


# FILLOI LUFTA NË GJIRIN PERSIK

● AEROPLANË TË FORCAVE SHUMËKOMBSHE SULMUAN OBJEKTIVA MBROJTËS TË IRAKUT. - ARTILERIA KUNDËRAJRORE REZISTOI FUQISHËM. - SADAM HYSEINI: «NUK DO TË DORËZOHEMI». - XHORXH BUSHI: «DO TË TËRHIQEMI PAS FITORES». - MIHAIL GORBAÇOV: «FAJTOR - SADAM HYSEINI». - DIK ÇEJNI: «OPERACIONI DO TË VAZHDOJË». - NË BAGDAD QETË DHE PA PANIKË. - DËME PO, POR ATO NUK DIHEN SAKTËSISHT. - AVIACIONI I IRAKUT, ME GJASË, SHPËTOI. - DEKLARATA BREGOSËSE TË KRYESISË SË RSFJ-së, TË KEF-it DHE TË SFPJ-së. PJESA DËRRMUESE E BOTËS PËRKRAH REZO-LUTËN E OKB-së, NDAJ EDHE LUFTËN Faqe: 4

**PËR 24 ORË -**  
**1.300**  
**FLUTURIME**  
**LUFTARAKE**

Uashington, 17 janar  
Më së paku 1.300 fluturime luftarake të avionëve të forcave aleate janë paraparë për 24 orët e para të ofensivës ajrore kundër Irakut, bënë të ditur Frans-Pres duke iu referuar burimeve të Pentagonit.  
«Operacioni po zhvillohet mjaftë mirë», deklaroi gjenerali amerikan, i cili kërkoi të mbetej anonim.  
Ofensiva ka nisur me «valën e raketave kryeqësuese» të shkrepura nga luftanijet amerikane në Gji. Kokat e tyre luftarake 500 kilogramëshe janë të programuara që të arrijnë caqet ushtarake irakiane.  
Kaqatorët-bombardues «F-15 E strajk Igel» me bomba një tonëshe dhe raketa për sulme nate, janë përdorë në valën e parë të sulmeve. Këto i kanë përcjellur kaqatorët-bombardues «të papashëm» «Stelt F-17» dhe avionët ofensivë të aviacionit të marinës «A-6».

Viti XIV, nr. 1, 1991 • Prishtinë • Çmimi 7 dinarë



**B U J K U**  
E PËRKOHSHE PËR ÇËSHTJE SHOQËRORE TË FSHATIT



## XHORXH BUSHI: «TËRHEQJE PAS FITORES»

Uashington, 17 janar  
Kryetari amerikan Xhorxh Bush u drejtua kombit përafërsisht dy orë pasi u vërtetua zyrtarisht se operacionet ushtarake filluan dhe kanë për qëllim çlirimin e Kuvajtit, vendosjen e qeverisë legjitime të këtij vendi dhe detyrimin e Irakut që të respektojë rezultatet e Kombeve të Bashkuara.  
«Derisa po ju drejtohem tash, sulmet ajrore po vazhdojnë kundër caqeve ushtarake në Irak. Ne jemi të vendosur që ta shkatërrojmë potencialin bërthamor të Sadam Hyseinit. Ne po ashtu do të shkatërrojmë instalimet e tij për prodhimin e armëve kimike. Një sasi e madhe e tankeve dhe e artillerisë së Sadamit do të shkatërrohet. Operacionet tona kanë për qëllim që të mbrojnë sa më mirë jetën e forcave të mbarë koalicionit, duke sulmuar arsenalin e madh ushtarak të Sadamit», deklaroi kryetari Bush.  
Duke shpjeguar se sanksionet, «ndonëse sollën ndonjë efekt, nuk treguan shenja për arritjen e qëllimit të vet», kryetari amerikan tha se «bota më nuk mundi të presë». Duke vërtetuar se operacioni nuk do të jetë «Vietnam i dytë», kryetari Bush po ashtu i premtoi kombit se trupat amerikane do të tërhiqen nga Gjiri pas fitores, posa të jetë kjo e mundshme.



## SADAM HYSEINI: NUK DO TË DORËZOHEMI

Aman, 17 janar  
Presidenti irakian, Sadam Hyseini, i cili personalisht mori komandimin me armatën, i dërgoi nëpërmjet Radio-Bagdadit një mesazh presidentit amerikan Bush, në të cilin thuhet se Iraku «nuk do të gjunjëzohet», duke kërkuar njëkohësisht që forcat shumëkombëshe të tërhiqen nga Gjiri.  
«Ju mendoni se kërcënimet do të na gjunjëzojnë» tha Sadami, duke kërkuar që Bushi të tërheqë trupat e veta dhe ato aleate. «Kjo është rrugë e vetme» që u ka mbetur, theksoi Sadam Hyseini në çastin kur aviacioni i forcave aleate edhe më tej po vazhdon bombardimin e objekteve strategjike anekënd Irakut, duke përfshirë edhe Bagdadin.  
Forcat e armatosura irakiake ende kryesisht nuk po u përgjigjen sulmeve. Në kumtesën e parë të luftës që u lexua sot në mëngjes, gjithashtu nëpërmjet Radio-Bagdadit, u tha vetëm që sulmi filloi, se aeroplanët e armikut u penguan me zjarr të mbrojtjes kundërajrore «i cili i detyroi» të fluturojnë në letërsi e të mos i qëllonin objektet, të qëllonin edhe vendet e banuara me popullsi civile.  
Në analizat e para të analitikëve të këtushëm ushtarakë shprehet vlerësimi se Iraku ende është i gatshëm të ndër marrë kundërsulm dhe vihet në dyshim pohimi i Pentagonit, sipas të cilit në sulmet e mbrëmshme u shkatërrua i tërë aviacioni irakian i luftës.



## FJALA E REDAKSISË PËRSËRI «BUJKU»...

Koha në të cilën jetojmë dhe proceset shoqërore që zhvillohen sot e këtu, në Kosovë, në vend dhe në botë, imponojnë nevojën për informim sa më të plotë për të gjithë, veçmas në boshllëkun e madh informativ që u krijua pas ndalimit të përkohshëm të punës së RTP-së - programit në gjuhën shqipe dhe të gazetës së përditshme «Rilindja».  
Duke u nisur nga kjo nevojë e madhe për informim dhe nga kërkesat e shumta të lexuesve NSHP «Rilindja» - NSH e Revistave vendosi që përsëri të botohet «Bujku», si gazetë e përkohshme informative për probleme të fshatit, dalja e së cilës pat pushuar për një kohë në mungesë të mjeteve të nevojshme për botimin e saj.  
«Bujku», prandaj, del sërisht e sot si numër i jashtëzakonshëm edhe për shkak të nevojës që edhe lexuesit shqiptarë në Kosovë, në mungesë të gazetës së përditshme, të kenë informacione sa më të gjera e me kohë në gjuhën shqipe për ngjarjen që filloi të tronditë botën - fillimin e luftimeve në Gjirin Persik. Për këtë shkak edhe me fizionomi e edhe me përmbajtje ky numër është i jashtëzakonshëm.  
Me dëshirë që edhe e përkohshmja «Bujku» të ndihmojë e kontribuojë sa më shumë në informim të opinionit, veçmas në fshat, vendosëm që sot dhe në të ardhmen të jetë përsëri në duart e lexuesve.  
Presim bashkëpunim.

## DEKLARATA E KRYETARIT TË KRYESISË SË RSFJ-së, DR. BORISAV JOVIQIT

### SADAM HYSEINI DUHET T'I RESPEKTOJË VENDIMET E OKB-së

Beograd, 17 janar  
Kryetari i Kryesisë së RSFJ-së, dr. Borisav Joviq lidhur me fillimin e luftës në Gji dhe këtë deklaratë: «Me dëshprim të madh duhet të konstatojmë dështimin e të gjitha përpjekjeve të deritashme të mbarë bashkësisë ndërkombëtare që të gjendet zgjidhja politike paqësore dhe të pengohet shpërthimi i luftës në Gji, e cila, mjerisht, mbrëmë filloi.  
Vendi ynë edhe si kryesues i lëvizjes së mosinkuadrimit ka bërë çmos që ky kontest të zgjidhet në mënyrë paqësore. Deri në çastin e fundit kemi shpresuar se do të mbizotërojë arsyeja dhe do të mund të evitohet përdorimi i forcës.  
Jugosllavia përherë në aktivitetin e vet ndërkombëtar është nisur nga qëndrimi se përzjerja në punët e brendshme, agresionin dhe pushtimin nuk mund të jenë mjete për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare. Sot kjo është posaçërisht e papranueshme, kur bota ndodhet në prag të epokës së re të paqes dhe të bashkëpunimit, pa konfrontime, të cilat dekadave të kaluara ishin kërcënim i përhershëm për paqen dhe sigurinë botërore.  
Ndonëse konflikti i armatosur, të cilin që të gjithë kemi dashur ta evitojmë, po vazhdon, ende nuk është vonë që ai të ndalet, të pengohen shkatërrimet e mëtejme dhe viktimat e reja.  
Andaj edhe në këtë situatë shumë të rrezikshme i drejtohem përsëri presidentit Sadam Hysein dhe Irakut të pranojnë vendimet e organizatës botërore e të fillojnë tërheqjen e menjëhershme nga Kuvajti, pushtimi dhe aneksimi i të cilit i kontribuan këtij zhvillimi tragjik. Në këtë çast kjo është mënyra e vetme që të evitohet katastrofa që ka filluar.  
Me vazhdimin e luftës të gjitha shtetet e bashkësisë botërore humbin në aspektin material, politik e në çfarë do tjetër dhe kjo objektivisht paraqet rrezik ndaj fryteve demokratike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Andaj është edhe interes i të gjithëve që nga kjo gjendje të dilen sa më parë». (Tanjug)

## PROCESET DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

### ZGJEDHJET U SHTYNË PËR 31 MARS

Marrëveshja për shtyrje u arrit pas takimit të Ramiz Alisë me liderët opozitarë  
Tiranë, 17 janar  
Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë miratoi dje vendimin që zgjedhjet e parapara më 10 shkurt të shtyhen, andaj zgjedhjet e para shumëpartiake do të mbahen më 31 mars të këtij viti. Njëkohësisht u arrit marrëveshja, të cilën e nënshkruan të gjitha partitë opozitare të Shqipërisë: - Partia Demokratike, Partia Republikane dhe Partia Ekologjike që deri në këtë datë të mos nxitet me asgjë mbajtja e manifestimeve partiake të cilat do të mund të rrezikojnë rendin e qetësinë publike, e me qëllim të zhvillimit normal të fushatës parazgjedhore.  
Për ata kandidatë të cilët në rundin e parë nuk fitojnë më shumë se 50 për qind të votave, është paraparë rundi i dytë i zgjedhjeve, i cili do të mbahet më 15 prill.  
Marrëveshja për shtyrjen e zgjedhjeve u arrit dje në mbledhjen e shefit të shtetit e të Partisë së Punës Ramiz Alia me liderët e partive opozitare të Shqipërisë: të Partisë Demokratike, Republikane e Ekologjike. Në takim mori pjesë edhe kryetari i Frontit Demokratik të Shqipërisë Adil Çarçani.

## BISEDË ME SHKAS - AZIZ ABRASHI: TI RUAJMË VENDET E PUNËS

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës insiston që të mos lëshohen lehtë vendet e punës, pos në rastet kur është e pamundshme të ruhen ato. - Sindikata synon ndërkombëtarizimin e problemit të punëtorisë kosovare /Faqe 2/

## PAS KATËR MUAJSH:

### SELAJDIN SKEJA U LIRUA NGA PARABURGIMI

Pritet të lirohet edhe Lekë Vuksani. - Në paraburgim mbetet delegati Tafil Salihu, ndërkaq penalisht ndiqen delegatët që shpallën Kushtetutën e Kaçanikut

## NGA GJYQI KUSHTETUES I JUGOSLLAVISË

### PËR DEKLARATËN MBI KOSOVËN BISEDHET NË SHKURT

● Megjithatë u kërkua që Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut të anulohet menjëherë, u mor vendimi që të mbahet edhe një mbledhje, ku do të sqarohen të gjitha çështjet kontestuese. - Ndalimi i «Rilindjes» - akt individual juridik që nuk qenka në kompetencë të kësaj gjykate! /Faqe 3/

## KUSH Ç'THA NË Mbledhjen e Kryesisë së RSFJ-së

### BISEDË E KËNDSHME APO - BLERJE E KOHËS

/Fragmente nga stenogramet e mbledhjes së sesisë së shtetit të mbajtur më 10 janar, sipas...



BISEDË ME SHKAS: AZIZ ABRASHI, NËNKRYETARI I KUVENDIT TË BSPK

# TË RUHEN VENDET E PUNËS

● Këto ditë Kosovën pritet ta vizitojnë asociacionet ndërkombëtare të punës. – Synimi i Serbisë është mënjanimi i shqiptarëve nga ekonomia. – Për imtësi nuk duhet lëshuar kursesi vendet e punës



«Shqiptarët janë të përcaktuar për punë – Aziz Abrashi

Përkundër të gjitha vështirësive me të cilat po ballafaqohet në aktivitetin e vet dhe përkundër pengesave, të cilat i bëhen nga Serbia, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës këto ditë zhvilloj një aktivitet të dendur politiko-diplomatik ku si synim kishte njohjen e saj nga asociacionet ndërkombëtare të punës. Së pari BSPK zhvilloi bisedime me Unionin Demokratik Evropian në Prishtinë, ndërkaq në Beograd biseduan me përfaqësuesit e sindikatave amerikane dhe evropiane. Këto asociacione ndërkombëtare u njoftuan për pozitën sociale, ekonomike dhe politike të punëtorëve dhe popullit shqiptar në Kosovë, me theks të veçantë në shkatërrimin e ekonomisë kosovare dhe përjashtimin e rreth 50 mijë punëtorëve nga puna. Për këto bisedime dhe për synimet e BSPK për njohjen e saj nga asociacionet e ngjashme dhe subjektet e tjera ndërkombëtare, si dhe për provokimet më të reja të këtyre ditëve të organeve të dhunshme për t'i detyruar shqiptarët t'i lëshojnë vendet e punës me kushtëzim dhe nënshkrimin të disa vendimeve-vërtetimeve dhe kinse dokumenteve të ndryshme, biseduam me Aziz Abrasin, nënkryetar i Kuvendit të BSP të Kosovës.

jë këto ditë edhe me sindikatat sllovene, me të cilat do të bëhet fjalë për nxjerrjen e gazetës javore të sindikatave kosovare. Po kështu, e që është edhe një hap shumë i rëndësishëm, këto ditë, problem in e largimit të shqiptarëve dhe shkatërrimin e ekonomisë kosovare do ta shqyrtojnë edhe Petagonala, si dhe sindikatat austriake.

Më tutje ky theksoi se punëtorët shqiptarë po u nënshtrohen provokimeve të pandërprera me ç'rast u jepën disa vërtetime dhe vendime për t'i nënshkruar se, ta zëmë, a pranojnë të anëtarësohet në Sindikatën e Serbisë dhe nëse nuk pranojnë t'i nënshkruajmë atëherë këtë e marrin si shkas për dëbimin e tyre nga puna. Mirëpo, Abrashi theksoi se punëtorët shqiptarë nuk duhet lejuar që të bien në gracka dhe kurtha të këtilla. Ata duhet të përcaktohen dhe të deklarohen për punë në kuadër të statutit të kolektivave punonjëse, t'i kryejnë punët si në kushtet normale, të respektojnë disiplinën dhe kanë për detyrë dhe obligim të vetin moral që ndaj të gjithë atyre të përdorin mekanizmat e ankesave, sepse konsiderojmë se klasa punëtorë shqiptarë është e civilizuar dhe duhet t'u përmbahet akteve civilizuuese derisa është e mundur, duhet t'i përdorë të gjithë ata mekanizma juridikë të një vendi. Në të gjitha instancat duhet të ankohen në mënyrë që të kemi dokumentacion, sepse, nëse legjislativi i Serbisë nuk i përfill këto, BSPK është çështje do ta shtrojë në nivele ndërkombëtare.

Kohët e fundit po bëhet një gjenocid i paparë që ka për qëllim që të eliminojë shqiptarët nga organet vetëqeverisëse, gjegjësisht, nuk po u mundësohet të konkurrojnë për zgjedhjen në këshillat punëtorë, madje këso rastesh ka edhe në ato kolektiva ku nuk janë vënë masat e dhunshme, me arsyetim se ata janë na-

cionalistë, separatistë dhe janë anëtarë të sindikatave të pavarura. Me këtë Serbia dhe Jugosllavia po bëjnë shkeljen flagrante të konventave ndërkombëtare.

E tërë kjo jep të kuptohet se Serbisë në Kosovë nuk po i intereson as prodhimit, as drejtësi, as zbatimi i shtetit juridik, por praktikisht, po i intereson shkatërrimi dhe eliminimi nga skena e klasës punëtorë shqiptarë.

Ne kemi thënë se edhe më tutje duhet të ruhen vendet e punës dhe se jemi për punë, praktikisht nëse jemi nën okupim dhe okupatori bën gjatë gjithë kohës shantazhe, atëherë këto nuk duhet kuptuar si serioze, së këndejmi nuk duhet për çfarëdo imtësi të japim shkas okupatorit të gjitha këtyre, ne të drejtat tona duhet t'i realizojmë në mënyrë legale nëpërmjet normave dhe ligjeve dhe duke qenë dinjitozë. Me vetë faktin se ne nuk kemi dalë në zgjedhje të lira kemi dëshuar se nuk e pranojmë shtetin serb. Në një rast disa qytetarë më pyetën se nëse e humbim ndonjë dokument siç është leja e njoftimit a duhet që këtë ta nxjerrim në gjuhën serbe. Natyrisht se një dokument i këtuill duhet të nxirret madje edhe prej okupatorit, sepse nevojitet për identifikimin e personit dhe nuk duhet të na pengojë edhe aq shumë, sepse sa na përket neve ai mund të jetë i shkruar edhe arabisht, mirëpo ne kurrë nuk do të heqim dorë nga gjuha jonë. Mirëpo, me këtë ne do ta vërtetojmë para opinionit ndërkombëtar se si Serbia po silllet ndaj popullit shqiptar. Prandaj, ne unanimisht kemi marrë qëndrimin se duhet ruajtur vendet e punës dhe në këtë jemi decidivë. Pra, nuk qëndron pohimi i Serbisë se mbi 43 mijë punëtorë e lëshuna vullnetarisht vendin e punës. Kjo do të ishte absurde, sepse fakti se këta punëtorë apo shumica e tyre kanë jetuar prej këtyre të ardhurave flet për të kundërtën.

R. DEMIRI

EDHE PAS SHUMË KËRKESAVE

# SINDIKATA JUGOSLLAVE MBETET E SHURDHËR

● Lidhja e Sindikatave të pavarura të Jugosllavisë, pa kurrfarë dëshmie, mbron qëndrimin se nuk mund të zhvillohet dialog me punëtorinë shqiptare. – Çka thuhet në një letër të Sindikatave të Pavarura të Kosovës,

Asociacionet e ndryshme botërore për fatkeqësinë e punëtorisë shqiptare në Kosovë po interesohen më shumë se ato të Jugosllavisë. Posaçërisht Lidhja e Sindikatave të Pavarura të Jugosllavisë, në krye me Moma Çolakoviçin, me kokëfortësi mbron qëndrimin se nuk mund të zhvillohet dialog me «sindikaten», e cila para vetes ka qëllimet separatiste». Se ai nuk mendon të lëshojë pe, dëshmoi edhe vizita para disa javësh që bëri në Kosovë, e nuk e pat të arsyeshme të merret me problem in e quajtur «përzënie e shqiptarëve nga puna» nën ndikimin e masave të dhunshme, të cilat u zbatuan në numrin më të madh të ndërmarrjeve kosovare. Tash kur duhet të bëhet nënshkrimi i kontratave kolektive, pushteti po kërkon mjete të reja që të largojë punëtorët shqiptarë, me arsyetim se nuk janë të anëtarësuar në sindikatën zyrtare, e cila, sipas tyre, është subjekt i vetëm që në emër të punëtorisë mund të nënshkruajë këtë dokument.

Se në Kosovë nuk mohohen format e organizimit sindikal në Jugosllavi, dëshmon një letër, të cilën bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës ia dërgon kryetarit të Sindikatave të Pavarura të Jugosllavisë. Aty thuhet: «Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës legjitimitetin e vet e fitoi me mbajtjen e Kongresit dhe me zgjedhjen e organeve legjitime në Kuvendin e Parë, të mbajtur në nëntor në Prishtinë, prandaj edhe po bëjmë këtë kërkesë për anëtarësim të barabartë në Lidhjen e Sindikatave të Pavarura të Jugosllavisë».

BSPK ka 200 mijë anëtarë. Për shkak të rrethanave të njohura, numri më i madh i anëtarësish është nga radha e punëtorisë shqiptare, por dyert i kemi të hapura për punëtorët e të gjitha nacionaliteteve. Prandaj, duke u nisur nga legjitimiteti që kemi, e në pajtim me Konventën ndërkombëtare nr.87, ju parashtrijmë këto kërksa:

– Që Lidhja e Sindikatave të Pavarura të Jugosllavisë të pranojë legjitimitetin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, çka do të thotë edhe pranimin e anëtarësish sonë të barabartë.

– LSPJ, në pajtim me obligimet që Jugosllavia i pranoi me rastin e nënshkrimit të Konventës për të drejtat dhe veprimin sindikal, është e detyruar të ngrejë zërin kundër urisë dhe represionit ndaj punëtorisë shqiptare nga ana e pushtetit serb, përmes largimeve masive të punëtorëve në më se 200 kolektiva të punës dhe institucione të tjera. Largimi me dhunë i 43.028 punëtorëve po ndikon që populli dhe punëtorët shqiptarë iu ekspozohet urisë. Prandaj, jeni të detyruar që sipas obligimit zyrtar të reagoni në emër të tërë punëtorisë në Jugosllavi. Nëse nuk ndihet zëri juaj rreth kërkesave tona, do të jemi të detyruar të informojmë të gjitha institucionet ndërkombëtare sindikale.

– Nga LSPJ kërkojmë që të nisë aksionin për ndihmë punëtorëve të uritur, të cilët u larguan me dhunë nga vendet e punës. Nëse edhe kjo kërkesë nuk has në mirëkuptim, do të jemi të detyruar t'u drjetohermi organizatave humanitare në botë.

– Ju propozojmë që të vizitoni BSPK në Prishtinë dhe të zhvillojmë dialog të hapur e korrekt për të gjitha çështjet e hapura. Nëse ju nuk jeni të gatshëm ta bëni këtë, ne jemi të gatshëm të vijmë në Beograd.

Presim përgjigjen tuaj për propozimet tona».

Edhe pse këto propozime u dërguan një javë para se të mbyllet viti që shko, kryetari i Lidhjes së Sindikatave të Pavarura të Jugosllavisë nuk u përgjig me kurrfarë shkrese, a deklarate në ndonjë formë tjetër. Kjo edhe një herë na përkujton se opioni në kren e sindikatës jugosllave, kur është në pyetje punëtorët shqiptarë në Kosovë, nuk ndryshon shumë nga opioni serb.

I. REXHEPI

ÇASTE ME MINATORËT E «GOLESHIT» TË MAGURËS

# NUK PËRULEMI DOT

● Rrjedhat e jetës pengohen, por nuk mund të ndalen. – Adaptim sipas «rregullave» të ditës. – Duke pritur pensionimin. – Populli nuk i harron minatorët

Është e enjte. Ditë tregu në Magurë, në këtë qendër të vogël minatorësh të komunës së Lipjanit. Tregtarët nxitojnë t'i joshin myshterijnt për mallin e tyre «të mirë e të lirë». Por, blerës ka pak, fare pak. Bisedojmë me njerëzit që takojmë aty: si arrijnë t'ia dalin këto ditë dimri minatorët e këtuashëm të cilët tash gjash të muaj «shteti juridik» serb i hodhi në rrugë.



Miniera pa minatorë shqiptarë: «Goleshi» i Magurës

Meqë i ka përzënë nga puna «shteti juridik» i serbisë u ka nxjerr mjaft «kohë të lirë», takuam shumë minatorë që kishin dalur në treg sa për të blerë ndonjë artikull të domosdoshëm, e më shumë për ta bjerrë kohën kot dhe për t'i harruar për një çast hallat e ditës. Ja, çka thonë vetë ata:

Hasan Latifi: – Verën e kaluar, gjatë kohës së pushimit vjetor, punova në Gjermani. Me të hollat që fitova, bleva diç veshmbathje sa për t'i plotësuar pjesërisht nevojat e familjes shtatanëtarëshe, si dhe kompletova katër fëmijë me tekste dhe mjete të tjera mësimore, të cilët ndjekin mësimet në klasa të ndryshme të fillores. «Goleshi» nuk na dha të holla, madje as për disa ditë që kishim punuar. Së shpejti çdo rezervë jona u shter. Gjithë ajo që kam tash është edhe një sasi e vogël mielli, që kam siguruar nga disa arë tokë që kam. Ndërkaq, nevojat e tjera familjare po mendohej t'i përmbush nga qumështi që po e shes. Kam një lopë, nga e ci-

la për çdo ditë marr nga pesë litra qumëst. Nga kjo sasi, një e ndal për vete, ndërsa katër litra detyrohem t'i shes.

Mehmet Sylejmani: – Kemi pakëz tokë, nga e cila kemi siguruar një sasi drithi. Këtë lopë e nxora në treg. Dëshja që me ato të holla të blej pakëz mish dhe me të hollat e tjera të blej cikërrima të tjera për nevojat e familjes. Por, duket se këtij pazari paskam dalë kot. Por, të jemi shëndoshë se idaren s'e ndal zoti. Ama nuk do të përulemi para fatkeqësive që po na i servon pushtuesi.

Nazmi Veseli: – Meqë nuk kisha kurrfarë burimi tjetër të të ardhurave, posa na përzunë nga pu-

na, mbeta keq. Nevojat për familjen 15-anëtarëshe ishin të mëdha. Për shkak të vështirësive, dy fëmijë në shkollën e mesme dhe një në fakultet u detyruan ta ndërpresin shkollimin. Ndërkohë nisën të arrijnë ndihmat. Na ndihmuan e po na ndihmojnë shokë e miq të shumtë. Nidhmat po arrijnë nga mbarë populli anekënd Ksovs dhe më gjerë. Vërtet, populli nuk po i harron minatorët. Jemi keq, por do të bëhet mirë. Kthim prapa nuk ka.

Izet Ramadani: – Kam pasuri sa për të bërë një jetë modeste me të njëmbëdhjetë anëtarët e familjes. Mandej një djale imi ende është duke punuar në një organizatë punëtorësh. Prandaj, nuk kemi ne-

vojë për ndihmë. Ditën që na përzunë nga «Goleshi» më shumë u brengosa për të tjerët sesa për vete. Ndryshe, unë kam 31 vjet përvojë pune në galeri, që kur të kihet parasysh beneficionet që na takojnë, bëjnë jo më pak se 43 vjet stazh pune. Pra me ligj i plotësoj kushtet për pensionim. Dhe, këtë e kam kërkuar. Njëherësh nuk po lëviz asgjë, po shpresoj se do ta realizoj këtë të drejtë.

Raif Nishori: – Nuk kam aq pasuri sa do të mjaftonte për t'i përmbushur të gjitha nevojat fa miljare por po ia dalim disi. Po shtrengohemi t'i përshatemi rrethanave që po i kushtëzojnë koha siç i thonë, t'i shtrijmë këmbët sa është jorgani. Kemi jetuar në skamje, por kurrë nuk iu kemi tur rur askujt t'ia shkelim djersën e ballit e t'ia grabi sim kafshatën e gojës, ashtu siç po vepron Serbia ne. Kështu nuk ndërtohet ardhmëria. Përkundër mangësive të tjera, më vjen keq që të birit, i cili ndjek mësimet në QAM të Lipjanit, nuk mund t'ia siguroj as të hollat që do t'i duheshin për pagesën e biletës për vajtje-ardhje. Pranda, më dhemb shpirti kur marr vesh se është maltretuar gjatë udhëtimit për këto shkaqe.

Muharrem Duhaku: – Nuk mbeta keq, jo, ec he pse më përzunë nga puna. Kam tokë dhe kafshë sa për t'i plotësuar nevojat familjare. Por, është fakt se po të mungonte solidariteti gjithëpopullor, shumë familje të katundit tim do të ballafaqeshin me skamjen. Po vërtet populli ynë është bujar e zemërgjerë dhe nuk ngurron ta shtrijë dorën ndihmës për të mbeturit keq, e kjo u dëshmuar edhe kësaj radhe. U vunë në lëvizje njerëzit tanë ku do që u gjenden dhe i përjetuan fatkeqësitë ton sikur të ndodhnin në familjet e tyre. E, kjo është një shenjë mjaft bindëse se kërkesat tona të drejtë nuk do të ketë forcë t'i ndalojë.

S. QERIC



# FILLOI LUFTA NË GJIRIN PERSIK

Bagdad, Uashington, Riad, Londër, 17 janar

Dje në mëngjes, në ora 01.00, filloi një luftë në Gji, në një sulm ajror «masiv dhe të përqëndruar» të forcave amerikane, britanike, saudite dhe kuvajtiane mbi objektivat strategjik në Bagdad, në tërë Irakun dhe në Kuvajt.

Operacioni «Furtuna shkretinore» filloi 170 ditë e një orë pas invadimit të Kuvajtit nga Iraku, më 2 korrik të vitit të kaluar, përkatësisht 19 orë pasi mbaroi afati që ia vuri Këshilli i Sigurimit i KB-ve Irakut për t'u tërhequr nga Kuvajti.

Tash për tash nuk ka të dhëna të sakta, se sa aeroplanë kanë marrë pjesë në sulmin, i cili, siç ka vlerësuar Pentagoni amerikan, u ndërmorë në një mënyrë shumë të suksesshme dhe «kirurgjikisht të përpiktë».

Aeroplanët sulmuan objektiva mbrojtës irakianë, sidomos qendrat e radarëve dhe të komunikacioneve, rafineritë dhe instalimet e prodhimit të armëve kimike dhe bërthamore.

Sulmi mbi Bagdadin e shoqëroi një zjarr i fuqishëm kundërajror irakian.

Në Jordani, e cila është «në darë» ndërmjet Irakut dhe Izraelit, gjithashtu nuk ka kurrfarë aksionesh ushtarake të dukshme. Mbreti jordanez, Hysein, natën e kaluar, pas lajmit të fillimit të luftës së Gjirit, e mori personalisht komandën mbi forcat e armatosura të

vendit të vet. Pjesa kryesore e armatës jordaneze është transferuar buzë kufirit me Izraelin, anës së luginës së lumit Jordan.

Rrjeti televiziv amerikan CNN

Bagdadit «irakianëve, arabëve dhe forcave të armatosura» duke deklaruar se «filloi hëna e të gjitha be- tejave» ndërsa spikeri lexoi se Iraku «do t'u japë mësim Amerikës dhe aleatëve të saj».

## KONFERENCË SHTYPI NË PENTAGON

### OPERACIONI - AFATGJATË?

Uashington, 17 janar

Sekretari amerikan i mbrojtjes Dik Çejni deklaroi sot në një konferencë të shkurtër për shtyp në Pentagon se sulmi i forcave shumëkombëshe në Irak është operacion afatgjatë, i cili kaloi vetëm fazën fillestare, andaj është e nevojshme matura dhe saktësia e plotë në vlerësimin e sukseseve të deritashme.

Dik Çejni informoi gazetarët se në sulm në Irak janë shënuar më se një mijë goditje ajrore aeroplanët e forcave shumëkombëshe dhe se janë ndezur më se 100 raketa bredhëse nga anijet në Gji.

Ai njëkohësisht shtoi se aksioni do të vazhdojë «derisa të jetë i nevojshëm», përkatësisht derisa të arrihet qëllimi i detyruar - që Sadam Hyseini të dëbohet nga Kuvajti dhe të sigurohet zbatimi i rezolutave të KB që kanë të bëjnë me këtë vend. Dik Çejni vërtetoi se aviacioni amerikan humbi një aeroplan, piloti i të cilit u vra në aksion. Aviacioni britanik humbi një aeroplan të tipit «Tornado». Ai shtoi se është e mundshme që në sulm të ketë pasur edhe më shumë viktima në anën e aleatëve.

njoftoi duke iu referuar burimeve të Pentagonit, se në sulmin u asgjësuan një pjesë e madhe e gardës elite presidenciale, të cilët organizatorët e vlerësonin si formacionin e vetëm ushtarak të aftë për t'u bërë një rezistencë ca më serioze forcave shumëkombëshe.

Kryetari irakian, Sadam Hyseini, iu drejtua nëpërmjet Radio-

Kryetari amerikan, Xhorxh Bush, deklaroi se «bota nuk mund të priste më» dhe se SHBA-të kanë hyrë në luftë me qëllimin «jo që ta pushtojnë Irakun, veçse që ta çlirojnë Kuvajtin».

Sulmi, të cilin e filluan dje në mëngjes forcat amerikane dhe shumëkombëshe, paraqet «vetëm fillimin» dhe shtetet e Bashkuara të

Amerikës «nuk mendojnë se do të


jetë lehtë» të arrihet qëllimi, përkatësisht çlirimi i Kuvajtit, deklaroi përfaqësuesi i Shtëpisë së Bardhë, Marlin Ficooter.

Ministri amerikan i mbrojtjes, Riçard Çejni, deklaroi se operacioni «Furtuna shkretinore» është duke u zhvillua mirë, duke theksuar se janë objektivë «instalime ushtarake ofensive» të zgjedhura irakiane. «Përgjigjja irakiane ishte shumë e kufizuar», vlerësoi Çejni, duke refuzuar për të diskutuar për të viktimat derisa të jenë në vazhdim operacionet.

Lajmi, i depërimit amerikan në Irak, megjithëse i pritur, ka ngjallur një shqetësim dhe brengosje të thellë në botë.

Sot në mëngjes, në agim të ditës, në Bagdad është kryesisht qetë dhe në qendrën e qytetit nuk ka shenja të bombardimit të natës. Reporterët e rrjetit TV CNN thonë se në rrugë është duke filluar trafiku i mëngjesit. Lidhjet telefonike dhe teleksi me Bagdadin kanë ndërprerje.

Ndaj raporteve të para për suksesin e natës mbi objektivat në Irak dhe në Kuvajt reagoi e para Bursa e Tokios ku sot në mëngjes çmimi i naftës ra nga 27,08 në 25 dollarë për fuçi. Kjo është, sipas vlerësimit të ekspertëve, pasqyrim i bindjes së lufta e Gjirit do të zgjasë megjithatë pak.



## KRYQI I KUQ NDËRKOMBËTAR NË GJENDJE GATISHMËRIE

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq i njoftoi organizatat kombëtare për personelin dhe për pajimet e zotëruara në zonën e konfliktit të luftës në Gjirin dhe ka dhënë saktësisht kërkesat në rast të zgjerimit eventual të operacioneve dhe të një nevoje më të madhe për evakuim dhe për ndihmën mjekësore në këtë rajon.

Kjo organizatë humanitare, bashkë me Gjysmë - hënë e Kuqe, zotëron momentalisht 84 punkte në Irak, Iran, Siri, Arabinë Saudite, Bahrejn, Egjipt, Jordani, Liban, Izrael dhe në territoret e pushtuara. Në të njëjtën kohë, 50 ekipe janë të gatshme që të nisen për çdo cast në zonën e përfshirë nga lufta. Në bashkëpunim me komitetet kombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe janë përgatitur 9 qendra të lëvizshme pranimi, të cilat do të mund të pranoni 30 mijë refugjatë në këtë rajon.

Organizatave kombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe u është drejtuar kërkesa që në rast të zgjerimit të konflikteve, të përgatitin (secilin vend) nga 5 spitale fushore plotësisht të pajisura me nga 100 krevate, material mjekësor për nga pesë ekipe kirurgjike, të cilat do të punonin në spitalet e zotëruara, material dhe pajime për kampet eventuale të refugjatëve.

Të njëjtën kohë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq tërhoqi vërejtjen gazetarëve anë botës që, sipas disponibilitetit të kësaj organizate të udhëtojnë assesi- onin që është në

## DEKLARATA E KEF-it ME RASTIN E SHPËRTHIMIT TË LUFTËS NË GJI

### JUGOSLLAVIA PËRPIQET PËR PAQE

Beograd, 17 janar

Me rastin e shpërthimit të luftës në Gji, Këshilli Ekzekutiv Federativ lëshoi këtë deklaratë:

«Jugosllavia, duke qenë besnike ndaj paqes dhe parimeve demokratike e humane të Kartës së OKB-së e të së drejtës ndërkombëtare, e frymëzuar nga parimet e politikës së mosinkuadrimin, shpreh keqanëje të madhe për shkak se në Gji shpërtheu lufta që sjellë viktima tragjike e pasoja të mëdha materiale e morale.

Jugosllavia edhe si kryesuese e lëvizjes së vendeve të painkuadruara, në bashkëpunim me vendet e painkuadruara e të tjera, bëri krejt atë që mundi me qëllim që kriza në Gji të zgjidhet me mjete politike e në mënyrë paqësore.

Edhe pas kalimit të afatit, të cilin e përmban Rezoluta 678 e Këshillit të Sigurimit të OKB, tetë orë para shpërthimit të luftës, bëmë edhe një apel për paqe dhe arsye.

Para së gjithash, iu drejtua kryetarit Sadam Hysein dhe udhëheqjes irakiane që në përputhje me

parimet e të drejtës e të paqes të japin kontributin e tyre të domosdoshëm për tërheqje nga Kuvajti dhe kësajoj të realizojnë parashikimet e mbarë bashkësisë ndërkombëtare e veçanërisht të lëvizjes së vendeve të painkuadruara.

Edhe tash, kur po vazhdon lufta dhe kur po bien viktimat e para mendojmë se duhet vazhduar përpjekjet që sa më parë të vendoset paqja. Përmes mënjanimit të menjëhershëm të shkaqeve të krizës, braktisjes së territorit të Kuvajtit nga Iraku do të krijoheshin kushtet që të ndërpriten armiqësitë, të shmangen viktimat e mëtejshme dhe që kjo vatrë e luftës dhe problemet e rajonit të fillojnë të zgjidhen me mjete politike në pajtim me parimet e mosinkuadrimin e të Kartës së OKB.

Jugosllavia, në këtë drejtim edhe më tej do të vazhdojë përpjekjet maksimale duke bashkëpunuar sa më ngusht me të gjithë faktorët ndërkombëtarë, me vendet e painkuadruara, me anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB e veçanërisht me sekretarin e përgjithshëm të OKB».

## DEKLARATA E B.LONÇARIT ME RASTIN E SHPËRTHIMIT TË LUFTËS NË GJI

### SHQETËSIMI PËR SHKAK TË KONFLIKTIT

Beograd, 17 janar

«Na vjen shumë keq dhe jemi shumë të shqetësuar për shkak të fillimit të luftës në Gji. Bëmë përpjekje të mëdha për ta penguar këtë luftë, viktimat dhe shkatërrimet të cilat do t'i sjellë me siguri. Tash duhet bërë çdo gjë që të ketë sa më pak viktima», deklaroi sekretari federativ jugosllav i Punëve të Jashtme Budimir Lonçari radiotelevizionit jugosllav me rastin e shpërthimit të luftës në Gji.

«Në këtë çast duhet thënë se edhe mbarë opinioni ndërkombëtar dhe diplomacia botërore priten që Iraku të tërhiqet nga Kuvajti dhe të pengohet kjo që po ndodh tash», shtoi Lonçari dhe vazhdoi:

«Mendoj se zgjidhja është në çështjen që Iraku, i ballafaquar me situatën e tashme e me fillimin e luftës, të rishqyrtojë interesat e popullit të vet, të

shmangë viktimat dhe pasojat katastrofale, të tërhiqet nga Kuvajti e të vendosë gjendjen që ishte para 2 gushtit, me qëllim që të sigurohet paqja e të zbatohen parimet në të cilat mbështetet Karta e OKB-së».

Pyetjes se a beson se diplomacia ndërkombëtare mund ta ndalë luftën dhe me çfarë mjete do ta bëjë këtë, sekretari federativ iu përgjigj:

«Mendoj se duhet të përqendrohemi në një aksion, të cilin do ta përmbledhim në çështjen që të kthehemi në gjendjen para dy gushtit. Deri tash kryetari i Irakut nuk dëshoi të kuptojë se do të shkaktohen pasoja të rënda për Irakun dhe rajonin nëse nuk tërhiqet nga Kuvajti dhe nuk e anulon aneksimin, të cilin e e quajmë agresion. Pra, nuk duhet realizuar kapitullimin e plotë të Irakut, por tërheqjen e tij nga Kuvajti».

## REAGIMET NË BOTË PËR FILLIMIN E LUFTËS NË GJI

### U ZBATUA VENDIMI I OKB-së

Ndonëse është pritur, lajmi për sulmin amerikan në Irak shkaktoi brengosje dhe shqetësim të madh në botë, e këtë e dëshmojnë edhe reagimet e para për të cilat njoftojnë korrespondentët e Tanjugut e të agjencive

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Peres de Kuelar shprehu pikëllim të madh për shkak të shpërthimit të luftës, përkatësisht për shkak të mospasurisë të të gjitha përpjekjeve të tij paqësore.

Kancelari gjerman Helmut Kol deklaroi se «mendimet e tij janë të njëjta me të gjithë njerëzit që do të vuajnë tash, kur filloi lufta në Gji. Koli shtoi se do të bëjë çdo gjë që mundet me qëllim që konflikti ushtarak të zgjasë sa më pak.

«Politika tradhtoi», deklaroi mbremë në Bon shefi i opozitës socialdemokrate Hans Jochen Fogel dhe shtoi se «është tronditur shumë nga tmerri». Përfaqësuesi i Ministrisë japoneze të Punëve të Jashtme shfaqi keqardhje që kryetari irakian Sadam Hysein nuk respektoi rezolutat e Këshillit të Sigurimit të KB, por shtoi se Tokioja miraton plotësisht aksionin e armatosur kundër Bagdadit.

Kryeministri australian Bob Houk kumtoi se tri anije australiane, të cilat ndodhen në Gji, morën autorizimet që të inkuadrohen në operacionet luftarake. Kryeministri për këtë vendim siguroi përkrahjen e plotë të qeverisë.

Ambasadori kuvajitian në Teheran Fauzi al - Xhasem shfaqti shpresën se lufta për çlirimin e vendit të tij do të përfundojë shpejt dhe nuk do të sjellë viktima e shkatërrime të mëdha. «Jemi përpjekur pesë muaj të arrijmë zgjidhjen paqësore por pas 15 janarit lufta u bë rrugëdalje e vetme», tha ambasadori kuvajitian.

Një përfaqësues i qeverisë italiane kumtoi se vendi i tij bëri të gjitha përpjekjet për t'u penguar konflikti ushtarak, por nuk mundi të bëjë asgjë. Ai shtoi se në Romë vlerësohet se katër-pesë orët e ardhshme do të jenë vendimtare për kohëzgjatjen e luftës.

Në Paris tash për tash zyrtarisht reagoi vetëm lideri i Partisë Komuniste të Francës Zhorzh Marshe. Ai për konfliktin e armatosur akuzoi edhe kryetarin amerikan e edhe kryetarin irakian, duke thënë se kjo është luftë «për naftë dhe dollarë, e jo për çlirimin e Kuvajtit».

Një përfaqësues zyrtar i qeverisë greke deklaroi se Sadam Hyseini është fajtor i vetëm për luftën në Gji. Në Athinë në të vërtetë, po vazhdon mbledhja e udhëheqjes ushtarake, e cila duhet të vendosë se a do të vëhen forcat e armatosura greke në gjendje të gatishmërisë maksimale.

Kryetari jugkorean Ro Te Vu shprehu përkrahjen e plotë të vendit të tij «aksionit të vendosur ushtarak amerikan kundër Irakut».

Një përfaqësues i Ministrisë spanjolle të Punëve të Jashtme po ashtu përkrahu sulmin amerikan dhe shfaqti bindjen se ai do ta detyrojë Sada Hyseinin që të tërhiqet nga Kuvajti.

Qeveria kineze shfaqti brengosje të madhe për shkak të shpërthimit të luftës në Gji dhe thirri palët ndërluftuese që të tregojnë rezervim maksimal me qëllim që të «pengohet zgjerimi i mëtejshëm i flakës së luftës». Vetëm kështu, thuhet në kumtesën e qeverisë kineze, bashkësia ndërkombëtare mund të ndër marrë aksione të menjehershme dhe të vazhdojë të kërkojë mënyra për përbalimin politik të konflikteve.

«Iraku vëlla i është ekspozuar sulmit amerikan». Me këto fjale, Radio Amani ndërpreu programin e rregullt për të lajmëruar për fillimin e luftës në Gji. Në të vërtetë, në kryeqytetin jordanez mbretëron qetësi absolute, kurse rrugët janë gati të shkrëta. Gjallëri ka vetëm në hotelet e mëdha, ku është vendosur një «ushtri» e madhe e gazetarëve të huaj.

Në Damask ende nuk ka kurrfarë reagimesh zyrtare për shpërthimin e luftës në Gji. Agjencia kombëtare SANA emeton lajmet e agjencive gazetare perëndimore, por tash për tash pa komente. Ministri sirian i Informimit dje deklaroi se ushtarët sirianë në përbërje të forcave shumëkombëshe në Arabinë Saudite nuk do të marrin pjesë në sulm në Irak.

Lideri kuban Fidel Kastro deklaroi se shpërthimi i luftës në Gji është disfatë për Kombet e Bashkuara dhe për politikanët e sotëm. Ai tha se lufta ka mundur të pengohet. Në bisedë me gazetarët amerikanë Kastroja tha se përgjegjësinë e mban ai që filloi luftën dhe theksoi se këto janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Po ashtu, Spanja zyrtare thekson se «në Gji ndodhi ajo që është dashur të ndodhë» dhe se «fajin kryesor e ka Sadam Hyseini».

Liderët suedezë deklaruan se Sadam Hyseini është ai që duhet fajësuar për sulmin e forcave shumëkombëshe. Kryeministri Ingvar Karlson tha se «shpërthimi i luftës në Gji është tragjedi» dhe se ajo do të sjellë vuajtjet e pakufishme njerëzore dhe mund të shkaktojë pasoja të papërmirësueshme ekologjike e politike. Por, tha Karlsoni, me injorimin e rezolutave të KB, Iraku, mori tërë përgjegjësinë.

Kryeministri indian Çandra Shekar tha se shpërthimi i luftës në Gji «e çoi njerëzimin buzë katastrofës». Ai tha se India dhe vendet e tjera aziatike do të goditen shumë rëndë nga pasojat e luftës. Njëkohësisht shfaq shpresën se «arsyeja do të mbizotërojë dhe se situata e tillë nuk do të zgjasë shumë».

Ministri belg i mbrojtjes Gi Kom theksoi se është e nevojshme që në këtë moment secili të tregojë «solidaritet maksimal» me aleatët me qëllim që lufta të përfundojë sa më parë.

Ministri danez i Punëve të Jashtme Ufe Eleman Jensen shfaqti shpresën se aksioni ushtarak kundër Irakut do ta detyrojë Sadam Hyseinin që të mbushet mend ose do ta nxisë popullin e tij që ta largojë nga pushteti.

Radio-Varshava thekson se bota dëshoi t'i shmangte kësaj lufte, por Sadam Hyseini zgjodhi luftën në vend të paqes. Radioja ve në pah se forcat shumëkombëshe janë nga 28 vende prej të cilave disa janë arabe, dhe se për këtë arsye nuk është fjala për luftën e shenjtë të besimtarëve islamikë e të ateistëve, por për luftën kundër agresionit, të cilin po e kundërshton opinioni botëror.

Qëndrimi bullgar prej fillimit ka qenë kategorik - është dënues pushtimi i Kuvajtit dhe janë respektuar pa kushte rezolutat e KB, deklaroi kryetari bullgar dr. Zheho Zhelev dhe shtoi se Bullgaria i përmbahet me konsekuencë embargos në tregti me Irakun, ndonëse është njëri prej vendeve që është goditur më së shumti nga kriza në Gji. Zhelevi shfaq shpresën se lufta në Gji «do të jetë më e shkurta dhe me më së paku viktima», e, ndoshta, do të jetë edhe e fundit në historinë botërore.

Ministria e Punëve të Brendshme e Bullgarisë kumtoi se organet e saj janë në gjendje të gatishmërisë së lartë, duke pasur parasysh afërsinë e rajonit të luftës. Komanda e mbrojtjes civile shpalli udhëzimet në rast të rrezikut radioaktiv ose kimik.



NGA GJYQI KUSHTETUES I JUGOSLLAVISË

# PËR DEKLARATËN MBI KOSOVËN BISEDOHET NË SHKURT

● Megjithëse u kërkua që Deklarata kushtetuese e 2 korrikut të anulohet menjëherë, u mor vendimi që të mbahet edhe një mbledhje, ku do të sqarohen të gjitha çështjet kontestuese. – Ndalimi i «Rilindjes» – akt individual juridik!

Kohëve të fundit çështjet kosovare janë vazhdimisht të pranishme në mbledhjet e Gjyqit Kushtetues të Jugosllavisë. Kështu ishte edhe në seancën e fundit të këtij Gjyqi (më 16 janar), në të cilën, ndër të tjera, u bë fjalë edhe për Deklaratën kushtetuese të 2 korrikut mbi Kosovën si njësi e pavarur dhe e barabartë në federatën (konfederatën) jugosllave. Të përkujtojmë – Gjyqi Kushtetues i Jugosllavisë filloi procedurën për vlerësimin e kushtetushmërisë së këtij akti më 21 nëntor 1990. Gjyqtari i obliguar për këtë çështje **Branislav Ivanović** edhe kësaj here kategorikisht kërkoi që menjëherë të anulohet Deklarata kushtetuese e Kosovës, sepse kinsë fjala është «për një dokument me të cilin në mënyrë flagrante shkelen dispozitat e Kushtetutës së RSFJ».

**Pjetër Kola** tërhoqi vërejtjen se Gjyqi Kushtetues i Jugosllavisë duhet të respektojë rregulloren e vet të punës dhe në këtë kontekst tha se, sipas procedurës së parashikuar, para se të vendosej për çështjen në fjalë, vendimi duhet t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës, i cili ka miratuar këtë akt. Po ashtu, para marrjes së vendimit definitiv, duhet mbajtur mbledhjen përgatitore, ku do të ftoheshin shkencëtarët dhe ekspertët dhe ku do të sqaroheshin çështjet kontestuese.

Habit fakti se mendimi i **Pjetër Kolës** kësaj here nuk mbeti i vetmuar. Atë e përkrahën jo vetëm, si rëndom, **Ivan Kristani** (Sloveni), por edhe shumica e gjyqtarëve të tjerë, si dhe kryetari i Gjyqit **Milovan Buzaxhiq**. Në fund, me shumicë votash (10:3) u miratua propozimi i **Pjetër Kolës** që të

mbahet një mbledhje përgatitore lidhur me Deklaratën mbi Kosovën, ku do të thirren edhe ekspertët nga Kosova. Siç pritet, kjo mbledhje do të mbahet nga fillimi i shkurtit.

Në rend të ditës ishte edhe propozimi i Kuvendit të Gjakovës dhe Kuvendit të Sllovenisë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit mbi ndërprerjen e punës së Kuvendit të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës. Ky propozim u dërgua Kuvendit të Serbisë, mirëpo meqenëse pas dy muajve (sa ishte afati) nuk arriti kurrfarë përgjigje nga Kuvendi i Serbisë, Gjyqi mori vendimin që për këtë çështje të organizohet debati publik në Gjyqin Kushtetues të Jugosllavisë. Edhe ky tubim duhet të mbahet në fillim të muajit shkurt dhe në të do të ftohen përfaqësuesit e Kuvendit të Gjakovës, Kuvendit të Sllovenisë (si përfaqësues të propozuesit të autorizuar), pastaj përfaqësuesit e Kuvendit të Serbisë, si dhe shkencëtarët dhe ekspertët nga Kosova.

Gjyqi refuzoi kërkesën e ndërmarrjes «Rilindja» mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit të Serbisë mbi ndalimin e përkohshëm të gazetës «Rilindja». Si edhe në rastet e mëparshme, shumica e gjyqtarëve konsideron se është fjala për një akt individual juridik, për vlerësimin e të cilit ky gjyq nuk është kompetent. Vendimi u mor me shumicë votash – «kundër» ishin **Ivan Kristani** dhe **Pjetër Kola**.

A. BERISHA

## KRYQI I KUQI I ZVICRËS NDIHMOM KOSOVËN

Kryqi i Kuq i Zvicrës këto ditë, siç na informoi sekretari i Kryqit të Kuq të Sllovenisë **Mirko Jeleč**, dërgoi ndihmë humanitare në veshmbathje për Kosovën nëpërmjet Kryqit të Kuq të Sllovenisë. Kjo ndihmë do t'i dërgohet Kryqit të Kuq në Prishtinë dhe Pejë për t'iu shpërndarë familjeve, të cilat kanë nevojë. Punëtorët shqiptarë me punë në Raron të Zvicrës, siç na informoi **Qenan Limani**, organizuan transportin e ndihmës deri në Sezhanë, ku më pastaj e mori Kryqi i Kuq i Sllovenisë, i cili mori përsipër edhe transportin deri në Kosovë.

M. H.

## NËN ADMINISTRATËN SERBE EDHE STACIONI BUJQËSISË

## S'I NJOHIM MASAT E DHUNSHME

Nën administratën e dhunshme, Kuvendi i Serbisë e futi edhe NSH Stacioni për Përparimin e bujqësisë. Ditën e parë, nga detyra u shkarkuan drejtori përgjithshëm dhe ai financiar, ndërsa të nesërmen u largua edhe një punëtor.

Sindikata e pavarur proteston ashpër kundër këtyre masave ndaj punëtorëve shqiptarë të organit të dhunshëm, të cilin nuk e njeh.

H.B.

## MËRGIMTARËT TANË NDIHMOJNË FAMILJET E RREZIKUARA EKONOMIKISHT

## PËR KODRËN E TRIMAVE – 60 MIJË DINARË

● Këto mjete i grumbulluan anëtarët e shoqatës humanitare «Nënë Tereza» në Troistorrents të Zvicrës

Në këtë kohë krize me të cilën po ballafaqohen shqiptarët në Kosovë, kur shumë familjeve u është rrezikuar baza ekonomike për ekzistencë, meqë pushteti serb largoi me dhunë nga puna rreth 50 mijë punëtorë shqiptarë, mërgimtarët tanë në botë nuk po kursejnë që me paratë e tyre të fituara me djersën e kurbetit të ndihmojnë që kjo krizë të zbutet sadopak. Ditëve të fundit të vitit të kaluar shoqata humanitare «Nënë Tereza» e mërgimtarëve tanë në Troistorrents të kantonit Valis të Zvicrës u dha ndihmë solidare 22 familjeve në Kodrën e Trimave të Prishtinës, të grumbulluara nga 18 anëtarë aktivë të kësaj shoqate. Këto ditë, nga po kjo shoqatë u ndihmuan edhe 38 familje të kësaj lagjeje dhe shuma e mjeteve që u dhanë, bashkë me ato të parat, arrin në rreth 60 mijë dinarë.

D. G.

## CINIZMI DHE PROVOKIMI I NJË KONKURSI TË MIM «GOLESHI»

## PËR 1.100 VENDE PUNE – 100 PUNËTORË!

Sindikata e Pavarur e MIM «Goleshi» në Magurë të Lipjanit proteston për shkak të bllokimit gjithnjë më të egër të prodhimit në Kosovë nga ana e pushtetmbajtësve të Serbisë, të cilët po mundohen ta gjuhëzojnë klasën punëtorë në Kosovë. Bartësit e pushtetit serb në këtë kolektiv pas hedhjes së 1.100 punëtorëve shqiptarë nga puna tash me një lloj cinizmi dhe provokimi shpallin konkursin për pranimin e vetëm 100 punëtorëve.

Konkursi i këtyrë është edhe një provokim i hapit të cilin nuk do ta pranojnë punëtorët, thuhet në komunikatën e SP të Xeherosës së Magnezitit. Kjo sindikatë angazhohet që masat e tashme të hiqen menjëherë dhe të lejohet puna e papenguar në këtë kolektiv.

B. Z.

## NË NDËRMARRJEN SHOQËRORE «TREGU» TË PRISHTINËS

## TEPRICË TEKNOLOGJIKE – VETËM SHQIPTARËT

Pas aplikimit të masave të dhunshme nga Kuvendi i Serbisë në NSH «Tregu» në Prishtinë organi i dhunshëm punëdrejtues në krye me **Slobodan Kostiqin**, me metoda tashmë të njohura përbuzëse antiligjore largoi nga puna 33 punëtorë shqiptarë, kinsë tepricë teknologjike.

Arsye për vendosjen e masave të dhunshme në këtë ndërmarrje tregtare prishtinase nuk kishte, sepse afarizmi i saj ishte pozitiv. Edhe marrëdhëniet ndërnacionale në ndërmarrje ishin të mira. Mirëpo, sjelljet dhe vendimet e organit të dhunshëm nuk duan koment, kur si tepricë teknologjike paraqiten vetëm shqiptarët.

B. KAJTAZI

## MALISHEVË STRUGANËT SOLLËN NDIHMË

Se vërtet te populli shqiptar jo vetëm në Kosovë është krijuar një moral dhe vetëdije e lartë në çdo pikëpamje, tashmë është dëshmuar shumë herë. Pas largimit masiv nga puna të punëtorëve shqiptarë nga okupuesi serb, shqiptarët kudo u mobilizuan për t'iu ndihmuar njëri-tjetrit. Kështu, filluan ndihmat nga të gjitha anët e Kosovës, por edhe nga viset e tjera të vendit të banuara me shqiptarë. Mirëpo, Malisheva me rrethinë kurrë nuk do të harrojë ndihmën vëllezërore të struganëve dhe tetovarëve, si dhe të qyteteve të tjera të banuara me shqiptarë. Këto ditë anëtarët e shoqatës bëmërisë «Nënë Tereza» nga Struga në adresë të Shtëpisë së Shëndetit sollën barna në shumë 40 mijë dinarësh. Po ashtu, u ndihmua edhe shoqata humanitare «Nënë Tereza» me seli në Malishevë. Struganët edhe më parë ndihmuan këtë komunë, sidomos Shtëpinë e Shëndetit. Ndërkaq, kësaj here ndihmuan edhe nxënësit e varfër të kësaj komune me mjete mësimore në shumë 70 mijë dinarë, thotë **Bahti Thaçi**, kryetar i shoqatës humanitare e bëmërisë «Nënë Tereza» në Malishevë.

I. B.

## MASAT E DHUNSHME DHE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

## DREJTORIA E TË HYRAVE SHOQËRORE ÇAK I PARË I MASAVE TË DHUNSHME

Me vendimin e Kuvendit të Serbisë nga posti i drejtorit të të hyrave shoqërore u shkarkua **Esat Jaha** e në vend të tij u emërua **Novica Vitosheviq**

Rahovec, 17 janar

Masat e përkohshme, të cilat Kuvendi i Serbisë i aplikoi në shumë kolektiva kosovarë e të cilat u morën në rrethana të veçanta dhe që janë edhe kundërkushtetuese, nuk e lanë anash as komunën e Rahovecit. Kjo fushatë antivilizuese e pushtetit okupues serb filloi edhe në këtë komunë e cila deri më tani ishte njëra ndër komunat e vetme pa masa të këtyrë. Pushtetmbajtësit serbë dëshiruan që edhe në këtë komunë me aplikimin e masave të dhunshme fushatë kjo e egër dhe antihumane t'i gjuhëzojë shqiptarët për ta pranuar diktatin e Serbisë. Çak i parë i masave të dhunshme në këtë komunë është Drejtoria e të hyrave shoqërore vendim ky i cili u mor mbledhjen e fundit të Kuvendit të Serbisë e që u publikua edhe në fletoren zyrtare të RS të Serbisë nr. 22/91. Në këtë vendim thuhet se Kuvendi i Serbisë shkarkon nga detyra e drejtorit të të hyrave shoqërore **Esat Jahën**, i cili në këtë vend u emërua nga ana e Kuvendit të kësaj komune e i cili është kompetent për emërimet e shkarkimeve, e në vend të tij për drejtor të të hyrave shoqërore emëroi **Novica Vitosheviqin** me kualifikim të lartë. Nga po kjo drejtori ditë më parë u largua edhe inspektori i këtij drejtorati **Nehit Elshani** me një vendim të çuditshëm të Këshillit Ekzekutiv Komunal.

T.R.

## SHTIME

## MASAT E DHUNSHME NË SHËTËPINË E SHËNDETIT

Shtime: Marrëzisë së pushtetit serb këto ditë u shtua edhe një «margaritar»: masat e dhunshme në Shtëpinë e Shëndetit në Shtime! Arsyeshmëria e këtij absurdi është sa qesharake, aq edhe e neveritshme: dhënia e ndihmës së parë të helmuarve! Këtij absurdi ne nuk mund t'i vëmë tjetër emër pos ÇMENDURI.

Nëse këtë veprë e përkrah populli serb, atëherë neve sinqerisht na vjen keq për këtë popull. Na vjen keq, sepse popujt që veprojnë kështu, ne i quajmë të mjerë. Besojmë se shkëlqimi i këtij mjerimi nuk i bën nder askujt, prandaj kërkohet që ky pushtet sa më parë të lirohet nga marrëzia.

R. RESHANI

## NË QENDRËN MJEKËSORE TË GJILANIT

## PAS MASAVE – NDËRRIME

● Nga detyra e drejtorit të spitalit u ndërrua dr. **Haqif Huruglica**. – Shpend Elezi e Hysen Hyseni nuk pranojnë të jenë në organ të dhunshëm

Punëtorët e Qendrës Mjekësore të Gjilanit, anëtarë të Sindikatës së pavarur, protestojnë ashpër kundër masave të dhunshme, të cilat, siç thuhet, u aplikuan pa kurrfarë arsye, me qëllim të largimit të tyre nga puna dhe zëvendësimit me punëtorë serbë e malazez. Menjëherë u ndërrua drejtori **Haqif Huruglica**, si dhe referentja **Xhyzide Ramadani**. Organi i dhunshëm po përgatit edhe shumë «rokada» të tjera, ndërsa të gjitha vendimet dhe shkresat e tjera po i shkruan vetëm në gjuhën serbe.

Në përbërje të këtij organi, për njohjen e të cilit punëtorët shqiptarë duhet të deklarohen (kështu kërkohet), pa u konsultuar fare janë futur edhe dr. **Shpend Elezi** dhe **Hysen Hyseni**, shef i kontabilitetit. Këta, menjëherë u deklaruan kolegëve të tyre se nuk i pranojnë këto detyra. Por, këtë detyrë, me dëshirën e vet e pranon **Faik Jashari**, punëtor social i BVI-së së shëndetësisë, më parë i caktuar në këso organe në «Integi».

Punëtorët shëndetësorë protestojnë edhe ndaj largimit nga puna pa kurrfarë baze ligjore të disa teknikëve të dhëmbëve.

I.M.

## NË GJYKATËN KOMUNALE TË MALISHEVËS

## U HODHËN ARBITRARISHT NË RRUGË 23 PUNËTORË

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Serbisë, përkatësisht të ligji mbi organizimin territorial të Gjykatave në teritorin e Kosovës, sipas «Gazetës zyrtare» të Serbisë» 21/90 të datës 31.12.1990, kësaj gjykate i ndërpritet funksioni i tërësisht. Vendimet për shkarkimin e gjykatësve ua solli pikërisht kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren **Masar Pirana**, para datës 25.12.1990, në të cilët, ndër të tjera, thuhet se këtyrë u pushon e drejta edhe për të ardhura personale dhe obligimet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të Serbisë në rrethana të porsaçme. Më 16 janar në këtë gjykatë arriti një komision prej tre anëtarësh, i përbërë nga **Fikri Shishko**, gjykatësi i Gjyqit të Qarkut në Prizren /kryetar komisioni). **Ali Elezi**, punëtor i SMPP të Kosovës, tash në cilësi të nënsekretarit të organeve të jurisprudence jolegjitime të Kosovës, si dhe **Jovica Vazura**, gjykatësi i Gjykatës Komunale në Rahovec. Me ta ishte edhe **Muhedin Bekeri**, kryetar i Gjykatës Komunale në Rahovec. Merret vesh se e tërë lënda dhe inventari i kësaj Gjykate do të bartet në tërësi në Gjykatën Komunale të Rahovecit. Lidhur me këtë rast protestoj ashpër **Kryesia e Shoqatës së Juristëve të Pavarur të Malishevës**.

I.BYTYQI

## NË DRAGASH

## TË GJITHA NDËRMARRJET NËN MASA TË DHUNSHME

Sipas propozimit të kuadrove myslimane, me vendimet arbitrare të Kuvendit të RSS-së, në të gjitha ndërmarrjet e pakta ekonomike dhe institucionet e Dragashit u aplikuan masat e dhunshme, me ç'rast kuadrot shqiptare u zëvendësuan me ato myslimane. Natyrisht pos kuadrove udhëheqëse shqiptare, nga detyra u shkarkuan dhe u pezulluan edhe kuadrot më të afta profesionale të ndërmarrjeve. Në këtë mënyrë komuna e Dragashit ka ngelë pa kuadro udhëheqëse shqiptare pasi që në ekonomi dhe joekonomi vendet udhëheqëse i okupuan kuadrot myslimane të cilat dita-ditës po i largojnë nga puna kuadrot dhe punëtorët «e padëgjueshëm» shqiptarë, numri i të cilëve tash ka arritur në afro 300 veta. Kësisoj, kuadrot myslimane të kësaj patën rast të bëhen udhëheqës me procedura legale ligjore. Kësaj mundësi të tillë arbitrarisht ua ofroi shteti juridik i Serbisë të cilit me mjaft «apetit» po i zbaton në dëm të shqiptarëve komune.

A.H.



RENDITJA E USHTARËVE NË GJI

Nikozi, 17 janar

Në territorin e Gjirit ndodhen afro një milion e dyqind mijë ushtarë. Sipas vlerësimeve më të reja të Pentagonit, numri i ushtarëve irakianë në vetë Kuvajtin a në afërsi të tij ka arritur në më se 540 mijë. Atyre, në tokë dhe det u kundërvihen afro 615 mijë ushtarë nga përberja e forcave multinacionale. Iraku ka edhe 480 mijë rezervistë. Nga shtetet e NATO-s forcat më të mëdha i kanë SHBA-të - afro 425 mijë ushtarë. Nga këta 245 mijë janë ushtri tokësore, 75 mijë marinca, 60 mijë pjesëtarë të marinës dhe 45 mijë të forcave ajrore.

Britania e Madhe ka dërguar në Gji 34 mijë ushtarë Franca 13.500. Afro 100 mijë ushtarë të armatës turke janë të dislokuar në afërsi të kufirit irakian, si dhe 35 mijë xhandarë dhe policë. Kanadaja ka dërguar në Gji 1700 ushtarë, kurse forca më të vogla edhe Danimarka, Greqia, Italia, Holanda, Norvegjia dhe Spanja. Nga vendet e Gjirit dhe aleatëve arabë, Arabia Saudite ka 118 mijë ushtarë, Egjipti 40 mijë, në Arabinë Saudite dhe 5000 në Emiratet e Bashkuara Arabe. (Rojter)

ÇMIMI I LUFTËS NË GJI

DERI NË 86 MILIARDË DOLLARË

Vlerësimet më të vogla mbështetën në konfliktin ushtarak që do të zgjaste më pak se një muaj dhe në të cilin më i angazhuar do të ishte aviacioni amerikan. - Në këtë variant amerikanët do të kishin nja 3 mijë të vrarë e të plagosur dhe nja 200 tanke të dëmtuara dhe nja 100 aeroplanë

Uashington, janar

Lufta në Gji mund t'u kushtojë SHBA-ve, midis 28 e 86 miliardë dollarë, varësisht nga gjatësia dhe intensiteti, kumtoi këshilli për buxhet i kongresit. Në vitin vijues fiskal (deri më 30 shtator), operacioni «mburoja shkretinore» mund të kushtojë prej 17 deri në 35 miliardë dollarë, parashikon këshilli. Çdo vit tjetër do t'i kushtonte arkës amerikane prej 11 deri në 51 miliardë dollarë, e këto shpenzime do t'i diktojë harxhimi i municionit dhe zëvendësimi i pajisjeve të shkatërruara.

Vlerësimet më të vogla mbështetën në konfliktin ushtarak që do të zgjaste më pak se një muaj dhe në të cilin më i angazhuar do të ishte aviacioni amerikan. Në këtë variant amerikanët do të kishin nja 3 mijë të vrarë e të plagosur dhe nja 200 tanke të dëmtuara dhe nja 100 aeroplanë (disa dhjetra tanke), të cilët ëprbëjnë 8 për qind të flotës amerikane.

Vlerësimi pesimist parashikon një luftë gjashtëmuajshe dhe përsëritjen e sulmeve në tokë. Humbjet do të arrinin në 45 mijë të vrarë e të plagosur, në 900 tanke e 600 aeroplanë. Këshilli i Kongresit konsideron se prania e 400 mijë ushtarëve në vitin 1991, pa angazhim të vërtetë në luftë, çmimin e luftës do ta ngrentë në lartësi prej 16 deri në 25 miliardë dollarë.

Nëse do të qetësohet situata, e SHBA-të do të arrijnë që numrin e ushtarëve ta reduktojnë në 100 mijë deri në fund të vitit, shpenzimet e sivjetme të luftës do të ishin prej 14 deri në 18 miliardë dollarë.

LINDJA E AFËRT ZONË EKSPLOZIVE

LUFTË TASH E 40 VJET

Nikozi, 17 janar

Lindja e Afërt tash e 40 vjet është fushëbetejë. Nga viti 1948 e deri sot në rajon janë zhvilluar shtatë luftëra të mëdha.

1948 - Shpërthen lufta arabo-izraelite rreth copëtimit të Palestinës dhe themelimit të Izraelit.

1946 - Britania, Franca dhe Izraeli sulmojnë Egjiptin pasi që Gamal Abdel Naseri kishte nacionalizuar kanalin e Suezit. Intervenojnë SHBA-të dhe BRSS, duke ndërprerë armiqësinë.

1967 - Pas shkallëzimit shumëmuajsh të armiqësive, Izraeli sulmon egjiptin, Jordaninë dhe Sirinë. Izraeli në luftën gjashtëditëshe okupoj Sinain, Bregun Perëndimor dhe Gazën.

1973 - Egjipti dhe Siria papritmas sulmojnë Izraelin me qëllim që të pushtonin territorin e humbur. Izraeli më vonë në suaza të marrëveshjes paqësore me Egjiptin, heq dorë nga Sinai.

1975 - Në Libanë shpërthen lufta qytetare. Për 15 vjet lufte janë vrarë afro 150 mijë njerëz.

1980-1988 - Lufta ndërmjet Irakut dhe Iranit. Pas një milion viktimitash, të dy palët, duke hequr dorë nga pretendimet territoriale lidhur paqe në çka ndërmjetësuan edhe Kombet e Bashkuara. 1982 - Izraeli sulmon Libanin për të shkatërruar vendstrehimet palestineze. Organizata Çlirimtare Palestineze tërheq luftëtarët e vet jashtë vendit. Izraeli më vonë tërheq pjesën dërrmuese të ushtarëve të vet. Formohet «zona e sigurisë» në Libanin Jugor që Izraeli të sigurohej nga aksionet e ardhshme të komandosëve.

U BOMBARDUA EDHE E ASRA

Qendrat vitale dhe strategjike irakiane në Bagdad, por edhe në Basra janë cak i sulmeve të fuqishme të aviacionet amerikane bën të ditur sot në mëngjes Radio-Eherani.

Në emisionin e Radio-Iraniane saktësohet se Bagdadin dhe Basrën e kanë bombarduar avionët amerikanë B 52 dhe kaqatorët bombardues «Furtif 177». Në lajmin e Radios Iraniane konstatohet, pa komentim, se «lufta në Gjirin Persin», ka filluar të enjten në agim.

Sipas një komunikate të Ministrisë irakiane të Mbrojtjes, Bagdadi urdhëroi nëpërmjet radiostacioneve brezin e lindur në vitin 1954, 1955 dhe 1956 që të paraqiten gjatë 3 ditëve të ardhshme në qendrat e rekrutimit.

I goditur nga një sulm fuqishëm ajror sot herë në mëngjes, shtatmadhuria e aramatës irakiane dhe urdhërin për t'u përforcuar armata e rregullt që i ka një milionë njerëz. «Lufta filli sot», njoftoi Radioja Irakiane dhe shtoi «do t'u japim mësim Amerikës dhe aleatëve të saj».

Në javët, të cilat i paraprinë zjarrit të luftës, Iraku rekrutoi rezervistët e lindur në vitin 1957.

BAGDADI BOMBARDOHET NË ÇDO 10-15 MINUTA

Uashington, 17 janar

Sipas raporteve të fundit të reporterit të rrjetit TV S-En-En (CNN) nga Bagdadi, bombardimi i kryeqytetit të Irakut po vazhdon në intervale prej 10-15 minutash. Vlerësimet e reporterit janë se aeroplanët - bombardues të forcave shumëkombëshe në këto sulme janë drejtuar nga periferia e Bagdadit.

Sipas deklaratave të dëshimtarëve, të cilët i citon CNN, në bombardimet e deritashme u rrënu një krah i Ministrisë së Mbrojtjes, u dëmtua një pjesë e ndërtesës në të cilën është selia e partisë BAAS të Irakut, ndërsa Pallati Presidencial është i padëmtuar, përkatësisht me gjasë as që u bombardua. Aeroporti ndërkombëtar i Bagdadit gjithashtu nuk është dëmtuar.

PËR IRAKUN ENDE S'KA FILLUAR LUFTA

- tha ambasadori irakian në Madrid

Madrid, 17 janar

Ambasadori irakian në Madrid, Arshad Tafik deklaroi në konferencën e shtypit me gazetarë të këtuashëm se «për Irakun lufta ende s'ka filluar», se Iraku ende s'ka përdorë «të gjitha armët e veta» dhe teknikën e vet.

Ambasadori irakian theksoi se amerikanët hynë në këtë luftë ngaqë «të parët i humbën nervat», kurse tash «që të gjithë do të mund të binden se ajo luftë do të zgjas shumë».

Sipas fjalëve të diplomatit amerikan janë «të rrejshme pohimet e Uashingtonit se nga sulmet e deritashme të aviacionit amerikan Irakut i janë shkaktuar dëme të mëdha. Ajo që është e vërtetë, tha ai, është fakti se ka numër të madh viktimitash ndër civilë, më shumë sesa ushtarakë».

Ambasadori irakian në Madrid, gjithashtu, deklaroi se ameriaknët në këtë luftë «i kanë humbur pozicionet e veta në botën arabe për 50 vjet të ardhshëm».

LUFTIME TË FORCAVE TOKËSORE

Radio-Bagdadi përgënjeshtron

Arabi Saudite, Bagdad 17 janar

Në kufirin e Kuvajtit dhe të Arabisë Saudite filluan në mëngjes në orën 3,30 sipas Grinviçit luftimet e njësive tokësore të Irakut dhe të forcave shumëkombëshe, njofton Frans Pres duke i referuar ministrisë kuvajtiane të Informatave. Tash për tash nuk dihet se kush e filloi sulmin i pari.

Luftimet e njësive të blinduara po vazhdojnë, siç thuhet, tash dy orë.

Forcat shumëkombëshe, thotë përfaqësi i ministrisë kuvajtiane të informatave, asgjësuan dy baza të vetme ajrore irakiane në Kuvajt.

Funksionarët amerikanë në Dahrnan refuzuan të vërtetojnë apo të përgënjeshtrorin këtë informata.

Pas SHBA-ve edhe Iraku përgënjeshtror se kanë filluar luftimet e forcave tokësore në kufirin kuvajtiano-saudit, bën të ditur agjencia Rojter.

Duke transmetuar kumtesën e Komandës ushtarake irakiane për rrëzimin e 14 avionëve të forcave multinacionale, Radio-Bagdadi shtoi se deri në atë çast (koha 9,30 sipas kohës së Evropës së Mesme) «nuk janë hetuar operacione të forcave tokësore armiqësore».

Radio-Bagdadi, njëkohësisht fton qytetarët dhe forcat e armatosura të Irakut që të respektojnë ligjet dhe fenë e vet dhe mos të maltretojnë apo vrasin robërit.

Siç bën të ditur AFP, lajmin për luftime tokësore sot në Riad e përgënjeshtror edhe gjenerali francez Mishel Rokzhof.

SADAM HYSEINI SHËTITI RRUGËVE TË BAGDADIT

Aman, 17 janar

Duke u inatosur me forcat aleate që valë-valë po bombardojnë kryeqytetin irakian, kryetari Saddam Hysein sot shëtit rrugëve të Bagdadit, bën të ditur Radio - Bagdadi.

Kryetari, shton Radio-Bagdadi, ka vizituar edhe selinë e forcave ajrore dhe kundërajrore të cilat, në mbështetje të burimeve perëndimorë, janë të dëmtuara rëndë gjatë sulmeve të deritashme.

Radio-Bagdadi nuk tha kurrfarë shënimesh për dëmet nga bombardimet.

Një teknik televiziv perëndimor e pa sot rreth orës 4 të mëngjesit, sipas kohës jugosllave, (6.00 sipas Greniqit) në qendrën TV të Bagdadit presidentin irakian Saddam Hysein, njofton Si-En-En.

Sadam Hyseini, sipas dëshmisë së teknikut, dukej «i vendosur» (Rojter)

IRANI PËR LUFTËN E RE NË GJI

BRENGOSJE E THELLË DHE KUJDES

Sekretari i Këshillit suprem kombëtar për sigurim Hasan Ruhan ka deklaruar në Radion shtetërore se Irani pret që «humbjet e numrit të njerëzve do të jenë të mëdha

Teheran, 17 janar

Irani sot shfaq brengosje të thellë për shkak të fillimit të luftës në Gjirin Persi dhe, njëherit, vlerësoi se viktimat do të jenë shumë të mëdha.

Kryetari Hashemi Rafsanxhani ka reaguar i pari, duke shfaqur në deklaratën dhënë Radios së Teheranit «brengosje të thellë për shkak të konfrontimit dhe viktimitave në njerëz». Luftën e quajti «grusht mbi jetën e njerëzve dhe resurset rajonale.»

Derisa Parlamenti që nga mëngjesi është tubuar pas dyerve të mbyllura, sekretari i Këshillit suprem kombëtar për sigurim Hasan Ruhan i ka deklaruar Radios shtetërore se Irani pret që «humbjet në njerëz do të jenë mjaft të mëdha».

«Shpresojmë se lufta do të marrë fund së më parë që është e mundur dhe se paqja do të kthehet në rajon» - tha Ruhan.

Opinionin iranian me brengosje po i ndjek lajmet nga Iraku dhe Kuvajti, mirëpo nuk është i befusuar. Këtu me ditë ka qenë e qartë se çka mund të ndodhte pas insistimit këmbëngulës irakian për të vazhduar okupimin e Kuvajtit.

Një kumtesë populit i ka arritur nga Komanda supreme, e cila me komunikatë të veçantë ka saktësuar politiken më parë të proklamuar të Teheranit se në konfliktin e armatosur do të qëndrojë anash.

Komanda, po ashtu, ka tërhequr vërejtjen se forcat e armatosura të vendit janë plotësisht të gatshme për të mbrojtur «kufijtë e shenjtë iranianë» dhe se asnjë palë nuk do t'i lejohet që për veprime eventuale luftarake të shfrytëzojë territorin e Iranit, hapësirën ajrore dhe detin e kësaj republike islamike. (Tanjug)

SHTËPIA E BARDHË NËN MBROJTJE TË FORTË POLICORE

Uashington, 17 janar

Derisa në Uashington po mbretëron rendi dhe paqja, sikur nuk ka ndodhur asgjë, Shtëpia e Bardhë ndodhet nën mbrojtje të fortë të policisë dhe «Sekret Servisit» - të shërbimit të veçantë që siguron politikanët e rëndësishëm dhe personalitetet e tjera.

Në vendin e ngjarjes mund të shihen forca të mëdha policore në automobila, motoçikleta dhe kuaj, kurse automobilat policorë dhe autobusët qartazi të huazuar turistikë mbi të cilët shkruan «të gjitha për qytetin», janë të paguar asisoj që paraqesin mbrojtje të shtuar të rezidencës së kryetarit amerikan. (Tanjug)

ÇEJNI - NUK E KEMI NDJEKUR SADAM HYSEININ

Uashington, 17 janar

«Qëllimi i operacioneve të mbrëmshme të forcave shumëkombëshe në Gji s'ka qenë zënia e Sadam Hyseinit», deklaroi sot në mëngjes ministri amerikan i Mbrojtjes, Dik Çejni.

Duke folur në konferencën e shtypit në Pentagon, Dik Çejni tha se «ne vërtetë nuk e kemi ndjekur Sadam Hyseinin. Çejni vlerësoi se gjatë operacionit «u arrit shkallë shumë e lartë e befasisë taktike».

Duke paraqitur shumë pak të dhëna për vetë operacionin, Çejni tha se sulmi i mbrëmshëm ka qenë i orientuar vetëm kundër objekteve ushtarake, e se «kijet kujdes përjetën e ushtarëve amerikanë dhe aleat, por edhe të civilëve irakianë».

Kryeshefi i shtatmadhorisë të forcave të armatosura amerikane, Kolin Paul theksoi në konferencën e njëjtë të shtypit se ende s'ka të dhëna për vlerësimin e dëmit nga bombardimi i aleatëve. Ai saktësoi se operacionet ajrore dhe bombardimi do të vazhdojnë «deri në fund». (Tanjug)

KUMTESA E PARË E KOMANDËS USHTARAKE IRAKIANE

U SULMUAN EDHE PJESËT E BANUARA TË BAGDADIT

Nikozi, 17 janar

Komanda e armatës irakiane kumtoi sot në mëngjes se «avionët armiqësorë» kanë sulmuar caqe ushtarake dhe civile në Irak.

Në «kumtesën nr.1», të cilën e transmetoi Radio-Bagdadi në orën 7.30, sipas kohës lokale, (5,30 sipas kohës së Evropës së Mesme), Komanda ushtarake irakiane, thekson se sulmi ajror ka nisur në orën 2,30, sipas kohës lokale (23,30 sipas kohës së Evropës së Mesme) dhe se ende po zgjatë.

KUMTESA E UASHINGTONIT PËR NISMËN E LUFTËS ËN GJI

Uashington, 17 janar

Kumtesa e parë e Shtëpisë së Bardhë për nismën e luftës në Gji ishte mjaft e shkurtër. Teksti i tërësishtëm i kumtesës është si vijon:

«Çlirimi i Kuvajtit ka nisur. Në bashkëveprim me forcat e aleatëve tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë hedhur në operacion nën shifrën «stuhia e shkretëtirës», për të jetësuar vendimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në orën 19 sipas kohës amerikane, përkatësisht në mesnatë sipas kohës së Evropës së Mesme, forcat e angazhuara në operacionin «stuhia e shkretëtirës» kanë sulmuar caqe në Kuvajt dhe Irak.

Kryetari Xhorxh Bush do t'i drejtohet kombit në orën 21 sipas kohës amerikane». (Tanjug)

GADAFI: DUHET PËRKUFIZUAR NË ÇLIRIMIN E KUVAJTIT

Nikozi, 17 janar

Prijësi i Libisë Moamer Gadaf deklaroi sot se aksioni ushtarak i forcave multinacionale në Gji nuk duhet të shkojë më larg nga dëbimi i trupave irakiane nga Kuvajti? bënë të ditur agjencia Rojter duke i referuar agjencisë Xhanu të Libisë.

Gadafi po ashtu konsideron se duhet ndërprerë sulmet ajrore mbi Irakun dhe duhet kufizuar operacionet ushtarake në territorin e Kuvajtit.

Kombet e Bashkuara nuk guxojnë të lejojnë që çlirimi i Kuvajtit të shfrytëzohet për «qëllime private», shtoi Gadafi në letrën dërguar sekretarit të përgjithshëm të KB Peres De Kuellar disa orë pas sulmit ajror të forcave aleate mbi Irakun. (Tanjug)

HUMBJET E ALEATËVE - SHUMË TË VOGLA

Baza ajrore britanike në Gji, 17 janar

Komandanti i eskadriles britanike në Gji Dejvid Henderson deklaroi sot se aleatët pësuan «humbje shumë të vogla» në sulmet e deritashme ajrore në Irak, njofton Rojter.

Hendersoni refuzoi të saktësojë numrin e viktimitave. Sulmet ajrore, sipas fjalëve të tij, «ishin jashtëzakonisht të suksesshme.»

U DORËZUAN 50 EKIUPAZHE TANKISTE IRAKIANE

Uashington, 17 janar

Nja 50 ekuipazhe tankiste irakiane iu dorëzuan sot forcave shumëkombëshe afër kufirit saudit-kuvajitian - lajmëron nga Arabia Saudite rrjeti televiziv Si-En-En (CNN), duke u mbështetur në burimet shtetërore.

Të njëjtat burime thonë se një numër i madh ushtarësh irakian në Kuvajt hoqi uniformat dhe u përpoq të përzihet me civilë.

Reporterit i Si-En-En-it thekson se nuk ka vërtetime zyrtare të këtyre informatave.

GIATË SULMIT TË PARË AJROR NË IRAK DHE KUVAJT

U HODHËN 18.000 TONË BOMBA

Uashington, 17 janar

Së paku 18.000 tonë bomba janë hedhur mbi Irak në sulmin e parë të sontëm të rrufeshëm të forcave aleate, bën të ditur Si-En-En, duke iu referuar burimeve në Pentagon.

Rrjeti amerikan televiziv Ej-Bi-Si informon se bombardimet e rënë B-52 kanë goditur pozicionet e njësive elite irakiane - të gardës republikane.

Pentagoni nuk ka saktësuar pjesëmarrjen e bombarduesve B-52 në operacione, duke theksuar se është tepër herët për vlerësimin e humbjeve ndër luftëtarët më të mirë të Sadam Hyseinit. (Tanjug)

U FORMUA SHTABI I KRIZËS NË TURQI

Ankara, 17 janar

Në Ministrinë turke të Punëve të Jashtme është formuar shtabi i krizës, kumtoi Ministria fill pas shpërthimit të luftës në Gji.

Kurrfarë veprimtarish të veçanta në natën që shkoi nuk hetuan në Ankara.

Nuk ka kurrfarë informacionesh për situatën në kufirin turko-irakian, ku ndodhën afro 120.000 ushtarë turq kundruall 100.000 ushtarë irakianë.

Autoritetet turke të hënën përsëritën se Turqia nuk do të hidhet në sulm po qe se nuk sulmohet. (Tanjug)

DEMONSTRATA KUNDËR LUFTËS ANEKËND AMERIKËS

Uashington, 17 janar

Në shumë qytete të Amerikës, në Uashington, Nju-Jork, Los-Anxhelos, San-Francisko e gjetiu u organizuan demonstrata kundër luftës në Gji. Në protesta, siç njofton rrjeti TV amerikan Si-En-En (CNN), po marrin pjesë mijëra njerëz, të cilët po brohorisin parulla kundër luftës

Në Los Anxhelos një grup i demonstruesve u përpoq të hynë në ndërtesën e qeverisë së qytetit, por policia pengoi aksionin e tyre. (Tanjug)



## OPERACIONI «FURTUNA SHKRETINORE»

## MINUTË PAS MINUTE

Prej fillimit të operacionit «Furtuna shkretinore» ngjarjet rrodhën kështu sipas kohës sonë:

– E enjte (0040): Breshëri të baterive kundërajrore çajnë qiellin mbi Bagdadin, dëshmojnë reporterët e Televizionit amerikan. Jehojnë shpërthimet e fuqishme.

– E enjte, 1.06: Forcat shumëkombëshe sulmuan Irakun, kumton zyrtarisht Uashingtoni. «Çlirimi i Kuvajtit» filloi në mesnat, thotë përfaqësuesi i Shtëpisë së Bardhë, Marlin Ficatore dhe shton se «forcat e përfshira në operacionin «furtuna shkretinore» sulmojnë objektiva në Kuvajt dhe në Irak».

– 1.55: Njësitë e armatës britanike u përfshinë në luftën kundër Irakut – kumton Ministria britanike e Mbrojtjes.

– 2.15: Bomba bien në Bagdad, në çdo 15 minuta. Aeroplanët gjuajnë objektiva shumë të saktë – njoftojnë reporterët e CNN.

– 2.30: Kjo është vetëm fillimi, SHBA-të nuk mendojnë se do të jetë lehtë, thotë zëvendësi i Shtëpisë së Bardhë.

– 2.30: «Pothuaj të gjithë objektivat kimike dhe bërthamorë janë asgjësuar» – njofton rrjeti TV amerikan NBC.

– 3.00: Kryetari Bush shpreh vendosmërinë e Amerikës që ta zhdukë potencialin atomik të Irakut dhe armët e tij kimike. Saddam Hyseini e filloi këtë luftë të egër duke e pushtuar Kuvajtin më 2 gusht – shton kryetari amerikan.

– 3.00: Një raketë irakiane «Skud» është shkrehur në drejtim të Riadit, por, pas të gjitha gjasave, bie jashtë qytetit, pohojnë burimet diplomatike.

– 3.40: Sekretari amerikan i Mbrojtjes Dik Çejni, deklaroi se katër vende janë të angazhuar në këtë operacione luftarë – SHBA-të, Britania e Madhe, Arabia Saudite dhe Kuvajti.

– 4.50: Janë sulmuar instalimet e raketave në perëndim të Irakut, pohon Izraeli. Sulmet ajrore mbi Irakun dhe mbi instalimet irakiane në Kuvajt nuk do të pushojnë – kumton shefi i shtatmadhorisë së bashkuar të ushtrisë amerikane Kolin Pauell. Ai shton se aeroplanët aleatë «nuk e ndjekin» Saddam Hyseinin.

– 4.55: Forcat ajrore franceze do të marrin pjesë në operacionin për çlirimin e Kuvajtit «kur të vijë çasti» – kumton Parisi.

– 5.00: Forcat aleate e kanë asgjësuar pothuaj tërë aviacionin irakian pa humbjen e asnjë mjeti fluturës – njoftojnë rrjetet televizive amerikane duke e cituar Pentagonin.

– 5.10: Një pjesë e madhe e gardës presidenciale e njësisë elite irakiane, të vendosura në zonën e Basrës, është asgjësuar, – pohojnë burime të Pentagonit.

– 5.15: Kryetari irakian Saddam Hysein porositi nëpërmjet Radio-Bagdadit se «populli irakian do t'i mund të pafetë dhe aleatët e tyre».

– 5.40: Në Bagdad është qetë – njoftojnë reporterët e CNN nga kryeqyteti i Irakut. Nga hoteli, në të cilin janë të vendosur ata, nuk shihen gjurmë të dëmeve.

– 5.50: 45 gjuajtës – bombardues britanikë «Tornado» të cilët morën pjesë në bombardimin e parë të Irakut, u kthyen pa humbje në baza në Arabinë Saudite dhe në Bahrein, – thonë burimet britanike të Gjirit.

## OPERACIONI «SHTRËNGATA NË

## SHKRETËTIRË»

– ORA 05.00: filluan konsultimet në Këshillin e Sigurimit. Irani ua ndaloi palëve ndërluftuese që të shfrytëzojnë territorin e tij dhe hapësirën e tij ajrore e detare. NATO-ja kumtoi në Bruksel se do ta mbrojë Turqinë në rast të sulmit irakian.

– ORA 05.30: në «kumtesën numër një», komanda e forcave të armatosura irakiane kumtoi se aeroplanët e armikut goditën objektet ushtarake dhe kuartet e banuara dëndur në Bagdad. Sulmet ajrore po vazhdojnë, thuhet në kumtesë.

– ORA 06.30: tanket e forcave shumëkombëshe u përlëshën me autobлиндat irakiane në kufirin kuvajitian – saudit, e aleatët shkatërruan dy bazat e vetme ajrore irakiane në Kuvajt, kumtoi një funksionar i ministrisë kuvajtiane të informatave në emigrim. Amerikanët as nuk e vërtetuan, as nuk e përgënjeshtrojnë këtë informata.

– ORA 07.00: kryetari francez Miteran mori vendim për angazhimin e njësisë franceze nën komandën amerikane, njoftohet në Paris.

– ORA 07.15: Saddam Hysein u pa në televizionin e Bagdadit njoftojnë reporterët e Si-En-En-it.

– ORA 07.20: Filloi sulmi i ri ajror në Bagdad e rrethinë njoftojnë reporterët e Si-En-En-it. Po gjëmojnë të shtënë kundër artilerisë ajrore. Dy shpërthime të fuqishme dridhën hotelin «Rashid», në të cilin janë vendosur gazetarët amerikanë. Nga Arabia Saudite sërish po fluturojnë aeroplanët e aleatëve.

– ORA 07.30: Këshilli i Sigurimit miratoi vendimin që për shkak të situatës në Gji të mbajë mbledhje të vazhdueshme. Ambasadori amerikan në KB deklaroi se «Iraku ende mund t'u shmangët shkatërrimeve të mëtejshme» përmes tërheqjes nga Kuvajti.

– ORA 08.00: televizioni saudit përgënjeshtroi se raketa irakiane «Skud» goditi Riadin. Në kryeqytetin e mbretërisë sirenat që paralajmërojnë sulmin ajror u dëgjuan tri herë gjatë natës së kaluar.

– ORA 08.15: Pentagoni kumtoi se janë planifikuar më së paku 1.300 fluturime të aeroplanëve në 24 orët e para të ofensivës kundër Irakut.

Dymbëdhjetë «jaguarë» francezë sulmuan aeroportin ushtarak në Kuvajt para ditë, kumtoi ministri francez i mbrojtjes Zhan Pjer Shevenman. U goditën katër aeroplanë, një pilot u lëndua lehtë, por që të gjithë u kthyen në bazë. Ministri po ashtu kumtoi se me komandën amerikane është arritur ujdia që trupat franceze të mos marrin pjesë në luftime në territorin irakian. Forcat tokësore ende nuk janë angazhuar, tha më tej Shevenmani.

– ORA 08.50: tri bomba goditën ministrinë irakiane të mbrojtjes, njofton korrespondenti i Bi-Bi-Si-së nga Bagdadi. Qyteti, sipas raportit të tij, është shkatërruar tmerrshëm.


– ORA 09.15: aertileria irakiane sulmoi rafinerinë e naftës në Bregun Lindor të Arabisë Saudite, njoftoi gazetari i Bi-Bi-Si-së nga Riadi, duke u mbështetur në burimet britanike në Gji.

– ORA 09.30: komanda e forcave të armatosura irakiane në kumtesën numër 2 kumtoi se mbrojtja kundërajrore irakiane rrëzoi 14 aeroplanë të armikut.

– Kryetari sovjetik Mihail Gorbaçov deklaroi se një orë para fillimit të operacioneve luftarake u informua për këtë. U përpoq që në kontakt me Xhorxh Bushin e me Saddam Hyseinin ta pengojë konfliktin.

## IRAKU RRËZOI 14 AEROPLANË

Radio-Bagdadi thotë se aeroplanët e forcave shumëkombëshe u rrëzuan në duele ajrore dhe me zjarr të mbrojtjes kundërajrore



Fotografia e komandantit edhe në tank

Bagdad, 17 janar  
Iraku sot kumtoi se ka rrëzuar 14 aeroplanë të forcave shumëkombëshe, të cilat mbrëmë sulmuan Irakun e Kuvajtin.

Në kumtesën e komandës ushtarake irakiane të cilën e shpalli Radio-Bagdadi, thuhet se aeroplanët e forcave shumëkombëshe u rrëzuan në duele ajrore dhe me zjarr të mbrojtjes kundërajrore.

«Shqiponjat tona të guximshme (Pilotët) dhe njerëzit e mbrojtjes kundërajrore deri tash rrëzuan 14 aeroplanë të armikut të llojeve të ndryshme», thuhet në kumtesën e komandës ushtarake.

Komanda ushtarake irakiane thotë se garda presidenciale e Saddam Hyseinit në Bagdad rrëzoi tre aeroplanë. Siç njofton Rojeteri, në këtë mënyrë dëshmohej se pallati presidencial ishte një nga objektet e sulmit të forcave shumëkombëshe.

Gjatë sulmit të forcave shumëkombëshe kundër Irakut u rrëzua një aeroplan amerikan, njofton rrjeti TV Si-En-En, duke u referuar funksionarëve të lartë amerikanë.

Si-En-En i referohet Sem Nanit, kryetar i Komitetit për forca të armatosura në senatin amerikan. Lajmin për rrëzimin e aeroplanit e konfirmoi, kinse, edhe ministri amerikan i Mbrojtjes, Dik Çejni. Lloji i aeroplanit nuk u kumtua.

Një kaçator britanik i llojit Tornado, i cili mori pjesë në valën e dytë të sulmit të forcave shumëkombëshe, evidencohet i zhdukur, njofton agjencia gazetares britanike, Pres Asocijshën, duke i referuar qarqeve ushtarake britanike.

Ndërkohë, në Paris Ministri i Mbrojtjes Pjer Sevanman ka kumtuar se sot një pilot francez është plagosur lehtë më rastin e misionit luftarak të avionëve francezë në Kuvajt. Në sulm merrnin pjesë 12 «jaguar» dhe që të gjithë u kthyen në baza, mirëpo katër u dëmtuan, njëri më seriozisht. Në këtë avion u plagos piloti francez familjen e të cilit e informuan menjëherë.

Avionët francezë kanë marrë pjesë në bombardimin e aeroporteve në Kuvajt, rreth të cilave ishin të shpërndara raketat «Sam-6», «Sam-8» dhe «Skud», si dhe mitrolozet dhe bateritë kundërajrore, që nuk mund të neutralizoheshin me elektronikë.

Franca sot në mëngjes hyri në luftë me 18 mijë ushtarë prej të cilëve 11 mijë janë pjesëtarë të këmbësorisë dhe të njësisë të motorizuara. Trupat franceze në Gji i përbëjnë edhe 2500 automjete të luftës, prej të cilave 500 të blinduara, si dhe 40 avionë të luftës, 110 helikopterë dhe 11 luftanije.

## MATURI E MINISTRIT BRITANIK TË MBROJTJES

## NUK DIHET Ç'DËME IU BËNË IRAKUT

Aviacioni irakian, sipas të gjitha gjasave, shpëtoi

Londër, 17 janar  
Ministri britanik i Mbrojtjes Tom King shfaqti sot kënaqësinë për rezultatet e para të operacioneve ushtarake kundër Irakut, por njëkohësisht i tërhoqi vërejtjen opinionit dhe gazetarëve se nuk duhet qenë euforikë dhe (se e le çdo gjë është e mundshme).

Gjykuar sipas fjalëve të tij, ende nuk dihen rezultatet e sulmeve të mbrëmshme e të sotme ajrore në Irak. Kinë vërtetoi raportet se shumica e aeroplanëve irakianë para sulmeve e dislokuan. Andë nuk dihet sa dhe a është «dëmta» aviacioni irakian, sep-

se asnjë aeroplan irakian nuk është ngritur në ajër për t'i pritur sulmuesit.

Kingu u tha gazetarëve se duhet qenë shumë të matur, sepse armata irakiane është e madhe, e armatosur mirë dhe ka në dispozicion, siç tha ai, disa prej «armëve më të tmerrshme». Ai pa aqiti te zën se rezistenca e dobët irakiane ditën e parë të luftës ndoshta është rezultat i vendimit irakian që forcat t'i ruajë për fazat e mëvonshme të konfliktit.

Ministri britanik i Mbrojtjes nuk vërtetoi lajmet se në sulme janë shkatërruar bazat e raketave irakiane me rreze të gjatë veprimi

të tipit «Skud» dhe në të vërtetë nuk dha informata të sakta për asnjërin prej qaveve të mundshme të sulmeve ajrore të forcave shumëkombëshe.

Maturia e Tom Kingut në Londër shpjegohet si pasojë logjike e mungesës së të dhënave të duhura e të sakta për rezultatet e bombardimeve të sotme. As amerikanët, as britanikët nuk kumtuën se çka sulmuan dhe a shkatërruan diç.

E vetmja gjë që është e qartë nga fjalët e Tom Kingut është se sulmet ajrore në Irak do të vazhdojnë dhe se po afrohet gjithnjë e më shpejt çasti kur do të fillojë edhe betaja në tokë.

## SIPAS TV-SË IRANIANE

## IRAKIANËT SULMUAN POZICIONET EGJIPTIANE

Nikozi, 17 janar  
Televizioni Iranian kumtoi sot, duke i referuar qarqeve të pavarura, se 18 kaçatorë irakianë sulmuan pozicionet egjiptiane në Arabinë Saudite, njofton Rojter.

Thuhet, gjithashtu, se irakianët shkrepën katër raketat «Skud» në Bahrein, si dhe predha në rafinerinë Haf-xhi dhe në rajonin e Hishamit në Arabinë Saudite.

Televizioni Iranian gjithashtu pohon, duke i cituar burimet e pavarura në Gji, se sot në mëngjes në ujërat e Gjirit rrëzoi një kaçator amerikan «F-15» e se piloti ia doli të shpëtojë.

## APELI I PRINCIT KUAJTIAN

## TË ANGAZHHEMI PËR KTHIMIN NË ATDHF

Manamë, 17 janar  
Princi kuvajitian, kryeministri Sheik Saad-al-Abdalah al-Sabah, thirri sot kuvajitianët që, me çmim të viktimitave, të luftojnë një drejtat e veta legjitime dhe çlirimin e atdheut.

Në reagimin e parë zyrtar kuvajitian lidhur me luftën në Gji theksohet, po ashtu, se «regjimi irakian edhe më tej po injoron apelen e Bashkësisë ndërkombëtare për paqë dhe ndërprerjen e gjakderdhjes».

Princi me bashkatdhetarët e vet, siç bën të ditur Kuna, ka porositur se «jemi në të fortë se forcat okupuese, ngase po e mbrojnë atdheun dhe nderin nga agresori dhe tirani».

## GORBAÇOVI FAJËSON SADAM HYSEININ

Moskë, 17 janar  
Kryetari sovjetik Mihail Gorbaçov sot për shpërthimin e luftës në Gji fajësoi presidentin irakian Saddam Hyseinin.

Në drejtimin që i bëri kombit ndërmjet TV-së, Mihail Gorbaçov tha se «refuzimi i udhëheqjes irakiane për të përmbushur kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare për tërheqjen e forcave nga Kuvajti» shkaktoi konfliktin e armatosur.

Gorbaçov tha se BRSS do të bëjë çmos që sa më parë të përfundojë lufta në Gji. (Tanjug)

## AKSIONE TË PAVARURA TË AEROPLANËVE KUAJTIANË

Riad, 17 janar  
Qeveria kuvajtiane në operacion kumtoi sot se 12 aeroplanë kuvajitianë morën pjesë në «aksione të pavarura ditore» kundër objektivave irakianë njofton Rojeteri.

Sipas asaj komunikate, aeroplanët asgjësuan objektiva irakianë dhe u kthyen të sigurt në ora 6.30 GMT (koha jugosllave 7.30) në baza.

Nuk u saktësuan tipat e aeroplanëve që morën pjesë në sulmet.

## U SULMUA REZIDENCA E AMBASADORIT EGJIPTIAN

Aman, 17 janar  
Sot në mëngjes në Aman u sulmua rezidenca e ambasadorit egjiptian në briterinë e Jordani-së. Sulmuesi, për të cilin dëshmohet se është fqinj i diplomatit egjiptian, me gurë theu disa xhama të mëdha në ndërtesë, me gjithë sigurimin e përforcuar rreth përfaqësive e rezidencave diplomatike në Aman. Egjipti në Gji ka nja 40 mijë ushtarë.

## JUGOSLLAVËT EVAKUOHEN NËPËR IRAN

Beograd, 17 janar  
Irani ka lejuar që punëtorët jugosllavë që kanë mbetur në Bagdad të evakuhon nëpër vendkalimin kufitar Hanakim nga ana irakiane dhe Kaser e Shirin nga ana iraniane, bënë të ditur Tanjug. Ky vendkalim kufitar ndodhet nja 200 kilometra në Lindje të Bagdadit dhe evakuimi do të fillojë në atë çast për të lejojnë kushtet.

Iranianet janë të gatshëm të presin dhe pranojnë punëtorët jugosllavë të evakuar. (Tanjug)

## NDALOHEN MANIFESTIMET KUNDËR LUFTËS NË PARIS

Paris, 17 janar  
Prefekti i Parisit ndaloi manifestimet kundër luftës që ishin caktuar për sot në orët e para të mbrëmjes në Sheshin e Republikës. Për protestë të re kundër luftës apelonin nënshkruetit e «Apelet 75», organizues të tubimeve të shumta të ngjashme ditëve të kaluara.

Thirrjet për këto manifestime paqësore, të shpallura herët në mëngjes, i përkrabën PK e Francës, fraksionet ekstremiste të saj – Lidhja e Komunistëve Revolucionarë e Lufta Punëtore si dhe centrali në të madh sindikal francez – Konfederata e Përgjithshme e Punës.



PAS FILLIMIT TË LUFTËS NË GJIRIN PERSIK

KONSULTIME BILATERALE NË KËSHILLIN E SIGURIMIT

Kombet e Bashkuara, 17 janar  
Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjatë këtij muaji, ambasadori i Zairit Bagbeni Nzengia sapo ka filluar vargun e konsultimeve bilaterale me përfaqësuesit e katërmbëdhjetë vendeve të tjera anëtare të Këshillit. Qëllim i këtyre konsultimeve është që të hulumtohen mundësitë për aksione të Këshillit në situatën e luftës në Gji.

Sipas fjalëve të ambasadorit kuban, vendi i tij do të kërkojë mbledhje urgjente formale të Këshillit, mirëpo vëzhguesit e këtushëm, së paku për një kohë, konsiderojnë se për këtë ka fare pak gjasa. Lufta, përkujtohet këtu, edhe ka filluar në mbështetje të dokumenteve të miratuara në Këshill, njëmend në një përbërje paksa të ndryshuar, sepse në ndërkohë, nga fillimi i vitit, ka pasur ndërrime të pesë deri dhjetë anëtarëve jo të përhershëm të Këshillit. Kjo, ndërkaq, nuk ndryshon situatën, prandaj gjasat për paqe duhet pritur derisa të paraqitet iniciativa e parë e vulltshme, kurse ajo, tash për tash, do të mund të vinte vetëm nga Bagdadi, që në këtë, çast vështirë mund të pritët.

NË BAGDAD - PA PANIK

Washington, 17 janar  
Në Bagdad, për të dytën herë gjatë 13 orëve të kaluara, jehuan sirenat, por, sulme të reja avionësh të forcave multinacionale nuk ka pasur - bëjnë me dije reporterët e rrjetit televiziv amerikan Si-En-En (CNN). Avioni i fundit që ka fluturuar mbi kryeqytetin e Irakut këtë e bëri para dy orësh.

Reporterët e CNN thonë se në Bagdad është qetë dhe nëpër rrugë nuk ka shenja paniku. Megjithatë, shihen grupe më të mëdha njerëzish me bagazhe në duar që, qartazi, po braktisin kryeqytetin.

Sulmi i mbrëmshëm në Bagdad, si duket, është realizuar me mjaft saktësi. Janë goditur, kryesisht, ndërtesat më të rëndësishme të administratës shtetërore - Ministrisë së Mbrojtjes, selia e paratitë sunduese, BAAS, etj. Në mbështetje të raporteve të deritashme, pallati presidencial, të cilin e mbron një bateri e fuqishme e mbrojtjes kundërrajore, nuk është goditur.

U GODIT RAFINERIA SAUDITE

Washington, 17 janar  
Artileria irakiane sonte ka bombarduar dhe djegur një rafineri më të vogël saudite afër kufirit me Kuvajtin.

Siç bën të ditur rrjeti amerikan TV CNN, artileria irakiane ka goditur rafinerinë afër qytezës Kafxi. Në mbështetje të raporteve të dëshmitarëve, rafineria ka pësuar disa goditje të drejtpërdrejta. (Tanjug)

APELI I OÇP-së DREJTUAR ARABËVE DHE MYSLIMANËVE

HISTORIA NUK DO TË FALË PËRTACËT

Tunis, 17 janar  
Organizata Çlirimtare Palestineze thirrte «arabët», myslimanët dhe forcat që angazhohen për paqe «për t'u kundërvënë «agresionit amerikano-evropian kundër Irakut», bën të ditur agjencia palestineze Wafa që e transmeton Frans pres.

Në reagimin e parë për sulmin amerikan mbi Irakun, OÇP shton se «historia nuk do t'i falë përtacët të cilët nuk i kundërvihen këtij agresioni mbi Irakun dhe kombin arab». (Tanjug)

IRANI U NDALOI PALËVE NDËRLUFTUESE SHFRYTËZIMIN E TERRITORIT TË TIJ

Teheran, 17 janar  
Irani u ka ndaluar të gjitha palëve ndërluftuese në Gji shfrytëzimin e territorit të tij, thuhet sot në mëngjes në kumtesën e komunikuar të Shtatmadhorisë së forcave të armatosura islamike të republikës, bën të ditur AFP.

SIPAS BURIMEVE PALESTINEZE

SADAM HYSEINI ISHTE I GATSHËM PËR KOMPROMIS

Romë, 17 janar  
Përfaqësuesi i OÇP-së në Romë i deklaroi sot Televizionit italian se kryetari irakian, Sadam Hyseini «ishte i gatshëm të kumtonte sot në orën 9 vendimin se pranoni apelin e Papës Gjon Palit II» për tërheqjen nga Kuvajti. Përfaqësuesi saktësoi se për këtë e njoftoi lideri i Organizatës Palestineze, Jaser Arafati «para fillimit» të sulmeve ajrore mbi Bagdad.

Njëkohësisht, shefi i diplomacisë italiane, Gjani de Mikelis u deklaroi gazetarëve se sekretari amerikan i shtetit, Xhejms Bejker e njoftoi për vendimin për luftë 45 minuta para fillimit të sulmeve ajrore kundër objekteve në Irak. (Tanjug)

LUFTA MË E SHKURTËR NË HISTORI - 38 MINUTA

Londër, 17 janar  
Sa do të zgjasë lufta në Gji në këtë çast nuk dihet, por me siguri nuk do të jetë më e shkurtra në histori.

Ky «nder» në librin e rekordeve të Ginisit i përket luftës ndërmjet Britanisë së Madhe e Zanzibarit më 1896, e cila zgjati plotësisht 38 minuta. Flota britanike nën komandën e kontraadmiralit Hari Rovson urdhëroi sultanin e vetëquajtur të Zanzibarit Said Halidi të evakuojë pallatin dhe të dorëzohet. Sulltani këtë e refuzoi, por pas bombardimit 38-minutësh kapitulloi.

Konflikti më i gjatë i armatosur ishte, njofton UPI, «lufta 100-vjeçare» e Anglisë dhe Francës, prej vitit 1338-1453, po që se marshimet e kryqzatave i kundrojnë veçmas. Ndryshe, luftërat e kryqzatave do të kishin përparësi, ngaqë zgjatën gjithsej 195 vjet.

Më e përgjakshme ishte Lufta e Dytë Botërore (1939-45), në të cilën u vranë 54,8 milionë njerëz, ishte ai deri tash konflikti i armatosur më i shtrenjtë, dëmi i përgjithshëm i luftës vlerësohet në 1,5 trilionë dollarë. (Tanjug)

SIPAS ASTROLOGUT TË NJOHUR INDIAN

PAQJA NË GJI - PAS 13 SHKURTIT

Nju-Delhi, 17 janar  
Paqja në Gji do të vendoset pas 13 shkurtit, pohon sot astrologu i njohur indian, Laçman Das Madan. Ai nga mesi i dhjetorit ka paraparë se bisedimet e paqes në gjysmën e dytë të janarit të sivjetmë «do të jenë irelevante» e se lufta është e pashmangshme për shkak se Dielli, Saturni e Marsi u gjenden në vijë të njëjtë.

Madan në Indi është shumë i njohur ndërsa klientët e tij janë shumë politikantë e punëtorë publik të njohur indianë. Ai thotë se ndryshimi i pozitës së trupave qiellor pas 13 shkurtit «paprimitas do të ndryshojë situatën». Sipas parashikimit të Madanit, Bashkimi Sovjetik me atë rast me ndihmën e disa vendeve të tjera do të ndërmerret një aksion të paqes që do të pranohet nga të gjithë andaj do ti kontribuojë edhe ndërprerjes së zjarrit dhe vendosjes së paqes. (Tanjug)

SHBA-të RIVENDOSIN MARRËDHËNIT DIPLOMATIKE ME SHQIPËRINË

Athinë, 17 janar  
Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të rivendosen marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, bën të ditur agjencia gazetareske Asoshteted Pres, duke iu referuar burimeve diplomatike të paidentifikuara në Athinë dhe Tiranë.

Zyrtarët shqiptarë, thekson agjencia, Shteteve të Bashkuara të Amerikës u kanë ofruar trull për ambasadë në afërsi të qendrës së Tiranës. Njëri diplomat shqiptar në Tiranë, i cili kërkoi të mbetet anonim, tha se vendi i tij dhe SHBA-të prej një kohe janë duke biseduar për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, mirëpo nuk saktësoi se kur dhe ku janë zhvilluar ato bisedime.

Diplomatët grekë saktësoan se marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-amerikane së shpejti do të rivendosen, kurse ambasada amerikane në Athinë refuzoi të komentojë këtë lajm.

SHBA-të kanë ndërprerë marrëdhëniet me Shqipërinë dhe kanë vënë veto në hyrjen e saj në Kombet e Bashkuara në janar 1946, pasi që ai vend është shpallur Republik Socialiste popullore. Shqipëria përfundimisht më 1955 u pranua në organizatën botërore. (Tanjug)

PASI IU PLOTËSUA SHUMICA E KËRKESAVE XEHETARËT E VALIASIT NDËRPRENË GREVËN

Tiranë, 17 janar  
Pas bisedimeve me përfaqësues të qeverisë dhe apelit të opozitës së bashkuar dhe pasi që pjesërisht iu përmbushën kërkesat për të cilat para pesë ditësh e hodhën në grevë, 3500 xehetarë të Valiasit përsëri dje në orën 15 e filluan punën.

Xehetarëve iu lejua rritja e pagave për 60 për qind, pensionimi me 50 vjet moshë dhe morën 168 banesa të reja.

L.I.H. SIPAS «RILINDJES DEMOKRATIKE» KËRKOHEM NDARJA E POSTIT TË KRYETARIT TË SHTETIT NGA AI I PARTISË

Tiranë, 17 janar  
Ramiz Alia mund të jetë vetëm kryetar i shtetit por jo njëkohësisht edhe shef i Partisë së Punës të Shqipërisë. Kështu thuhet në numrin e djeshëm të gazetës «Rilindja Demokratike». Në artikullin e Kolec Trabionit gjithashtu kërkohet që simbolet kombëtare dhe ato shtetërore njëherë e përgjithmonë të lirohen nga «veçoritë staliniane». Lidhur me këtë autori propozon që nga flamuri shqiptar të hiqet ylli pesëcepësh. (Tanjug)

RIZA SAPUNXHIU PRITI MINISTRIN IRANIAN

Beograd, 17 janar  
Anëtar i Kryesisë së RSFJ, Riza Sapunxhiu, priti dje ministrin e çështjeve ekonomike dhe të financave të Republikës Islamike të Iranit, Mosen Nourbakhsha, i cili po i prin delegacionit iranian në seancën e Komisionit të përbashkët jugosllavo-iranian për bashkëpunim tregtar, ekonomik dhe teknik që po zhvillohet në Beograd.

Në bisedë nga të dy palët u shfaq kënaqësi për zhvillimin e bashkëpunimit bilateral, në veçanti ekonomik për shkak Iranit është njëri nga partnerët më të rëndësishëm të Jugosllavisë në atë pjesë të botës. Të dy palët shfaqën bindjen se janë kushtet për zhvillim edhe më të vulltshëm në periudhën e ardhshme, veçanërisht të formave më të larta të bashkëpunimit ekonomik, teknologjik, për investime të përbashkëta dhe në fusha të tjera. (Tanjug)

U BURGOS TRUPROJA E JOVAN RASHKOVIQIT

Knin, 17 janar  
Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë sot rreth orës 13.00 në Dërnish burgosën Petar Çupkoviçin, shofer e truproje e kryetarit të Partisë Demokratike serbe dr. Jovan Rashkoviç. Shoferi tjetër i tij, Dragan Batas, nuk u mor në polici, e sipas fjalëve të tij ata nga Knini shkuan në Shibeniç për ta marrë dr. Rashkoviçin.

Lajmin për këtë burgim dr. Rashkoviçit e vërtetoi personalisht. (Tanjug)

TAKIMI I KESB-së NË MALTË

NË SHENJË TË NGJARJEVE NË GJIRIN PERSIK

Romë, janar  
Mbledhja trijavëshe e ekspertëve të 34 vendeve të Konferencës për bashkëpunim e siguri në Evropë (KESB), e cila dje filloi në Maltë, po mbahet «në rajonin mesdhetar e të Lindjes së Afërt, i cili sot është skenë e konfrontimit dramatik». Këtë, në mesazhin drejtuar mbledhjes në kryeqytetin e Republikës së Maltës, në Valetë, e theksoi ministri i Punëve të Jashtme i Italisë Gjani de Mikelis.

Më se 200 pjesëmarrës të tubimit maltes prej dje po diskutojnë

për «zgjdhjen paqësore të marrëveshjeve» ndërmjet vendeve të KESB-së. Në Romë kjo temë konsiderohet indikative për të nesërmen në terrenin e tendosur të Lindjes së Afërt, andaj në qarqet diplomatike mund të dëgjohet edhe vlerësimi se si në Maltë, «pa marrë parasysh a do të ketë luftë apo jo», tashmë po punohet për periudhën «pas Gjirit».

Krahas mesazhit të De Mikelisit po ashtu, është e mundshme të pritët konkluzioni se në Maltë po punohet për Evropën me mendime të drejtuara nga rajoni i Mesdheut.

Me fjalë të tjera, po mendohet për çështjen se si parimet dhe rregullat e reja të jetës së përbashkët në Evropë, të sanksionuar me Kartën paradokohshme të KESB-së në Paris, të barten në «rajonin e tensionuar të Mesdheut e të Lindjes së Afërt». Duke theksuar se Itali hedh poshtë vendosmërisht përdorimin e forcës dhe se me të gjitha fuqitë do të angazhohet për suksesin e tubimit të Maltës, shefi i diplomacisë italiane theksoi se është e pamundshme të mos vihet re koincidenca e përmendur.

NË RAST INTERVENIMI TË ARMATËS NË JUGOSLLAVI

AUSTRIA E GATSHME TË PRANOJË REFUGJATËT NGA SLOVENIA

Vjenë, 17 janar  
Krahinat austriake Shtajerska e Korushka do të mund të pranin rreth 75 mijë refugjatë nga Sllovenia, po që se në atë republikë jugosllave për shkak të intervenimit të armatës, krijohet situatë e ngjashme me luftën civile, shkruan «Standard» i Vjenës.

Duke thënë se në të dy krahinat austriake tash disa javë po bëhen përgatitje intensive të këshillave koordinuese kompetente, gazeta thotë se Shtajerska është e gatshme të pranojë 60 mijë refugjatë, ndërsa Korushka «ka dëshmuar» pranimin e 15 mijë njerëzve. Ata, shkruan pastaj gazeta, do të strehoheshin në shkolla dhe ndërtesa publike.

«Standard» transmeton edhe deklaratat e kryetarit të qeverisë së Shtajerskës, Josef Krajnerit, dhe të udhëheqësit të Këshillit koordinues krahinor Gerold Ortnerit të cilët, duke thënë se shërbimet kujdestare po punojnë pareshur, megjithatë nuk presin se në Slloveni do të ndodhë diçka.

Duke thënë se shërbimet kompetente që nga korriku i vitit të kaluar janë të gatshme për çdo gjë, thotë Ortner, shpreh njëkohësisht bindjen se kufiri shtetëror në Jugosllavi, po që se ndodh diçka, nuk do të mbyllet, duke thënë pastaj se pavarësisht nga kriza në Slloveni duhet llogaritur edhe në faktin se, po që se «fillon zjarri në Kosovë», ai do të përfshijë edhe pjesët e tjera të vendit. (Tanjug)


U SHQYRTUA SITUATA AKTUALE E SIGURISË NË VEND

Vukovar, 17 janar  
Ministri i punëve të brendshme i Kroacisë Josip Bolkovac u takua sot në Vukovar me sekretarin republikan të punëve të brendshme të Serbisë Radmilo Bogdanoviçin. Në bisedimet e shefave të shërbimeve republikane të punëve të brendshme të Kroacisë e të Serbisë morën pjesë edhe ndihmësmistrat Josip Perkoviç dhe Stjepan Peçevsi, si dhe ndihmësit e sekretarëve republikanë Jovica Stanishiq dhe Radomir Shujeranoviç.

Sipas kumtesës së ministrit të punëve të brendshme të Republikës së Kroacisë, në takim u shqyrtua situata aktuale e sigurisë në vend, e iu bë një vështrim i veçantë pengimit të aktiviteteve kundërligjore si dhe ndërmarrjes së masave e veprimeve lidhur me këtë. U shprehën pikëpamje të hapta, e vëmendje e veçantë iu kushtua propozimeve të të dy palëve për vazhdimin e bashkëpunimit sa më të mirë në të ardhmen. (Tanjug)

BOTIMI JASHTËZAKONSHËM I «OSLOBOGJENJES»

Sarajevë, 17 janar  
Fillimi i operacioneve të luftës në Gji ishte shkas që «Oslobogjenja» e Sarajevës sot të botonte një numër të jashtëzakonshëm. Kjo gazetë sarajevase sot në mesditë do të numërohet të jashtëzakonshëm në gjashtë faqe që i kushtohen luftës dhe lajmeve që deri në atë çast ishin arritur nga treva e operacioneve të luftës dhe kushtuar reagimeve në botë.



TË PAMBROJTURIT  
Për derisa fuqitë më të mëdha ushtarake në botë u angazhuan për të mbrojtur Kuvajtin, i cili u pushtua pa viktima nga Iraku, popujt baltikë duarthatë e të pambrojtur përpiqen t'i ndalin me supe tanket moderne sovjetike. Fotografia e AFP-së nga Vilnusi në Lituaninë dëshmon për «demokracinë tanksiste gorbacioviane» mbi popullin e pambrojtur lituanëz. Këtu ose kemi të bëjmë me kritere të dyfishta të botës demokratike, ose nuk kemi të bëjmë fare me ruajtjen e lirisë dhe të demokracisë, por me interesa fare të tjera, siç është ruajtja e burimeve të naftës dhe krijimi i mburojës së re strategjike të Perëndimit në Gjirin Persik!  
Poulli thotë: mos qofsh i vogël dhe pa krah!



**KALENDARIHISTORIK**

1736

Xhems Uati, konstruktor i makinës së parë efikase me avull. Që në vitin 1782 dyzet makina me avull të Uatit punonin në një fabrikë. Ishte ky fillimi i revolucionit industrial, në të cilin forcën e duarve fillojnë ta zëvendësojnë makinat. Vdiq më 25 gusht 1819.

1747

Lindi astronomi gjerman Johan Elert Bode, i cili e konstatoi largësinë relative të planetëve nga dielli.

1798

Lindi Ogyst Konti, filozof dhe matematikan francez, theme-lues i pozitivizmit dhe i sociologjisë borgjeze. Veprat e tij krye-sore janë «Kursi i filozofisë pozitive» dhe «Traktat mbi frymën pozitive». Vdiq më 5 shtator 1857.

1809

Lindi poeti, eseist, kritik dhe përkthyes amerikan Edgar Alan Po. Me tregimet e llahtarit, të ndërtuara mbi sajime logjike, është nismëtar i romaneve të mëvonshme popullore të detektivëve. Ka ndikuar fuqimisht mbi letërsinë evropiane. Vdiq në vitin 1849.

1839

Lindi piktori i famshëm francez Pol Sezan. Në fillim e ndiqte drejtimin impresionist, por më vonë krijon një stil origjinal në sintezën e trajtave dhe të toneve të natyrës. Kuptimi i artit nga ana e tij ka qenë revolucionar dhe ka shkaktuar shndërrimin e pikturës në botë. Vdiq në vendlindje Eks Provansë, më 22 tetor 1906.

1938

Aviacioni i diktatorit spanjollë Franko bombardoi Barcelonën dhe Valencien. Në këto sulme ajrore humbën jetën rreth 700 qytetarë të pafajshëm.

1942

Pas sulmeve mbi Pirl-Harborin, Malajën, Hong-Kongun, Tajlandën dhe Filipinet, Japonia argressive u hodh në aksion edhe kundër Birmanisë, atëherë nën administratën koloniale britanike. Ofensiva japoneze filloi me bombardimin e tmerrshëm të Rangunit, ndërsa pas pesë muaj e gjysmë përfundoi në pushtimin e plotë të tërë vendit. Birmania mbeti pas lufte megjithatë koloni britanike



1881

Në dhjetor të vitit 1880 në Prizren arriti fshehurazi nga Stambolli, ku mbahej nën mbikëqyrje, Abdyll Frashëri. Komiteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e shpalli tani veten «Buvernë e përdorne» (qeveri e përkohshme). Në Prizren u vendos një administratë e përbërë nga nëpunës shqiptarë që ishin anëtarë të Komitetit drejtues të Lidhjes. Vëmendja kryesore e Komitetit të ri u përqëndrua në organizimin e forcave ushtarake dhe në zgjerimin e pushtetit të Lidhjes në krahinat e tjera të vendit. Komiteti bëri përpjekje për të ngritur njësi ushtarake të rregullta, krijoi reparte të lëvizshme të cilat, ndryshe nga repartet që luftonin vetëm në krahinat e tyre do të shërbenin kudo që do ta lypte nevoja. Forcat e armatosura mbaheshin në saje të kontributeve të mëdha vullnetare në të holla që jepte populli. Kështu, vetëm qyteti i Gjakovës dha për këtë qëllim më tepër se 20 mijë lira ari. Mjaft kahina, si Luma, Gucia, Gjakova dhe Peja, që i kishin dëbuar autoritetet turke, u bashkuan menjëherë me Prizrenin. Nga ana tjetër, repartet e Lidhjes, të komanduara nga Sulejman Vokshi, sulmuan edhe shtinë në dorë Shkupin më 4 janar, Prishtinën më 18 janar dhe Mitrovicën më 25 janar, më vonë edhe Vuçiternën e Gjilanin. Në të gjitha këto u vendos autoriteti i lidhjes; nëpunësit turq kur nuk dëboheshin, lejoheshin të qëndronin, me kusht që të mos përziheshin në punët e administratës. Autoriteti i Lidhjes u shtri edhe në Kumanovë, Tetovë, Gostivar e Dibër. Nëpunësit turq në administratën e provincave, në mexhliset dhe në gjykatat u zëvendësuan me njerëz që ishin anëtarë të Lidhjes dhe që gëzonin besimin e popullit.



**AVA GARDNERI  
NË SERINË  
ANNO DOMINI**

Teleseria amerikane në pesë vazhime «ANNO DOMINI» ka zgjuar kureshtjen e përgjithshme me spektakularitetin, kostumografinë dhe me autenticitetin e ngjarjes që merr në pikëvështrim. Fjala është për vitet e para të paraqitjes së krishterimit dhe shthyrjen e Perandorisë Romake. Janë angazhuar edhe një plejadë e yjeve të mëdhenj të Holivudit, ndërsa me njërin nga rolet e fundit, ku u paraqit Ava Gardneri, është pikërisht në këtë seri.



**MBRETI  
I PATAGONISË**

Omar Sharifi, njëri nga aktorët më të mëdhenj dhe më të kërkuar të kinematografisë botërore, luan rolin kryesor në filmin «MBRETI I PATAGONISË». Fjala është për një film dhe rol kompleks, i cili bën fjalë për njeriun, i cili organizon fiset indiane për t'iu kundërvënë pushtetit kilian. Megjithëse fiset që i organizon e shpallin mbret të tyre (pjesa e dytë e shekullit XIX), qeveria kiliane e pati shpallur të çmendur.

Barbara Hershei, aktore e re dhe e talentuar, u bë sidomos e popullarizuar dhe e kërkuar me filmin «TUNDIMI I FUNDIT I KRISHTIT», i cili kur u shfaq, e skandalizoi një pjesë të opinionit ndërkombëtar, sidomos një pjesë të klerit në SHBA dhe në Kanada. B. Hershei në këtë film interpreton rolin e femrës ekzotike dhe të mitizuar, që kësaj radhe paraqitet me tërë sensualitetin dhe gjallërinë, të kushtëzuar nga dielli i nxehtë i Lindjes.

**BARBARA HERSHEI**



**NË PESHOJË TË KOHËS**

**... SI NUSJA QË MBETEJ FAJTORE**

Një shembull banal për një opsion të madh: korrespondenti i «Jedinstvos» nga Deçani lajmëron redaksinë e vet se «gati nuk ka shitore shoqërore në territorin e komunës së Deçanit, për të cilën mund të thuhet se është e furnizuar në mënyrë solide me artikuj ushqimorë ose të tjerë të konsumit të përgjithshëm. Në rafte gjysmë të zbrazëta ka mall nga rezervat dhe me cilësi të dyshimtë».

Lajmi nuk do të ishte i plotë po të mos kishte edhe tri «elemente» të rëndësishme: kohën prej kur ato janë të pafurnizuara, «shkakun» pse ato janë të pafurnizuara dhe supozimin se pse në shitoret private «nuk ka çka nuk ka»...

Elementi i parë: «qarkullimi në shitoret shoqërore ka rënë me të shpejtë nga korriku i vjetëm, prandaj nuk ka para për sigurim të mallit të ri»; elementi i dytë: «njohësit e rrethanave në Deçan pohojnë se kjo rënie e qarkullimit nuk është e rastit dhe këtë e vënë në lidhje me veprimin e alternativës separatiste shqiptare»; elementi i tretë: «alternativa kërkon nga shqiptarët (termi «shiptari» tashmë është institucionalizuar në këtë gazetë) që mallin ekskluzivisht ta blejnë në shitore private, pronarë të të cilave janë shqiptarët, në mënyrë që kështu t'u mundësohet që të fitojnë e të ndajnë sa më shumë para për financimin e separatizmit në Kosovë e Meto-

hi»(!!!)  
Ky është lajmi i tëri, ai konkret i përfolur, ndërsa opsioni që del edhe në këtë rast është një vazhdimësi për të gjitha mosukseset që po shënohen në politikën e aplikuar, sidomos prej korrikut të vjetëm e këndej - për të gjetur «fajtorin»...

... si të rrëfimi për nusen, të cilën nuk e linin të flasë e «ishte fajtores» edhe kur thyhej sëpata, edhe kur rrëzohej sana nga mullari në oborr, edhe kur nuk i punohej të shoqit të saj, edhe kur ishte shtëpia e pastër e dlië...

Ruana Zot nga zhurmëmëdhenjtë e tillë



FESTIVALI I KËNGËS NË RADIOTELEVISION

IRMA LIBOHOVA



Njëra ndër këngëtares më të popullarizuara në Shqipëri, Irma Libohova edhe në festivalin e këngës në Radiotelevizion tregoi potencialin e vërtetë. «Veç një herë jetojmë» ishte melodia e kompozuar nga Piro Çako në tekst të Agim Doçit që hëpërhe u pëlqye ma së shumti në festival.

Irma këto ditë po qëndron në Kosovë dhe siç u informuan jozyrtarisht nuk po rrin duarkryq. Me orkestrën e SHKA-së «Ganimete Terbeshi» të Gjakovës po përgatit materialin për realizimin e një kasete me këngë poulllore. Në bazë të asaj që patëm rastin të dëgjojmë nga kjo këngëtare në hotel «Dajti», kasete padyshim do të jetë e suksesshme...

MORENA REKA



Ishte për herë të parë në garën e këtij festivali kombëtar. Vokali i saj padyshim premtonte shumë. Kjo durrësake ka të kryer Liceun për kanto në Durrës, dhe paraqet një freski në zhanrin e muzikës së lehtë në Shqipëri. Këtë vit me sukses interpretoi melodinë «Do trokas» të doajenit të këngës së lehtë Avni Mula. Kjo melodi nuk u nderua me shpërblimet e para të festivalit, por si material la gjurmë tek dëgjuesit e pasionuar në sallë dhe jo vetëm aty...

REDINA TILI



Mixhi i saj në skenë, por edhe vokali tërheqës bënë që sivityt në festivalin e këngës, Redina Tili mos të jetë inferiore. Kënga «Lule e vetmuar» që e interpretoi Redina e që e kompozoi Spartak Tili, krijoi imazhin e një kënge që do të mbetet shpejt në shqisat e dëgjuesve. Kjo e re me një «ekstravagancë» ishte në qendër të fotoreportereve të ndryshëm dhe kamermanëve në sallë. Përse mos të jetë kur kishte ç'tu ofronte.

(e përgatiti: S.PIRAJ)  
foto: S.KOKOLLI

REPORTAZH NGA «RILINDJA DEMOKRATIKE» E TIRANËS, BOTUAR MË 16 JANAR 1991

TIRANA  
E TRISHTUAR

Ku vështron kryeqyteti ynë: drejt «Alaskës» së re? Sakrifica kjo levë Arkimedi, befasisht u shpërbë

Tirana tani është një qytet i trishtuar. S'është e domosdoshme të arrish në këtë konkluzion duke anketuar qytetarët. Mjafton të ndjekësh në ekranin e vogël të TV-së një ndeshje futbolli. Shkallët e stadiumit kombëtar janë të zbrazura. Mjafton të shohësh vitrinat e librarive në qendër të kryeqytetit. Libri shumë i mirë nuk shitet. Mjafton të ecësh me dorën në hundë brigjeve të plehrave që s'i tërheq askush, të qash në ditët me shi gropat e ujit që s'i rregullon askush, mjafton të kryqëzohesh ngado me djemtë e rinj të dehur në pikë të ditës...

Trishtimi është lajtmotivi i këtij qyteti. Pak njerëz punojnë si më parë. Shumë të tjerë enden klubeve dhe para agjencish ajrore Albransportit. Qëndrojnë me orë të tëra para ambasadave të huaja e hoteleve më me zë të kryeqytetit, merren me tregun e zi...

Ajo që pritej ndodhi. Kryeqyteti i vendit, zemra e vendit pas hemoragjisë së mërzi-shme e rrëqethëse të ikjes së dhjeta mijëra djemve e vajzave të posamartuarve e prindërve iu dorëzua trishtimit e humbjes. Në mijëra familje të mbetura shkret nga braktisjet e vendit për të gjetur ëndrrën nuk u festua viti i ri. Mijëra njerëz të fortë e prodhues të mirash materiale thanë të përhumur këtë mbrëmje të madhe: Më mirë të mos vinte ky vit i ri! Në vizitën tradicionale të familjarëve të qytetit nuk i shpëtoi dot pamjes tragjike: Njerëz të moshuar e të vetmuar mbi varret e të afërmve që rrinin me orë të tëra në heshtje, duke u rrëfyer të ikurve ç'hall iu kishte rënë mbi kokë. Hall i tmerrshëm: prindërit s'dinë si të reagojnë ndaj shpërthimeve e sulmeve të fëmijëve. Pyetje asgjësuese: përse luftuat e punuat ju, prindër të dashur, që vendi të shkojë në këtë gjendje?!... S'përtëri-

tet urdhri i historisë. Dhe ku nuk merret në konsideratë historia, mungon toleranca.

Ku po shkon ky qytet me potencial të fortë intelektual e familje tradicionalisht të shëndoshë? Drejt mërgimit e evolimit total, drejt Alaskës së re! Drejt katastrofës! Atdheu nuk ka më vlerë. Varfëria mund ta mundë në mënyrë tragjike ndjenjën kombëtare. Sakrifica, kjo levë arkimedi për mbajtjen e Shqipërisë së derisotme befas u shpërbë. Askush nga rinia nuk dëshiron të sakrifikojë më. Nga këngët patriotike me e preferuara është kënga me refrenin «Se mjaft në robëri o e mjera Shqipëri...» O shpirti im i ri!... Rinia kërkon braktisjen e vendit me të gjitha mënyrat turpsjellëse kur i dëgjon: me kapërcime ilegale të kufirit, u vihet jeta në rrezik me thirrje për statusin e refugjatit sapo kalon kufirin; me martesat tepër të dyshimta... Deri dje të huajve u kërkonin lekë e plaçka. Sot të gjithë kërkojnë adresa... ndershmëria ndihet keq. Ndalimi i hemoragjisë njerëzore duket i pashmangshëm. Po ndodh, fatkeqësisht, fatkeqësia e dytë: rrënimin më të madh nga shkaktoi historia, po e shkaktojnë gabimet tona. Mungojnë njerëzit e dashur për rini. Askush nuk mund të ngjitet më në tribunë për ta kthyer me argumentet kokën e kësaj rinie e sërish drejt atdheut.

Tirana po zverdhet e po zbehet nga hemoragjia. Shenjat janë për ikje edhe më të mëdha. Një djalë fare i ri i ikur dy-tre muaj më parë në Angli është gati t'i dërgojë familjes 500 dollarë për ta tërhequr andej. 500 dollarë për dy muaj! Kaq paguhet gjatë një viti një ministër në Shqipëri! Kaq duhet për t'ia mbushur mendjen rinisë të fluturojë si Ben Xhonsion drejt kuljve; duke harruar se lë pas dhembje, lotë, trishtim. Atdheu duket, iu dorëzua sëmundjes. Ai qëndron i shtrirë në shtrat i këputur fare, i vetmuar dhe s'ngrihet dot me forcat e tij pret ta ndihmojnë, t'i sjellin ilaçet jetëprurëse...

Teodor NEKO

ENCIKLOPEDIA E VOGËL

● Pse nuk janë të sakta shënimet e kohës së mbretërisë jugosllave për shqiptarët?

● Çfarë është pema më e çuditshme në botë?

● Kush është kampion botëror për gjuajtje të lira në basketboll?

● Regjistrimi i parë i popullsisë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve u bë në vitin 1921. Më vonë u bënë edhe disa regjistrime të tjera, por të gjitha ato nuk janë të plota sa u përket të dhënave për përkatësinë kombëtare të disa kombeve, sepse përmenden vetëm gjuha amtare dhe feja. Madje, ku më shumë e ku më pak, merrej për bazë vetëm feja. Të gjitha ato regjistrime kishin për qëllim të nxirrnin një pasqyrë sa më të rreme për pakicat kombëtare e veçanërisht për kombin shqiptar. Megjithatë, të gjitha ato regjistrime tregojnë se shqiptarët e përbënin shumicën e popullsisë së Kosovës, por binte numri i shqiptarëve në Mal të Zi dhe në një pjesë të Maqedonisë.

● Një pemë të cilën e quajnë «suxhuk» është pema më e çuditshme në Tokë. Kjo pemë afrikane rritet 10 deri 13 metra, lulet e mëdha të saj shpërthejnë gjatë natës dhe lëshojnë një erë e cila tërheq të dashurin më të madh të saj - minaqorin. Fruti i saj është ai që i jep emër dhe pamje të çuditshme kësaj peme tropike. Frutat e saj, të ngjashëm me suxhukun, janë të gjatë 30 deri 60 centimetra. Herë-herë ata mbërrijnë gjatësinë deri një metër dhe mund të kenë një peshë deri në shtatë kilogramë.

● Rekordi botëror për gjuajtje të lira në basketboll është arritur më 6 prill të vitit 1935 dhe që atëherë ka mbetur rekord i pacenuar. Atë ditë katër mijë dashamirë të basketbollit janë sulur për të zënë vend në sallën Madison Strit Armori të Çikagos, ku ishte organizuar gara për gjuajtje të lira në rrjetën e basketbollit. Në orën 7 të mbremjes, Harold Levit e follon garën. Para orës 12 të mesnatës Haroldi ka pasur 499 të qëlluara të pandërprera. Gjuajtja e pesqindtë i shkon huq. Duke qëndruar në të njëjtin vend, Leviti qëllon edhe 371 herë pa asnjë huq. Në orën 2 e 30 minuta një rojtar i lodhur dhe i padurim i sallës ngopet dhe vendos të mbyllë sallën. Leviti detyrohet në ndërprerje gjuajtjen. Më vonë «Harlemi» ka ofruar 1.000 dollarë dhuratë për çdokë që do ta thyente atë rekord të Levitit. Ai shpërblim nuk është dhënë kurrë, sepse më i suksesshmi ndër të gjithë të suksesshmit e tjerë ka arritur vetëm 86 të qëlluara, ndërsa Leviti, në serinë më të dobët të tij ka pasur «vetëm» 96.

FJALËKRYQI

AUTOR: XHEVAT RUHANI	ENËT PËR TË PIRË UJË	LIQEN NË BRSS	SHTRUAR--JET E DIÇKAJE PALË-PALË	LODËR FËMIJËSH PËR NGASJE	AI QË RUAN DIKË	KLITHJE NË KORIDË	SHKRIM-TARI VJETËR ROMAK	BARAZIA (FR.)	TEORITË E DHËNIES SË LËNDËVE MËSIMORE			
GËNJËHEM NGA DIKUSH	M	A	S	H	T	R	O	M	E	M		
AJO QË PARASHEH FATIN PËR-MES YJEVE					R	O	L		E			
VEND QË NUK E ZE ERA (SHI SHQ.)					O	J	E		T			
SHKRIVA DIÇKA NË UJË	T	R	E	T	A		THIRRJE TELE-FONIKE AMPER	A	L	O		
AKTORE JONA RAS (SKAJ.)					I		THARTINË OKSIGJEN LITËR	A	C	I	D	
KRYETARE FILIPINASE KORASON	A	K	I	N	O		MAL NË GREQI (2152m) ...OKSA				I	
AKTORE AMERIKANE SJU MARTIN	M	A	M	E	L	A	ERIK KLEPTON ISAN SALIHU		E	K		
PATINA--ZHISTE ENJOHUR PEÇ					T		DRAMË E JOSIP RELËS LITËR		N	I	T	A
BANORËT E NJË VENDI NË VOJVODINË					I	L	A	S			K	



FATI I KULTURËS SHQIPTARE NË KOSOVË

# PËR KULTURËN AUTOKTONE «GJYKOJNË» ARDHACAKËT

**Sipas Stojan Kostiqit, kryetar i Fondit Krahinor për Kulturë (ish-BVI-ja për Kulturë e Kosovës) disa institucione kulturore duhet mbyllur, disa duhet dorëzuar shtetit, kurse disa të jepen në treg! Profesionalizmi kulturor qenka i dëmshëm për shqiptarët**

Kultura si dhe format e ndryshme të aktivitetit krijues në Kosovë po përjetojnë rastet më të vështira. Atë që e përjetojnë jeta politike e ekonomike, e përjetojnë edhe jeta kulturore, duke filluar nga sulmet e pabazat mbivlerat burimore të kulturës shqiptare, e deri te ndërprerja e financimit, si dhe zbatimimi masave të dhunshme në shumicën e institucioneve kulturore. Hapi i parë praktik në rënimin e jetës së organizuar kulturore ishte shuarja e BVI-së Krahinore për Kulturë, si dhe shndërrimi i saj në të ashtuquajturin Fond për Kulturë të Kosovës. Si pretekst për këtë ndërmarrje restriktive u morën rrethanat e jashtëzakonshme në të gjitha fushat e jetës. Transformimi i një bashkësie të organizuar shoqërore që merret me financimin dhe përkujdesjen e kulturës, në një të ashtuquajtur fond, pikësynim i të cilit është mbyllja dhe reduktimi i disa institucioneve kulturore në Kosovë, flet edhe për një absurd të kohës

sonë. Kjo mund të vërehet edhe në deklaratën e njëfar Stojan Kostiqit, i cili qenka kryetar i të ashtuquajturit Fond Krahinor për Kulturë: «Duhet gjithësesi të ndërrohet fizionomia e kulturës në Kosovë. Në Kosovë ekzistojnë 13 institucione kulturore, prej të cilave, gjysma nuk punojnë asgjë, kurse gjysma tjetër mezi gjallërojnë». Sipas këtij «kryetarit» ishte i domosdoshëm zbatimi i masave të dhunshme në disa institucione kulturore, sepse aty punët nuk na paskan shkuar mirë. Bile, ai preferon që këto institucione si të tilla edhe nuk na nevojiten. Dhe pa një pa dy përmend Muzeun e Kosovës, i cili që nga fillimi nuk paska pasur perspektivë, pastaj ansambli profesional «Shota» i cili «ashtu siç është nuk i duhet Kosovës», prandaj që të jetë ndryshe, Stojan Kostiqi, thotë se ky ansambel profesional duhet të bëhet gjysmëprofesional! Pra, si profesional nuk i duhet

Kosovës, kurse si gjysmëprofesional po!

Si «mëkatore» për «gabimet» në jetën kulturore të Kosovës, sipas Kostiqit, konsiderohet edhe Bashkësia Kulturore-Arsimore e Kosovës sepse «ajo nuk punon asgjë». Për këtë lypset të koordinohen punët me Bashkësinë Kulturore-Arsimore të Serbisë dhe të gjendet një modus për «zgjidhjen» e këtij problemi, sepse BKA e Kosovës nuk mund të funksionojë më ngase ajo qenka në shërbim të alternativës «separatiste shqiptare».

Në mesin e atyre që «s'po punoka asgjë» qenka edhe Galeria e Arteve të Kosovës, kurse zbatimi i masave të dhunshme të Teatrit Popullor të Kosovës, Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Kosovës, Arkivin e Kosovës, po shërbekan si «hapësirë për krijimin

e kushteve normale për punë të mëtutjeshme». Se me çfarë aktivitetesh «rivitalizuese» po u merrka i ashtuquajturit Fond Krahinor për Kulturë flet edhe kërcënimet e «kryetarit» të këtij fondi se nuk do të financohen më revistat «Fjala», «Thumbi», «Kosovarja», të cilat na qenkan në shërbim të nacionalizmit e separatizmit shqiptar. Me një fjalë ai thotë se «tash e tutje nuk do të financohen armiqet»(!)

Fati i kulturës shpirtërore e materiale shqiptare po trajtohet si një material «i importuar», ndaj të cilit «doganierë» të ndryshëm të importuar caktojnë çmimin e saj të «doganës». Do të ishte mirë që doganierët e tillë ta dinë se kultura shqiptare i ka rrënjët këtu dhe lashtësia e saj mund të matet me vitalitetin e saj shpirtëror e material, që nga antika e deri sot. Për këtë dëshmojnë vlerat e pakontestueshme letrare, muzikore, figurative, etnografike, arkeologjike etj. Ata që s'dinë për këto vlera, sikur harrojnë për mentalitetin e tyre ardhacak dhe për psikologjinë inferiore krijuese.

Emin AZEMI

Pozita e vështirë ekonomike dhe papunësia që me vite të tëra ishte karakteristike e Kosovës bëri që një numër i madh i shqiptarëve të marrë udhën e kurbetit dhe të vendoset në qytete e kantone të Zvicrës. Këta njëherë ishin të angazhuar vetëm si punëtorë krahu, por me aspirimin e situatës politike dhe me shtimin e terrorit serb mbi shqiptarët, sidomos mbi të rinjtë, viteve të fundit numri i emigrantëve shqiptarë në vendet e ndryshme të Perëndimit u shtua, kurse krahas kësaj u ndryshua edhe struktura sociale dhe profesionale e tyre. Kjo bëri që tek bashkëatdhetarët tanë të gjenden përkohësisht edhe profesorë, juristë, ekonomistë, inzhinjerë, krijues e artistë, të cilët krahas punëve dhe mallëngjimit për atdhe e familje, filluan të merren edhe me aktivitete kulturore e artistike. Në shumë meste u themeluan shoqata e shoqëri, klube e asociacione të tjera, që kishin për qëllim organizimin e jetës kulturore të punëtorëve tanë dhe të familjeve të tyre.

NGA AKTIVITETI I PUNËTORËVE TANË NË ZVICËR

## DO TA RUAJMË DHE AFIRMOJMË KULTURËN SHQIPTARE

**Themelimi i shoqatës për mbrojtjen dhe afirmimin e kulturës shqiptare «Aleksandër Mojsiu» në Zvicër i dha rezultatet e para. – Plane ambicioze të punës për sivjet**



Pas shfaqjes së komedisë «Vëllazëri e interes»

he nga vet emri i saj, ka për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e kulturës shqiptare, të dokeve e të zakoneve tona tradicionale, por edhe afirmimin e këtij thesari ndër bashkatdhetarët tanë dhe tek të gjithë të tjerët këtu në Zvicër dhe më gjerë. Deri më tash jemi angazhuar kryesisht në kultivimin e poezive, recitaleve e pjesëve dramatike. Kemi përgatitur dhe shfaqur me mjaft sukses një reci-

tal nga tekstet e Riza Nikqit me titull «Hija e vdekjes», që u kushtohet vashave shqiptare kosovare që studiojnë në Universitetin e Prishtinës. Pos kësaj, kemi përgatitur dhe shfaqur me plot sukses, madje disa herë dhe në disa meste, edhe komedinë e modifikuar «Vëllazëri e interes» të Kristo Floqit, kurse për vitin 1991 kemi plane vërtet ambicioze. Kështu, planifikojmë të përgatisim dramën kushtuar heroines Kosovare



Adem Kicaj, regjisor amator në Lensburg të Zvicrës



Shote Galica «Gershetat e luftës» dhe dramatin e veprës së Adem Demaçit. «Gjarpinjtë e Gjakut».

Do të angazhohemi edhe për hapjen e një biblioteke këtu, pastaj për organizimin e orëve letrare, të takimeve kulturore e formave të tjera të organizimit të jetës kulturore ndër bashkatdhetarët tanë në Zvicër, thotë Adem Kicaj.

Refki RESHITAJ

NË SPIKAMË

## EDHE NJË ATAK NDAJ ARTIT TONË SKENIK!

**Ose: Çfarë rrjedhimesh do të mund të reflektohen në veprimtarinë e Teatrit Popullor të Gjakovës, që është institucioni i dytë i këtillë profesionist në Kosovë, pas ndërprerjes arbitrare të financimit të tij nga ana e aparatit vazal – Fondit Krahinor të Kulturës?**

Përderisa kohë më parë çështjet e financimit të veprimtarisë së institucioneve tona profesioniste të kulturës ishin probleme, që thuaa kryekëput rrjedhinin nga pozita e pavolitshme materiale e asociacioneve përkatëse të Kosovës, aktualisht aparatet (organet) vazale të Serbisë «zgjidhjen» e vështirësive të kulturës kosovare, apo thënë troq, të kulturës shqiptare, po e bëjnë me aq «marifet», sa që «ilaç» më të mirë rrallë kund mund të gjendet. Një «ilaç» kaq efikas, këto ditë, nga pakoja e panumërt e masave të Kuvendit të Serbisë, ose, nga organet e tij të ashtuquajtura krahinore në Prishtinë, i arriti edhe Teatrit Popullor të Gjakovës.

Ç'është e vërteta, këtij institucioni të rëndësishëm të artit tonë skenik, që është, siç dihet, teatri i dytë profesionist në Kosovë, nuk i ndodhi ajo që i ngjau Teatrit Popullor Krahinor të Prishtinës, ku edhe me «ndihmën» e policisë pushtetmbajtësit i aplikuan masat e dhunshme. Por, ky mund të jetë vetëm si një ngushëllim, ngaqë në «ilaçin» që u gjet për Teatrin e Gjakovës vetëm sa nuk shkruan «masa administrative», për t'ia hapur rrugën ndoshta edhe mbylljes së tij.

Pikërisht, fjala është siç pohon Hadi SHEHU, drejtor, se kësaj shtëpie teatrore, pa asnjë arsye dhe krejtësisht në mënyrë arbitrare, iu ndërpre tërësisht financimi i veprimtarisë nga ana e Fondit Krahinor të Kulturës. Edhe pse kompetentëve të këtij teatri për këtë ende nuk i ka arritur ndonjë shkresë zyrtare, megjithatë, atyre kjo masë iu është komunikuar gojarisht nga faktorët e këtij fondi. Se kjo masë është e «plotëfuqishme», mund të mësohet edhe nga «Fletorja zyrtare» e Kuvendit të Republikës së Serbisë, në të cilën thuhet decizivisht: «se të gjitha institucioneve kulturore krahinore që deri vjet janë financuar në mënyrë participiale, pra nga BVI-të e deritashme krahinore të kulturës dhe ato komunale, iu ndërpritet krejtësisht

ajo përqindje e mjeteve financiare që e ndante për to BVI-ja Krahinore e Kulturës, përkatësisht tash Fondi Krahinor, që është formuar për këtë qëllim. E, deri më tash veprimtarinë e Teatrit Popullor të Gjakovës, si institucion profesionist, në masë 70 për qind, e ka financuar BVI-ja Krahinore e Kulturës (tash Fondi), kurse pjesën tjetër (30 për qind) e ka bërë BVI-ja komunale e kulturës.

– Një veprim i këtillë absurd, jo vetëm në rrethanat aktuale të ngarkuara me plot anomali anakronike, thuaa në të gjitha sferat e jetës tek ne, nuk na ka befusuar aq shumë. Sepse, qysh vjet kishim një parandjenjë se do të ndodhë një gjë e tillë, aq më parë kur kihet parasysh fakti se gjatë krejt kësaj periudhe, kuptohet pas formimit të këtij Fondi e me njerëzit që u emëruan në krye të tij, kishim vazhdimisht probleme rreth sigurimit të mjeteve financiare, që do të thotë se për shkak të mosdijshes së mjeteve që na takonin, përherë e kishim xhirologarinë tonë të bllokuar. Krijimi i një situatë të këtillë na u bë edhe më qartë kur, jo njëherë, nga krerët e këtij Fondi pëshpëritej se Teatri i Gjakovës na qenka institucion njënacional, pra i shqiptarëve, se vetëm regjisori i përhershëm që është i kombit serb nuk është i mjaftueshëm... Absurdi i kësaj mase bëhet edhe më i pakuptueshëm, kur dihet se «arsyetimi» i përmendur më sipër, nuk po vлека edhe për institucionet tjera, si bie fjala, për Institutin për studime të kulturës serbe, malazeze e të tjerëve të Kosovës, për Orkestrin simfonik të Prishtinës, etj, që na qenkan me interes më të madh (!), pohon H. Shehu.

Dhe, pas gjithë kësaj, sado që çdo koment do të dukej ndoshta i tepërt, megjithatë, rrjedhimet tejet negative në veprimtarinë e këtij teatri, i cili gati tash e një dekadë e gjysmë shënoi rezultate të pamohueshme, janë të pashmangshme. Është pra ky edhe një atak i drejtpërdrejtë ndaj artit tonë skenik, ndaj institucioneve tona të tilla edhe ashtu të pakta. Në këtë kontekst, ndoshta do të ishte me interes të përmendet një e dhenë, mbase më shumë për të bërë një krahasim se në ç'shkalë gjendet zhvillimi i jetës teatrore tek ne. Derisa në viset tjera përafërsisht me shkallë të njëjtë të zhvillimit shoqëror-ekonomik, si bie fjala, në Mal të Zi, ku sot punojnë 5 teatro profesioniste, kurse në Maqedoni 8 sish, në Kosovë, dihet për çfarë qëllimesh, të vetmet dy institucione të këtilla gjenden praktikisht në prag të mbylljes.

Mirëpo, gjithnjë me shpresë se çështja e financimit do të zgjidhet, në një masë, nga ana e organeve përkatëse komunale, në ç'drejtim aktualisht edhe po punohet, por edhe të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të ekzistimit të Teatrit Popullor të Gjakovës, për obligimin ndaj kulturës sonë, të krijimtarisë skenike dhe ndaj popullit, trupa artistike e kësaj shtëpie, pavarësisht nga të gjitha këto telashe, me të njëjtin entuziazëm është zotuar që edhe sivjet të realizojë në tërësi planin e veprimtarisë së vet. Kësisoj në sezonin e sivjetmë në TPGJ është planifikuar të realizohen tri projekte mjaft ambicioze: «Ulpiana 516» e Ymer Shkrelit, «Shtëpia në bulevard» e Fadil Paçrramit, ose, «Kush e solli Doruntinën» të Ismail Kadaresë, premiera e tretë do të jetë «Rrushi në diell» e L. Hazberit, ose, «Koligula» e A. Kamys.

Zija HASIMJA



KONTRIBUTET E REJA PËR «REVOLUCIONIN ANTIBUROKRATIK» MALAZIAS

# NJË DOSJE POLICORE ZBULOI «DIRIGJENTË»

Në dyvjetorin e janarit historik në Malin e Zi, i cili konsiderohet këtu zyrtarisht si «një kryengritje autentike, demokratike, kundër ish-udhëheqes së paafte dhe të tjetërsuar nga populli», në opinionin doli, papritur, një dëshmi autotentike: një material policor rigorozisht i ruajtur i bisedimeve telefonike të përgjuara të «tëtorit malazias». Nga ai material shihet qartazi se çdo gjë është bërë sipas një skenari të sprovuar dhe sipas instruksioneve nga jashtë Malit të Zi!

Organi opozitar «Liberal», publikoi në rubrikën «ekskluzivisht» në 17 faqe një material të origjinës policore, i cili, siç thonë, është duke qarkulluar nëpër Malin e Zi, për një rrjet të «terrenistëve», të organizatorëve të mitingjeve, të jatakëve, të hafijeve, në të vërtetë të realizatorëve të grushtshtetit, nëpërmjet të cilin opinioni merr vesh vetëm tash se nga cilat themele «demokratike» buron legaliteti i pushtetit aktual të Malit të Zi. Nga raporte sekrete policore, nga të dhëna operative dhe nga bisedat telefonike të përgjuara shihet se si të gjitha rridhnin nën shkopin dirigjues të Miroslav Sholeviqit të Kosovës, por, mjerisht, nuk mund të merret vesh, megjithëse supozohet, se kë të pasur urdhërdhënës.

## Sholeviqin e përcillnin këmbë pas këmbë

Shërbimi i sigurimit shtetëror i Malit të Zi e përcillte këmbë pas këmbë Sholeviqin dhe zbuloi rrjetin e gjithmbarshëm të bashkëpunëtorëve të tij. Dita më ditë, orë për orë e dinin se me kë kishte kontakte, se të kush ishte, se për çka kishin biseduar, se për çfarë kishin bërë ujdj dhe se çdo të ndërmerrnin, se cilat ishin lidhjet me Beogradin, Novi-Sadin dhe Prishtinën. Por, pushteti asgjë nuk mundte (ose nuk guxonte) që të ndërmerre.

Është e njohur dhe botërisht e demonstruar aftësia e Sholeviqit për të caktuar mitingje. Ja se si dukej kjo praktikisht mbi një shembull malazias: Sholeviq i kishte telefonuar Mojash Çoroviçit, të metalurgjikisht «Boris Kidriç» - Nikshiq (Mojash është vëllai i Tomash Çoroviçit, drejtor i «Radiotoni» - Beograd, lidhje më parë e regjistruar e afërt e Sholeviqit, më 8 shtator, ndërsa policia e kishte përgjuar bisedën. Sipas dokumentit, «Sholeviq i sugjeroi Çoroviçit që të shkruante një «petition» dhe të gjente persona, të cilët do ta nënshkruanin, ndërsa pesë nënshkruesit e parë të shpaleshin «këshill iniciator». NJË kopje të petitionit duhej t'ia dorëzonin LSP-së e të thoshin se orgjinalin do t'ia dorëzonin «këshillit organizues» të Kosovës. Këshillit duhej për t'ia dërguar në teleksin 18-383 njoftimin se kishin dorëzuar një kërkesë për organizimin e një mitingu, të cilën e kishin nënshkruar qytetarë (të përmendej numri e të tjera). Ç'duhej bërë ende «spontanisht»? Sholeviq i dha Çoroviçit ranë një ujdj rreth shkrimit të parullave. Sholeviq propozoi që ta vizitonin «njërin, në të cilën shihet se si Zharkoviç lëkundet, herë andej, herë këndej, që kur është pa bazë dhe pa baraspeshë», ndërsa në nënshkrimin duhej të shkruante «Pivast». Propozoi që të vizitohet një helikopter «tek e kthen nga një mbledhje e Kryesisë në vendlindjen e vet». Pastaj Mojash bisedoi me Vllan Tomash (Sholeviq i thirrte nga zyra e Tomashit nga «radiotoni»), dhe ranë në ujdj që të bisedonin më vonë «në lidhje me hollësitë».

## Bashkëpunëtorët e «Politikës»

Pas katër ditëve vëllezërit Tomash dhe Mojash biseduan dhe me atë rast Mojash mori «këshilla» se ç'të bënte nëse do të dilnin fare problemesh: «duhet të njoftosh menjëherë Radio-Nikshiqin, si dhe Milen e «Politikës» që të shpallnin se si një grup i punëtorëve kërkonte organizimin e një mitingu, kurse lidhja Socialiste nuk lejonte».

Duke gjykuar nga numri i raporteve për përcjelljen sekrete, Mojash Çoroviç nuk kur-

## ● Gazeta opozitare «Liberal» publikoi një raport policor për rrjetin e «terrenistëve», të organizatorëve të mitingjeve, të jatakëve dhe të nismëtarëve të grushtshtetit në janarin e para dy vjetëve

sente para për bisedat telefonike. Kishte biseduar më 18 shtator me Dragomir Beqiroviçin, shëf i korrespondencës i «Politikës» nga Beograd, i cili ndodhej atëherë në Radio-Nikshiqin. Me atë rast Mojash i kishte thënë Beqiroviçit që t'u hiqte viza parullave: «Kjo «nuk shkon», por Vuk Brankoviç dhe «i shtati nuk është i gjashtij» etj». Të nesërmen «i publikoi të gjitha parullat që ishin vënë në mitingun e Nikshiqit, bashkautor i të cilit kishte qenë, një gazetar i «Politikës».

Sholeviq, si një dirigjent i stërvitur mirë, u jepte në çdo miting shenja të vendosura ihtarëve të vet fanatikë - kur dhe kush duhej fishkëlluar dhe duartrokatur, kujt t'i kthehej shpina e kujt t'i brohoritej, se nga kush të kërkohej dorëheqja. Një punonjës operativ i shërbimit të sigurimit shtetëror nga Cetina u raporton eprorëve: «Se parullat dhe këngët, të cilat i këndonin dhe i thirrnin pjesëmarrësit nga Kosova (ndër të cilat «duam armë» dhe «na jepni armë») kryesisht fillonin në shenjë të Sholeviqit, i cili gjendej në hapësirën parapa skenës».

«Sholeviqit iu qa Pavle Miliq i Titogradit» - shkruan më tej në informatën - «Se duan që t'ia presin kokën për shkak të paraqitjes në miting, duke theksuar se e kishin përkrahur katolikun tonë, gjë që e ka me shkrim, nga sindikata dhe nga tubimi, si dhe nga një takim partie. Sholeviq e këshillonte që të ngrinte padinë dhe, t'i premton Miliqit se do të vinte në Titograd të nesërmen dhe pastaj të shkonin ata në Titograd për të marrë masa siç kishin rënë në ujdj. Sholeviq premtoi se do të vinte me 1 mijë persona dhe me 120 gazetarë, në mënyrë që t'u sigurohej publiciteti të gjithëve».

E qartë, pas shpartallimit të mitingut, instruktorë si Sholeviq kërkonin që aksioni të vazhdohej pa më parë. Në informatat e SPB-së së Prishtinës paraqitur kolegëve malazez përmendet se Sholeviq kishte pasur kontakte me Pavle Miliqin dhe Nada Gruiqin e Titogradit dhe se ai siguronte që ta vazhdonin aksionin e filluar, duke i siguruar se do të përforcohehin me 1 mijë persona nga Serbia dhe me 120 gazetarë. Vërejtjes së Miliqit se në rrugë kishte forca të fuqishme të milicisë, Sholeviq iu përgjigj se «edhe ne do të vishe-

mi me uniforma, se tash për tash janë duke na veshur mirë dhe se, fundi i fundit edhe ne e kemi kryer ushtrinë».

## Instruksonet për punonjësit

Vuri kontakt menjëherë me ekspertët e vetë për një tubim protesues në kolektiva të mëdha pune dhe i diktoi udhëzimet: «ndërpreni tërësisht prodhimin. Kjo duhet të zgjatë deri sa të mos konstatohet faj për forcën e përdorur. Kërkesa e dytë le të jetë se nuk do të punonin derisa të mos rriten të ardhurat personale 50 për qind», krahas vërejtjes se kushti rreth parave nuk bënte asesi që të vihej si i pari. Tha se duhej të akuzohej për udhëheqje, sidomos Lazar Gjodiç, sekretar i SPB-së, dhe të kërkohej urgjentisht shkarkimi i tyre.

«Nesër do të shkoj larg në Beograd, te gazetaret dhe t'ua them të gjitha që t'ua lëshojmë në qafë tërë shtypin», e njoftonte Sholeviq lidhjen e vet të Nikshiqit, ndërsa një bashkëbisedues të Titogradit edhe më hollësisht: «Këto ditë tërë shtypi i Beogradit ka për të ardhur atje».

Në një bisedë me Nada Lazareviçin e Titogradit, në të cilën kishte Sholeviq kontakte të vazhdueshme (në raportin policor thuhet: «Ish bashkëshorte e Ranko Joviçit, një letërrar, i cili vepron nga pozita nacionaliste, me të cilin, sado që janë shkurorëzuar, ka marrëdhënie të ngushta»), ishte bërë fjalë për një telegram përkrahjeje drejtuar udhëheqes së vjetër nga «Ododi» i Cetinjes. Sholeviq thotë se telegrami ishte i porositur dhe i trilluar që punonjësit, për atë arsye, duhej ta ndërprisnin punën, të thirrnin një tubim dhe të distancoheshin nga ai telegram.

Një persone e Titogradit iu qa Sholeviqit se nuk ishte dhe aq lehtë për ta përmbysur udhëheqjen malaziasë kështu që, ndër të tjera duhej të përgatitej më me themel një miting para Kuvendit, ndërsa Pavle Miliq, aktivist antiburokreatik i «Radoje Dakiqit», përmendte në një bisedë Rakoçeviqin, drejtor i «Beotehnës», gjoja nip i Slobodan Milosheviçit dhe i cili kishte kompensuar shpenzimet e mbartjes së punonjësve të «Radoje Dakiqit», me autobus të «Tarës» në mitingun e Beogradit.

## Populli i manipuluar

Cituam vetëm disa hollësi nga një material i gjerë i papërpunuar, policor, i cili përmban 150 shënime dhe dokumente zyrtare nga ai shihet se as që mund të bëhet fjalë për një kryengritje spontane dhe për një lëvizje autoteknike. Sigurisht se kjo nuk do të jetë shkas për rehabilitimin e ish-funksionarëve malazezë, por është marrë vesh që edhe me këtë rast populli kishte qenë manipuluar për qëllimet e huaja dhe kishte futur në një politikë, e cila do t'i kishte - u pa së shpejti - më shumë pasoja shpartalluese sesa integruese për të ardhmen e Jugosllavisë. Vetëm tash është e qartë se në Malin e Zi «ndodhi populli» nën shkopin dirigjues të specialistët serbë të masave, ndërsa në atë gjë morën pjesë mjaft shumë edhe disa profesorë të universiteteve të Beogradit dhe të Novi-Sadit, gjë që shihet qartazi nga ky material policor. Në «Liberal» kanë paralizuar edhe një vazhdim nga i cili do të shihet sigurisht se si është gatuar dhe si është realizuar janari dhe se si u sollën në atë gjë gjoja prijësit e janarit Stankoviç, Bulatoviç, Gjukanoviç, të cilët i dhanë çdo gjëje legalitetin demokratik në një moment, kur puna kryesore ishte kryer tashmë.

«Vjesnik»

SËRISH PËR TË NJËTËN ÇËSHTJE: BANESAT PËR TË KTHYERIT

# SKUQJA E «BUKUROSHES SË KALTËRË»

Ndarja e banesave në bllokun banesor për të kthyerit në lagjen e Prishtinës «Ulpiana» në 80 për qind të rasteve është bërë në mënyrë kundërligjore. - Ndër banuesit më së paku ka të kthyer dhe të shpërngulur potencialë e më së shumti ka persona që e kanë të zgjidhur çështjen banesore. - Tani për tani kompetentët bëhen të shurdhër ndaj vërejtjeve të komisionit të KK të Prishtinës për zbatimin e programit jugosllav për Kosovën

A tuj që ka jepi edhe më. Kështu do të mund të përshkruhej shkurtimisht mënyra, sipas së cilës në kolektivat punonjëse është bërë ndarja e banesave në bllokun e ri banesor në lagjen e Prishtinës «Ulpiana». «Bukuroshja e Kaltër», siç e pagëzoi populli këtë ndërtesë banesore që bën pjesë ndër më të bukurat në kryeqytetin e Kosovës u ndërtua për t'u vënë në funksion të ndërprerjes së shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve dhe kthimit të pjesëtarëve të ndjekur të këtyre dy popujve. Kjo nënkuptonte që banuesit e saj para së gjithash të janë persona, të cilët mbetjen e tyre në Kosovë, përkatësisht kthimin në vendlindje, e kushtëzonin me sigurimin e pullazit mbi tokë. U pa se banues të këtyre kishte më së paku e shumë më tepër të atillë, të cilët e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, por kish edhe nga ata të cilët më shumë lakmojnë të jetojnë në qendër sesa në periferi. Natyrisht, me kushte të njëjta komfore apo me ndonjë metër katror më shumë. Për këto arsye mbi «bukuroshen e kaltër» ra e kuqja. Megjithatë, askush nuk u skuq dhe edhe më pak e ndien veten përgjegjës.

## Jashtë ligjit

Në të vërtetë, ndodhi ajo për të cilën gazeta jonë tërhoqi vërejtjen qysh para tre muajve - shpërputhja ndërmjet ndarjes së banesave dhe përcaktimit më programin jugosllav për Kosovën. Në vend që të korrigjoheshin hapat që u ndërmorën gabimisht, përkatësisht në vend që të rishqyrtohet ndarja e banesave, organizatat punonjëse, të cilat nga investuesit i bllokut banesor - Investbanka, filiali në Prishtinë - i bienë banesat duke u obliguar që t'ua ndajnë të kthyerve apo të shpërngulurve potencialë, jo vetëm që nuk e respektuan këtë obligim por ndarja u bë në kundërshtim me rregulloret në fuqi për marrëdhëniet banesore. Për këtë më së miri flet informata e Avokatorit shoqëror të vetëqeverisjes të KK të Prishtinës (nr.71-90) data 13.VII.1990) me të cilën, ndër të tjera, u konstatua edhe sa vijon: Anjë ndër marrje organizatë, me rastin e ndarjes së banesave, nuk iu përmbajti dispozitiv të Ligjit për marrëdhëniet banesore e as procedurës së përcaktuar me rregulloren mbi ndajren e banesave. Në shumicën e rasteve u konstatua se personat, të cilëve u janë ndarë banesat, e kishin të zgjidhur çështjen banesore e tani ose morën banesë më të gjerë ose banesën e mëparshme e ndërruan me banesë të re».

Nga komfiri në komfor

Intervenimi i Avokatorit shoqëror të vetëqeverisjes u bë me kërkesën e komisionit të KK të Prishtinës për zbatimin e programit jugosllav për Kosovën përfaqësuesit e të cilët që nga fillimi iu kundërvënë ndarjes jo të drejtë të banesave në bllokun banesor dedikuar të kthyerve dhe të shpërngulurve potencialë, por kolektivat punonjëse i injoruan porositë e anëtarëve të këtyre komisionit. U kontrolluan vetëm organizatat punonjëse dhe institucionet nga komuna e Prishtinës - 14 sosh «Agrokosova», Investbanka, «EK-simkosi», Tregtia e Kosovës, Banka Kredituese SHA, Prishtinë, korrespondentura e gazetës «Politika Ekspres», Elektroekonomia e Kosovës - dispeçeria, Energobanka, Elektrokomosova, ndërmarrja shoqërore «Kishnicë e Novobërdë», shkolla fillore «22 Dhejtori», dhe BSPP «Dunava». Për kontrollimin e ndarjes së banesave në kolektivat e tjera Avokati shoqëror i vetëqeverisjes i KK të Prishtinës nuk ishte kompetent, sepse ato nuk janë në territorin e kësaj komune por janë në kompetencë të organeve krahinore me përjashtim të disave, ku ndarja u bë në bazë të ligjit dhe në përputhje me rregulloret në fuqi mbi marrëdhëniet banesore, në të gjitha kolektivat e tjera ligji nuk u respektua. Në këtë mënyrë të paligjshme është bërë ndarja e nëntë banesave tridhomëshe dhe e një banese njëdhomëshe gjersa pronarët e tyre kryesisht janë persona që e kanë të rregulluar çështjen banesore dhe të cilëve u nuk u mungon komfiri. Të tillët mundën, andaj e shfrytëzuan.

Nga burimet e sigurta morën vesh se ndarja e banesave është bërë jashtë të gjitha kriterëve edhe në kolektivat jashtë territorit të komunës së Prishtinës. Në «Kosovamont» në Obiliq, për shembull, me vendimin e organeve vetëqeverisëse u blenë tri banesa në «bukuroshen e kaltër» dhe iu dhanë për shfrytëzim tre punëtorëve të këtyre kolektivit. Vetëm pas pak ditësh, në kundërshtim me këtë vendim, u kontraktua blerja e 5 banesave, e dy punëtorëve, nga ata tre punëtorët të cilëve organet vetëqeverisëse ua ndanë banesat, me dëshirën e dikujt iu mohua e drejta për të siguruar pullazin mbi kokë.

Me malverizimet në ndarjen e banesave dedikuar kryekëput të kthyerve apo të shpërngulurve potencialë, komisioni i KK të Prishtinës për zbatimin e programit jugosllav i njohu organet kompetente të komunës nëpërmjet organeve koordinues të organeve krahinore të administratës e deri në Republikë, me kërkesë decidoje që organet përkatëse të tyre të marrin masa dhe të mos lejojnë që të vendosen në bllokun e ri banesor derisa ndarja të mos bëhet në përputhje me ligjin dhe përcaktimet nga programi jugosllav. Deri tani nuk u dha as përgjigje e as që u ndërmorën masat.

Njohuritë tona bëjnë me dije se në 80 për qind të rasteve ndarja e banesave është bërë në mënyrë kundërligjore - thotë sekretari i komisionit të KK të Prishtinës për zbatimin e Programit jugosllav Zvonimir Seviç.

(«Jedinstvo»)

# ÇKA PËRMBANË REZOLUTA E INTELEKTUALËVE MYSLIMANË

Sovraniteti dhe kufijtë e BeH-së, veçantia kombëtare dhe interesat nacionale të myslimanëve duhet të çmohen e të respektohen në të gjitha negociatat e ardhshme për rregullimin e ri të marrëdhënieve ndërmjet popujve dhe republikave jugosllave. Çdo tentim i kontestimit të sovranitetit të kësaj republike dhe i veçantive kombëtare të kombit mysliman do të lente pasoja të paparashikuara në marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavi dhe në paqen e kësaj pjesë të botës.

Këto janë disa nga qëndrimet kyçe të «Rezolutës së intelektualëve myslimanë», e cila dje, në një konferencë mjaft të përcjellur për shtyp, u shpall në Sarajevë. Për vetëm një ditë këtë proklamim që iu dërgua opinionit jugosllav dhe institucioneve shtetërore - politike, e nënshkruan 84 intelektualë të njohur të kombit mysliman nga B e H, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre partiake. Rezoluta njëkohësisht u bënë thirrje edhe serbëve e kroatëve nga kjo Republikë si dhe pjesëmarrësve të tjerë të sovranitetit të B e H-së që të mbrojnë vendosmërisht ekzistencën dhe zhvillimin demokratik të Republikës amë.

Duke arsyetuar kërkesën për respektim të kujvijve dhe të vetëqenies kombëtare të myslimanëve, intelektualët thonë se më shumë se një shekull pjesëtarët e këtij kombi u penguan në zhvillimin e tyre kombëtar, autonomitetin kulturor dhe vetëvendosjen politike, të cilën gjë asnjë popull i Jugosllavisë që jeton së bashku me myslimanët nuk e përjetoi. Kërkojnë që të gjithë përfaqësuesit mysliman, por edhe përfaqësuesit e popujve të tjerë, të ngriten kundër përveçësimit të myslimanëve dhe të gjithëve t'u bëhet e ditur se asnjë individ, kolektiv apo organizatë nuk mund të flasë në emër të myslimanëve nëse në çfarëdo mënyre vihet në dyshim parimi i interesave jetësore të këtij populli, e këto janë: veçantia dhe sovraniteti i popullit mysliman; se ekzisten-

## ● Çdo tentim për kontestimin e sovranitetit të BeH-së dhe veçantive kombëtare të kombit mysliman do të lente pasoja të paparashikuara në marrëdhëniet ndërnacionale në Jugosllavi dhe për paqen e kësaj pjesë të botës, thuhet në Rezolutë

ca dhe zhvillimi i këtij populli nuk mund të rreçohen nga ekzistenca dhe zhvillimi i B e H sovranë e demokratike dhe se është i qenësishëm parakushti i ekzistencës së myslimanëve - ekzistencës dhe zhvillimit të Bashkësisë jugosllave të drejtë e demokratike.

## NËNSHKRUESIT

Në mesin e nënshkruesve të Rezolutës pos të tjerësh janë edhe Abdullah Sidrani, Mersad Berberi, Xhevat Hozo, Atif Puri-vatja, Alia Isakoviç, Muhamet Kreshhevli-koviç, Enes Durakoviç, dhe shkrimtarë, gazetarë, ekonomistë, juristë e inxhinierë të tjerë... Në mesin e nënshkruesve nuk është emri i Emir Kusturicës; por u zbatim se ai do ta jepë kontributin e vet për zbatimin e kësaj Rezolute.

Më në fund, intelektualët myslimanë krahas vërejtjes dhe potencimit të «aparësisë së përkatësisë partiake dhe përcaktimit politik, potencojnë rëndësinë e jashtëzakonshme të Partisë së Aksionit Demokratik e të shoqërisë kulturore të myslimanëve «preporod» për përfaqësimin dhe shpëzimin e interesave legjitimë të kombit mysliman. Theksohet edhe gatishmëria që së bashku me popullin mysliman dhe popujt e tjerë si dhe njerëzit e vullnetit të mirë të pengohen qëllimët për çoptimin e Bosnjës «për të cilën gjë aq shpesh po flitet».

Vëmendje të posaçme të disa gazetarë që ishin dje të pranishëm në konferencë për shtyp nxitë edhe përkrahja e intelektualëve myslimanë që ia bënë udhëheqjes së zgjedhur legjale në B e H dhe në Jugosllavi.

«Myslimanët veçmas përkrahin të gjithë përfaqësuesit e zgjidhur në mënyrë demokratike dhe legjale në Republikën e B e H si dhe në organet më të larta të Republikës, në Kryesinë e RSEJ - së dhe në të gjitha organet e tjera më të larta të Federatës. Nëse në këtë pikëpamje bëhen çfarëdo ndryshimesh, myslimanët, të cilët deri më tash gjithnjë kanë qenë të lenë anash, tash e tutje duhet ta fitojnë vendin që u takon».

Njëra ndër pyetjet që iu bënë tre përfaqësuesve nënshkrues të Rezolutës ishte edhe ajo se për ç'arsye mu tash ngrejnë zërin e tyre intelektualët myslimanë.

U dha një përgjigje e njerëzishme dhe diplomatike - se edhe gazetarët në mjetet e informimit vazhdimisht mund të lexojnë ç'mos për tentimet e anacionalizimit të myslimanëve e - nëse paraqitet nevojë për një gjë të tillë, përkatësisht nëse dikush këtë e konteston - atëherë mund të shpallet një libër i tërë me fjalë të tilla...

(«BORBA»)

## MOSMARRËVESHJET MES VENDËSVE DHE KOLONËVE TË FUSHË-KOSOVËS

# TASH KËRKOJNË HEOJEN E KOMUNËS

Kërkojmë angazhimin e menjëhershëm të organeve kompetente të Republikës së Serbisë në komunën e Fushë - Kosovës - prej aplikimit të masave të përkohshme deri te heqja e kësaj komune. Ky është njëri prej konkluzioneve më të rëndësishme nga tubimi i qytetarëve të degës së parë të Bashkësisë së 16-të lokale të Fushë - Kosovës, të mbajtur më 10 janar, të cilin, sot në formë të një kumtese ua shpërndanë gazetarëve në Prishtinë.

Në konkluzionet i formuloi, siç theksohet, një grup i autoritar i punës, Këshillit kryesor të PSS i shihet për të madhe «tolerimi i pakuptueshëm i shkatërrimit evident të autoritetit të Partisë Socialiste të Serbisë nga Këshilli Komunal i PSS të Fushë - Kosovës».

Banorët e Bashkësisë së 16-të lokale tërheqin vërejtjen se këto ndarje të popullit serb në «vendës» dhe «kolonë» mund të sjellin rezultat «konfliktet e hapura, shtrësimin e anëtarëve të PSS dhe valën e re të shpërnguljes, si dhe ndaljen e kthimit në Kosovë».

Pastaj theksohet se këto çështje nuk durojnë fshelje të mëtejshme dhe kërkohet intervenimi energjik i kompetentëve në pengimin e veprimtarisë së mëtejshme të atyre që potencojnë ndasitë dhe mbjellin farën e përçarjes ndër qytetarë, të cilët luftuan bashkërisht për kthimin e shtetësisë së integritetit territorial të Serbisë.

Në kumtesë thuhet se për këto ndasi të brendshme serbe në Fushë - Kosovë më përgjegjës është kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Komunës dr. Zoran Grujiç, e në këtë kontekst u përmend edhe Ratko Maksimoviç, kryetar i Këshillit Komunal të PSS të Fushë - Kosovës.



KUSH Ç'THA NË MBLEDHJEN E KRYESISË SË RSFJ-së

# BISEDË E KËNDSHME APO - BLERJE E KOHËS

(Fragmente nga stenogramet e mbledhjes së gjerë të Kryesisë së shtetit të mbajtur më 10 janar, sipas «Vjesnikut»)

**M**ilan Kučan: Kërkoj ndjesë që më duhet të paraqitem përsëri.  
Për kumtesën konsideroj se do të ishte mirë të thuhet ç'është ajo që propozon kryetari i KEF-it. Se do të kemi bisedën e ardhshme, kuvendimin për minimumin e funksioneve për funksionimin e Federatës, por nuk theksohet afati ngaqë do të ballafaqohemi me diç që do të iritojë opinionin, e kjo është pyetja se çfarë ndodhi.

Po ashtu, mendoj se do të ishte mirë të thuhet se disa republika tashmë janë marrë vesh për biseda dypalëshe. Konkretisht, ne me udhëheqjen e B-eH-së. Sepse, kjo nuk është ndonjë bisedë. Këtu, megjithatë, janë biseda të rëndësishme nëse mbështetemi në faktin se bartëse e sovranitetit është Republika.

E treta, ç'është me rëndësi për mua a jemi pajtuar që, në të vërtetë, fjala është për tri lloje bisedash: për funksionimin minimal, për përkufizimin e të drejtave dhe obligimeve dhe për të ardhmen, të them shkurtaz: Kjo teknikisht nuk është e thënë të bëhet ndaras. Por, esenca, megjithatë, ka të bëjë me tre komplekse të ndryshëm. Sepse, nuk është me rëndësi vetëm të merremi vesh cili do të jetë minimumi i funksionarëve. Shtrohet pyetja a do të arrihet ai fare. Por, për mua është me rëndësi, pa marrë parasysh atë perspektivë se a do të dalim në ato biseda me llogari të pastra, pra me detyrime dhe të drejta të kufizuara apo jo. Unë kam propozuar në emrin tonë që KEF-i t'i përgatisë ato biseda.

**Borisav Joviq:** Shokë, e dëgjua ju këtë. Unë po ashtu përsërita atë që e tha shoku Kučan, se ai propozon të përgatitet një akt i tillë, i cili do të bënte të mundshme ndarjen e funksioneve nëpër republika dhe kthimin e tyre.

**Llogari të pastra Milan Kučan:** Jo të funksioneve. Kjo është e qartë por të të drejtave dhe obligimeve, të borxheve e pasurisë.

**Borisav Joviq:** Këto, megjithatë, janë të drejtat dhe obligime në rast të shpërbërjes së vendit.

**Milan Kučan:** Jo vetëm të shpërbërjes.

**Borisav Joviq:** Si do të ndahet?

**Milan Kučan:** Unë në federatën e centralizuar do të shkoj duke ditur cilat janë obligimet e mia, borxhet e rezervat devizore.

**Borisav Joviq:** Nëse mbetet e këtille çfarë është.

**Milan Kučan:** Edhe po që se ndodh ashtu. Unë pa llogari të pastra më s'kam autorizime për asgjë.

**Borisav Joviq:** Për të ardhmen është gjë normale: nëse bisedojmë për ndonjë formë të shtetit dhe për funksionimet e tij atëherë do të bisedojmë edhe për atë regjistrë dhe për obligimet. Por, asesi nuk kuptova pse atëherë kjo çështje veçohet nga minimumi i funksioneve për të ardhmen?

**Milan Kučan:** Funksionet janë një. Funksioni i mbrojtjes, i Bankës Popullore, politika monetare, por borxhet dhe të drejtat materiale të miat.

**Borisav Joviq:** Borxhet që dalin nga e kaluara?

**Milan Kučan:** Paj unë po flas tërë kohën, nga jeta e përbashkët e deritashme, në bazë të vendimeve që janë marrë në organet federative. Ato kanë qenë organet tona në bazë të autorizimeve që u kemi dhënë ne, të gjithë së bashku. Por, duhet pasur situatë të pastër, përfshirë edhe pasurinë e APJ-së.

**Borisav Joviq:** Kjo do të ishte gjendje eventuale e likuidimit.

**Milan Kučan:** Si ta marrësh. Në aspektin evidencues në mos ndryshe. Nuk është e thënë të deklarohet kjo teknikisht.

**Borisav Joviq:** Mirë, e kuptuam.

**Momir Bulatoviç:** Fare shkurtazi. Ndiej nevojën sikur të gjithë së bashku, që tash ne të shpallim ndonjë kumtesë e cila dikë do ta trimëronte.

Pikë së pari, diskutimi nuk trimëron.

Nga ana tjetër, mund të dëshmohet fare iluzor diskutimi dhe përpjekja jonë që të shpallim kumtesë, ngaqë është fakt se shokët tanë të Maqedonisë kanë këtë mandat imperativ, të marrin stenogramin, kjo mbledhje në fakt është publike. A duhet shpenzuar kohë rreth kumtesës?

Por, unë, megjithatë, vetëm desha që në kumtesën të cilën, megjithatë, do të shpallim nga ky vend, përsëri të mos prejudioj asnjë zgjidhje të veçantë. Unë personalisht nuk pajtohem që opinionit jugosllav t'i kumtohet se ne kërkojmë ndonjë minimum. Të hymë në një proces, të paralajmërojmë të gjitha mundësitë, është fare e qartë se kjo do të jetë, duke respektuar barazinë e republikave, ajo pikëpyetje. Por, është e popullarizuar që me një tubim nga i cili njerëzit presin mjaft, të shpallet kumtesa se ne që në start kërkojmë minimumin.

**Janez Dërnovsheku:** Mbase është fjala për një-mosmarrëveshjeje. Unë e kuptoj se ky është minimumi i financimit të funksionimit të Federatës, derisa nuk arrihet marrëveshja, çfarëdo që të jetë ajo.

**Borisav Joviq:** Propozimet që i ka dhënë KEF-i i janë dërguar Kuvendit, në mënyrë që me kujdes më të madh t'i shqyrtojë dhe të përpqiet të gjejë zgjidhje të përbashkët.

## Mos e harroni Kosovën

**Franjo Tugjman:** Duhet thënë se ujdia për funksionimin e Federatës duhet të arrihet deri në kohën e ujdisë.

**Borisav Joviq:** T'i japim fund.

**Ismen Kajdomçaj:** Para se ta mbyllni, nëse është e mundshme të flas. Unë nuk e kam mohuar faktin evident për të cilin zoti Kučan foli, kur tha se, sipas Kushtetutës së Serbisë, krahinat më nuk janë ato që ishin. Ky është fakt dhe është e sigurt se kjo është e evidente, e nuk dëshiroj të hyjë në trajtimin e krejt asaj për të cilën mund të flasë njeriu. Në të vërtetë, unë kam vlerësuar, së paku unë, se nuk duhet të hyjmë tash në këtë temë.

Por, duke dëgjuar disa iniciativa dhe atë që e tha shoqja kur foli për punën e grupit të punës të Komisionit Kushtetues, si dhe për tash për tash zgjidhjen alternative se a do të deklarohen fare për propozimet e deklaruarë vetëm kuvendet e republikave ose edhe kuvendet e krahinave autonome.

Unë këtu foli për pozitën kushtetuese-juridike të krahinave, fola për Kushtetutën që është në fuqi, e cila përcakton saktësisht pozitën e krahinave autonome në sistem. Vura në pah çështjen se mendojmë se çdo veprim, me të cilin krahinat do të përjashtoheshin nga këto bisedime, do të ishte antikushtetues. Ndoshta, këtë e theksova më shumë

ëndrejtuese, si të them të këshillave të detyrueshme, me përbërje njëkombëshe etj. Të shkojmë e të bisedojmë drejtpërdrejt me qytetarë, me pjesëtarët e të gjitha kombeve dhe kombësive, të bisedojmë në mënyrën më të hapët e në kontakte të drejtpërdrejta.

Mendoj se gjërat mund të shkallëzohen deri në përmasa dramatike. Mendoj se në një mënyrë të caktuar të gjithë mbajmë përgjegjësi për atë që po ndodh atje.

Edhe përpara kam thënë, e jam i obliguar të them haptazi edhe me këtë rast - ne që kemi mbetur aty, nuk kemi mundësi të ndryshojmë asgjë, e po them se derimë tash nuk gjendet gati asnjë shqiptar në ndonjë funksion atje.

Lus Kryesinë që të gjitha këto t'i ketë parasysh dhe që ndaj disa propozimeve, që po paraqiten këtu, të përcaktohet barabarësisht.

Kërkoj falje ngaqë u detyrova ta përsëris këto, por e pashë të nevojshme ta them këtë.

## Kujt i duhet fshehtësia?

**Borisav Joviq:** Kjo njëra prej çështjeve që janë pjesë përbërëse e mbarë problematikës. Ne për asnjë çështje nuk kemi deklaruar konkretisht, por për çështjen se si të punojmë më tej, e nuk

mër të mundshëm sa më të madhe kundruall marrëveshjeve të drejtpërdrejta të republikave, për t'u gjetur pika të përbashkëta, pikëpamje të përbashkëta, qëndrime të afërta dhe që këtu të mund të punojmë në mënyrë më konsultive.

**Franjo Tugjman:** Unë angazhohem për atë që konkretisht të përmendet - se është arritur marrëveshja ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë.

**Borisav Joviq:** s'ka problem, për të gjitha që mirreni vesh ne do t'i publikojmë.

## Mos e publikoni afatin

**Slobodan Milosheviç:** Duhet thënë parimisht se Kryesia sugjeron që në ndërkohë, mundësisht, të zhvillohet numër sa më i madh bisedimesh ndërmjet përfaqësuesve më të lartë të republikave, kurse më 23 do të zhvillohet mbledhja e ardhshme.

**Borisav Joviq:** Të themi se këtu është arritur marrëveshja edhe me kryetarët e republikave se në ndërkohë do të zhvillohet numër më i madh bisedimesh ndërmjet republikave, mirëpo zoti Tugjman dëshiron që të publikohet se do të zhvillohet edhe biseda ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë.

**Slobodan Milosheviç:** Mirë, por le të thuhet - pritet që në këtë ndërkohë do të zhvillohet bisedimet ndërmjet udhëheqjeve të Serbisë dhe të Kroacisë dhe atyre të tjerave që dëshirojnë.

**Borisav Joviq:** Për ne politikisht është më mirë të themi se të gjitha republikat në ndërkohë do të bisedojnë ndërmjet vete, që të mos thonë: Për çka mirren vesh Serbia dhe Kroacia - edhe për të tjerët është punë e kryer.

**Franjo Tugjman:** Jo, të gjitha, ndërsa tashmë u arrit marrëveshja që në atë afat të zhvillohen të gjitha bisedimet.

**Ante Markoviç:** Mos e publikoni ate afatin 23, sepse ndoshta nuk arrijmë t'i kryejmë.

**Borisav Joviq:** Ne jemi orientuar për të mërkuren që juve mos t'ua çrregullojmë planet. Qëllimi ynë është që këtë ta bëjmë deri atëherë. Nëse rastësisht shtyhet afati, ne do të japim shpjegime. Mirëpo, opinionin nuk do të lejojë që kjo të jetë kohë e pafundme.

**Vasil Tupurkovski:** Nuk është real ky afati 23. Duhet paraparë edhe pak kohë. Shoku Andov foli se çfarë është problemi ynë, edhe ky është një-mend problem serioz. Ne të fitojmë mandatin e dytë nga Kuvendi për dy javë, pa kryetarin e shtetit, kryetarin e qeverisë për këto bisedime - nuk është mirë për Maqedoninë, e as për këto bisedime.

E dyta, nëse kemi thënë se do të takohen të gjitha republikat, atëherë të jemi në kontekstin e këtij kompromisi.

E treta, është absurd, Boro, këtu edhe një takim i ri, nëse nuk do të ketë ujdë për arrijten e minimumit të nevojshëm, e jo të vetëm ndonjë minimumi.

**Borisav Joviq:** Vasil, kjo është punë që duhet ta kryejmë «me plot energji». Ne nuk mund të parandalojmë asgjë.

**Vasil Tupurkovski:** Nuk është fjala për parandalim, por për projektim të drejtë të kohës. Data 23 nuk është e mirë dhe ju lutem që të mirremi vesh së paku edhe për një javë.

**Stojan Andov:** Është e sigurt se 13 ditë nuk mjaftojnë për takime bilaterale, mirëpo për atë minimumin e ujdisë - si të funksionojë federata e tashme, këtë duhet arritur për 13 ditë.

## «Sopata e vogël» dhe «hapi i vogël»

**Borisav Joviq:** Ju lutem, kjo ka qenë në Kryesi, ka qenë në Kuvendin e Jugosllavisë dhe i është dërguar të gjitha republikave. Kjo nuk mvaret prej nesh, por prej republikave.

Nëse ju konsideroni se duhet ta shtyjmë për një javë, s'ka problem.

**Ante Markoviç:** P.sh «deri nga fundi i muajit»

**Slobodan Milosheviç:** Shokë është jo solide që për kohë të pacaktuar të zhvillojmë mbledhjen tjetër.

**Vasil Tupurkovski:** S'është «e pafundme» - kjo do të ishte prej 23 deri 30, kurse në ndërkohë do të zhvilloheshin edhe pesë takime që kanë rëndësi për njerëzit të cilët po i propozojnë.

**Slobodan Milosheviç:** Ne mundemi edhe pas 30-it nëse është nevoja. Çka do të prëjmë ne me «sopatë» më 23 - asgjë, por prapë do të bëjmë «hap të vogël» dhe bisedimet bëjnë një përparim gradual.


**Franjo Tugjman:** Ne kemi propozuar që në afat prej dy muajsh të gjitha bisedimet të zhvillohen ndërmjet republikave.

**Borisav Joviq:** Për këtë kohë të gjithë nuk do t'i kryejnë bisedimet. Le të zhvillohen bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë, ndërmjet Bosnjës dhe Sllovenisë, e pastaj shohim e bëjmë.

**Milan Kučan:** Edhe ndërmjet Sllovenisë dhe Serbisë.

**Borisav Joviq:** Mirë, u morëm vesh. Jap pushimin për drekim.

Lus shërbimin për të përgatitur tekstin e kumtesës, kurse pas drekës Kryesia këtë do ta shikojë dhe miratojë.



seç është dashur, veçanërisht në këtë nivel. U detyrova të flas sërish, sepse unë edhe më tej nuk e kam të qartë se a mbesin krahinat si faktorë dhe subjekt aktiv i të gjitha këtyre bisedimeve ose jo. Ose, a duam ne, ndoshta, edhe si federatë, të kemi krahinat autonome? Mendoj se në një mënyrë të caktuar, ne duhet të shohim, ndoshta ju këtë e keni të qartë, por mua nuk më është e qartë deri në fund.

Sepse, së dyti, nëse duhet inkuadruar në këtë unë do të lutesha të krijoj minimumin e supozimeve për inkuadrimin e tyre. Unë flas për Kosovën - për minimumin e supozimeve për përfshirjen e Kosovës, pra, të të gjithë qytetarëve të saj, edhe të shqiptarëve, edhe të të tjerëve, barabarësisht si dhe të të gjithë qytetarëve të pjesëve të tjera të vendit tonë. E, kjo nënkupton nevojën që të shohim, e asesi të deklarohemi për propozimet e vazhdueshme që paraqiten këtu lidhur me Kuvendin, delegatët, Këshillin Ekzekutiv, etj.

Pastaj unë nuk fola me qëllim për situatën, ndonëse me një fjalë thash se sa është ajo njëmend tejet e rëndë dhe nuk fola për çështjen se rrethanat, në të cilat punojmë atje, kohë pas kohe po sjellin edhe viktima të reja në njerëz. Unë nuk fola

për këtë, sepse jam i bindur se kësja Kryesia dhe kësaj përbërje kjo i është e njohur dhe e qartë deri në fund. Por, nuk u luta as rastësisht e në këtë drejtim me përkrahje edhe shoku Riza - e kjo nuk është hera e parë që paraqitet kjo - se pikërisht për shkak të situatës së tillë do të ishte njëmend e domosdoshme që sa më parë ose grupi i punës ose anëtarët e Kryesisë, ose nuk e di se në çfarë forme, të vijë menjëherë në Kosovë dhe ta shohin këtë gjendje. Unë nuk jam për çështjen që, ndoshta, të vijnë atje të bisedojnë në këtë Kryesi tonë «të cunuar», e organe të tjera nuk kemi. Ndoshta, nuk jam as për çështjen që të ndalemi e të bisedojmë në kuvendet e komunave, të cilave tash nuk e lejohe as të mbajnë mbledhje. Nuk jam as për çështjen që të mbesin në nivelin e atyre organeve pu-

mund të përjashtohet çështja e pozitës së krahinave, as e përfaqësimit i tyre në Federatë: nuk mund të përjashtohet gjatë diskutimit për Kushtetutën, e tashme është thënë se për këtë do të bisedohet.

Mendoj se mund të konstatojmë se kemi zhvilluar një bisedë të dobishme, të gjithmbarshme, të hapët e të gjerë, e cila paraqiti të gjitha këto mundësi dhe përmblantë të gjitha propozimet e mundshme.

Ne stenogramin do t'ua japim të gjithëve. Ai do të jetë i gatshëm nesër, e ju nëse jeni të obliguar që këtë ta bënë në mëngjes, mund ta prezentoni thelbin mbi bazë të shënimeve tuaja, e më vonë do ta merrni edhe stenogramin (iu drejtua shokut Andov).

Këtu do të duhej të mirremi vesh për publikimin sa i përket stenogramëve. Kjo çështje është mjaft e ndieshme. Disa shokë kanë pasur diç të shkruar, prandaj mbase edhe nuk frikësohen që kjo të botohet: disa kanë folur në mënyrë të paradëgjuar: është pikëpyetje si do të dalë kjo. Nëse ju konsideroni se kësaj duhet dhënë më shumë rëndësi - këtë mund ta bëjmë. Personalisht, një besoj se kjo mund të mbrohet, kurse duhet t'u jepen të gjithëve që këto t'i keni për përdorim.

**Franjo Tugjman:** Përse kjo të ketë rëndësi të sekretit? Duhet zhvilluar debat publik.

**Borisav Joviq:** Po, por kush dëshiron këtë ta autorizoj, këtë mund ta bëjë.

**Stojan Andov:** Mbledhjet e Sobranjës janë publike. Vetëm nëse dikush ekskluzivisht kërkon nga ju që diç të ruhet, atëherë në rregull është.

**Borisav Joviq:** Ne u morëm vesh - këto që u thanë këtu nuk janë fshehtësi.

Mirë, pas dy javësh do të gjendem përsëri në këtë përbërje, me kusht që në ndërkohë të gjitha propozimet që janë paraqitur këtu, mendimet dhe sugjerimet - të nxirren nëpër republika dhe të zhvillohen bisedimet ndërrepublikane në nu-



ÇKA PYETI DELEGATI NGA KOSOVA NË DHOMËN E REPUBLIKAVE E TË KRAHINAVE E ÇKA IU PËRGJEGJ KEF-i

## KEF-i ARSYETON PËRJASHTIMIN E SHQIPTARËVE NGA PUNA!

Në mbledhjen e Dhomës së Republikave e të Krahinave të Kuvendit të Jugosllavisë, më 18 dhjetor të vitit të kaluar, delegati nga Kosova Gani Miftari shtroi këto pyetje: Çfarë qëndrimi ka KEF-i lidhur me largimin nga procesi i punës të mbi 40 mijë punëtorëve shqiptarë në Kosovë? Çka mendon KEF-i për mbylljen e shkollave në gjuhën shqipe? dhe a ka qeveria informata se çfarë është raporti rreth marrjes dhe dhënies së lejeve për bartjen e armëve gjatë vitit në fjalë?

Rreth pyetjes së parë në përgjigjen e KEF-it thuhet se materia për pushimin e marrëdhënies së punës është e rregulluar me ligj mbi marrëdhëniet e punës që nxjerrin vetë republikat e krahinat, kurse organet federative vlerësojnë se a janë këto ligje në përputhje me ligjin federativ dhe si aplikohen ato. Në këtë kuptim me problemën e flakjes së punëtorëve nga puna në Kosovë jemi njofuar me anë të ankesave dhe kërkesave të shumta për mendim profesional, me ç'rast nga organet përkatëse të inspeksionit është kërkuar të konfirmohet gjendja faktike dhe baza juridike e largimit nga puna të punëtorëve kundër vullnetit të tyre.

Në përgjigje thuhet më tej se në numrin më të madh të rasteve marrëdhënia e punës ka pushuar për shkak të mungesës së paarsyeshme nga puna pesë ditë radhazi në përputhje me dispozitën e nenit 75 paragrafi 2 pika 3 të Ligjit mbi të drejtat themelore të marrëdhënies së punës. Gjithashtu në një numër të madh të rasteve marrëdhënia e punës u ka pushuar punëtorëve në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të veçanta (RS Serbisë), për shkak të moszbatimit të obligimeve të punës, mungesës dhe vonës në punë, të refuzimit të kryerjes së detyrave, lëshimit me vetëdëshirë të vendit të punës dhe të pengimit të punëtorëve të tjerë për të kryer obligimet. Me aplikimin e këtyre zgjidhjeve ligjore në një numër të kolektivave në Kosovë në masë

ACAROHEN MARRËDHËNIET SERBO-MAQEDONASE

## MANASTIRI «PROHOR PČINSKI» - SHKAKTAR I PËRÇARJES

Kisha ortodokse serbe sërish e shqetësoi opinionin maqedonas. Si shkas përsëri shërbeu manastiri «Prohor Pçinski», njëri prej vendeve të shenjta më të mëdha në historinë e popullit maqedonas. Pa kurrfarë dokumenti zyrtar, përfaqësuesve të Muzeut të Maqedonisë, të cilët janë kompetentë për materialin muzeal të Sesionit të Parë të KAÇKM në kohaqet e Manastirit, iu bë me dije se kisha ortodokse serbe dëshiron të shfrytëzojë lokale të cilat është vendosur muzeu i Ansomit, si sallë e ngrënies për besimtarët dhe klerikët e kishës ortodokse serbe gjatë festës së ardhshme të shën Savës.

Përfaqësuesit e Muzeut të Maqedonisë qëndruan këto ditë në manastirin «Prohor Pçinski», por nuk u bë kurrfarë kontakti me eprorin e Manastirit, e për këtë arsye imponohet përfundimi se në të vërtetë fjala është edhe për një provokim të kishës ortokse Serbe dhe për një testim të opinionit maqedonas. Sipas fjalëve të drejtorit të Muzeut të Maqedonisë dr. Voislav Sanavit këtij institucioni nuk i është paraqitur kurrfarë kërkesë për heqjen e përkohshme të muzeut të KAÇKM-së, e madje, edhe po të arrinte një kërkesë e tillë nga kisha ortodokse serbe, do të refuzohej kategorikisht sepse manastiri «Prohor Pçinski» është përmendore kulturo-historike e rangut më të lartë dhe për shfrytëzimin e lokaleve të tij ekziston marrëveshja ndërrepublikane e RS të Maqedonisë dhe e RS të Serbisë. Me fjalë të tjera, manastiri «Prohor Pçinski» është në kompetencë të shtetit të Serbisë, e jo të kishës ortodokse serbe, e cila duhet të respektojë ligjet e shtetit të vet. (Tanjug)

### KOMISIONI I MBROJTJES I KUVENDIT TË SLOVENISË

#### SHËRBIMI USHTARAK NË SLOVENI SHTATË MUAJ?

Lubjanë, 17 janar  
Nga sesionet e vjetshme të Kuvendit e deri në mbledhjen e sotme të Komisionit të mbrojtjes të Kuvendit të Sllovenisë qeveria republikane ka përpunuar tekstin e ligjit të detyrimit ushtarak, por kjo duke gjykuar nga gjykimi i sotëm në komision, nuk është ende një tekst i pranueshëm për të gjithë, para së gjithash, për opozitën, por edhe për disa përfaqësues të koalicionit qeveritar.

Në të vërtetë, shumica e pjesëmarrësve përkrah objektivat themelore të këtij ligji, në radhë të parë përpjekjen që çështja e ushtrisë në Slloveni të rregullohet, përkatësisht të përshtatet me Kushtetutën republikane dhe të bëhet i mundshëm, ndër të tjera, edhe shërbimi civil i detyrimit ushtarak, që shërbimi ushtarak për të gjithë të shkurtrohet në shtatë muaj, por ka edhe pakënaqësi për shkak të disa zgjidhjeve. Përfaqësuesve të Partisë së të Gjelbërve, ua zë udhën që me ligjin, madje as me «diksionin» e tekstit nuk parashikohet mundësia e çmilitarizimit gradual të Sllovenisë. (Tanjug)

#### PAS AFERËS NË SFERËN E SISTEMIT MONETARO-KREDITOR

#### SË SHPEJTI MONEDHË KROATE

Zagreb, 17 janar

I nxitur nga ngjarjet më të reja në sferën e sistemit monetaro-kreditor, nga rrjedhat financiare dhe nga bankat përgjithësisht, të krijuara nga vendimi i Kuvendit të Serbisë që të sigurojë në mënyrë të paligjshme për më shumë veprimtari sasi të mëdha të parave tërthorazi nga emisioni primar, guvernatori i Bankës Popullore të Kroacisë, prof. dr. Ante Čičin Šajin, në ujdj me ministrin e financave të Kroacisë, prof. dr. Marijana Hanxheković, thirri para dy ditëve të gjithë përfaqësuesit e bankave të republikës, anëtarët e qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Këshillin e BPK për një takim pune, i cili ishte i mbyllur për gazetarët.

Siç merr vesh «Veçernji list», «u dha parimisht dhe pa ujdj përfundimtare edhe iniciativa për vendosjen e një monedhe republikane. Kërkohen pastaj rrugë për t'u mbajtur mjetet valutore të mbledhura në Republikën e Kroacisë brenda caqeve të njëjta». (Tanjug)

### KRYESIA E OE TË SERBISË

#### PAPUNËSIA DHE FALIMENTIMET I KËRCËNOHEN EKONOMISË SË SERBISË

Beograd, 17 janar  
Në javët e para të janarit, si u tha në mbledhjen e djeshme të Kryesisë së Odës Ekonomike të Serbisë, kapacitetet në metalurgji dhe ndërtimari në atë republikë janë shfrytëzuar gjithësej 70 për qind, në makina ndërtimari 8 për qind, kurse gjendje e ngjashme është edhe në degët e tjera të industrisë. Nisma e sivjetme e prodhimit ekonomik, tha Momir Pavličević, anëtar i Kryesisë së Odës republikane, është më e pavoritshme sesa në nismë të vitit 1990, që ka qenë vit krize.

Nëse këto ecuri të pavolitshme vazhdojnë është më se e sigurt se ndërmarrjet e shumta do të falimentojnë, kurse disa qindra mijëra punëtorë do të mbeten pa punë apo do të shkonin në pushim të dhunshëm. Mu për këtë arsye, pa kurrfarë ngurrimi, duhet të thuhet e vërteta: ekonomia nuk është e aftë që vetë të ballafaqohet me vështirësi të tashme! (Tanjug)

#### SI IMPORTOHEN ARMËT DHE PAISJET USHTARAKE NË JUGOSLLAVI

#### VETËM NJË SUBJEKT I AUTORIZUAR

Boegrad, 17 janar  
Armët dhe pajisjet ushtarake në Jugosllavi mund t'i importojë, sipas autorizimit të Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes Popullore, Drejtoria federative për qarkullimin dhe rezervat e prodhimeve me destinim të veçantë. Kjo është rregulluar saktësisht me ligjet e tashme federative për afarizimin e jashtëm tregtar dhe për marrëdhëniet ekonomike e të tjera në prodhimin dhe në qarkullimin e armëve e të pajisjeve ushtarake.

Mënyra e blerjes së armëve e të pajisjeve ushtarake zbatohet në të gjitha vendet e botës. Nuk ka shembuj që tregojnë se në ndonjë shtet armët importohen pa të ashtuquajturin regjim të lejeve që i lëshojnë organet qeveritare.

Prej kërkesës për blerjen e armëve në botën e jashtme deri te importimi i tyre është një rrugë e gjatë. Kontraktimi i punës, të cilin e lejon sekretari federativ i Mbrojtjes Popullore, bëhet pas vlerësimeve të gjithanshme e të hollësishme të cilësisë së armëve, të çmimit, të afatëve të dërgimit, të kushteve të pagesës...

Qe armët që i merr ushtari të jenë të sigurta për përdorim, para blerjes provohen në poligone ushtarake në kushte të ndryshme klimatike e kohore. Është gati e sigurt se armët e blera ilegalisht pa marrë parasysh prodhuesit dhe konstruksionin nuk kalojnë nëpër teste të tilla.

Dihet qysh përpara se nja 15 për qind e mjeteve dhe armëve për nevoja të forcave të armatosura të RSFJ - të APJ e të mbrojtjes territoriale - importohen. Në botën e jashtme kryesisht blehen armë dhe pajisje ushtarake, prodhimi i të cilave ekonomikisht nuk është i arsyeshëm në vend. Po ashtu, dihet se vendi ynë është në mesin e atyre shteteve që prodhojnë pajisje e armë të llojllojshme - prej municionit deri te aeroplanët modern dhe sistemet e ndryshme raketore. (Tanjug)

#### BRENDA 20 DITËVE TË SHKUARA NË KROACI

#### U IMPORTUAN DHJETË MIJË VETURA

Zagreb, 14 janar  
Gjatë njëzetë ditëve të shkuara në Kroaci, në mbështetje të vlerësimeve të para, me lehtësimet që dalin nga vendimi i qeverisë, janë importuar afro 10 mijë automobila.

Me vendimin e qeverisë për lirin, përkatësisht lirin e pjesërisht, pastaj zbritjen e tatimit në qarkullim dhe në harxhimet e tjera të qytetarëve dhe të organizatave tregtare në Kroaci, lirohen nga tatimi deri në lartësinë e doganës, që dukshëm ul çmimin e veturave të importuara. Ndonëse ky vendim ka hyrë në fuqi më 22 dhjetor 1990, deri vonë kishte shpjegime të ndryshme për atë se lirohen praktikisht veturat. Thënë me gjuhë shifrash, do të thotë se automobili për të cilin duhej paguar 10.000 DEM me të vjetër, me të gjitha kontributet afro 130.000 dinarë, kurse me çmimin e ri, përkundër devalvimit, ky automobil kushton afro 115.000 dinarë. Logjaria për këtë është e qartë: tash disa automobila japonezë të vegjël, me lehtësimet-tatimore kushtojnë më lirë se «Jugo» jugosllave. (Tanjug)

#### LSPPJ U SHUA

Beograd, 17 janar  
Lidhja Socialiste e Jugosllavisë prej sot nuk ekziston më. Vendimin për ndërprerjen e punës së LSPPJ-së, të Konferencës Federative, të organeve dhe të forumeve të saja e morën sot delegatët e tri organizatave të krijuara me transformimin e LSPPJ në B e H, në Mal të Zi e në Maqedoni në Kuvendin Themelues të Lidhjes së Partive Socialiste të Jugosllavisë, e cila bëhet trashëgimtare politike dhe juridike e LSPPJ-së. (Tanjug)

### KIRO GLIGOROVI KANDIDAT PËR KRYETAR TË MAQEDONISË

Shkup, 17 janar  
Kandidati unik për kryetar të Republikës Socialiste të Maqedonisë është Kiro Gligorov. Kryetari të Parlamentit republikan propozimin e vetëm deri në mbarimin e afatit ligjor ia paraqiti mbrëmë grupi parlamentar i LKM - Partitë e Shndërrimit Demokratik. Këtë kandidat për funksionin më të lartë të republikës e propozuan 22 deputetë të radhëve të LKM - PSHD. (Tanjug)

### PPD-JA ËSHTË PËR MAQEDONINË E PAVARUR DHE SOVRANE

Shkup, 17 janar  
Partia për Prosperitet Demokratik e Maqedonisë përkrah iniciativën e Kuvendit që të nxirret deklarata për sovranitetin e plotë të kësaj republike, me të cilën Maqedonia do të konstituohet si shtet sovran, i pavarur. Në kumtesën e kësaj Partie, anëtarë të së cilës kryesisht janë shqiptarët, thuhet se Maqedonia duhet të jetë shtet kombëtar i kombit maqedonas dhe i kombeve e kolektiviteve nacionale të tjera që jetojnë në te. Nëpërmjet deputetëve të vet, me numrin e të cilëve në Kuvendin e Maqedonisë është e treta për nga forca, Partia për Prosperitet Demokratik do të angazhohet për rregullimin konfederativ të Jugosllavisë, si bashkësi e shteteve sovranë dhe të pavarura.

Në kumtesë thuhet edhe se Maqedonia në këtë aspekt duhet të përgatisë platformën për marrëveshjen e ardhshme në Beograd për rregullimin e Jugosllavisë. (Tanjug)

### BISEDIMET E SLOVENISË DHE KROACISË

#### KOORDINOHEN AKSIONET E PËRBASHKËTA

Lubjanë, 17 janar  
Lidhur me situatën e krijuar në vend dhe në botë në qytetin Mokrice të Novo-Mestos u takuan dje delegacionet e Sllovenisë dhe Kroacisë dhe me atë rast, në mbështetje të kumtesës së qeverisë republikane të Sllovenisë, u morën vesh për bashkëpunimin e ndërsjellë.

Delegacionet e dy republikave, në të cilat ndodheshin ministri i Mbrojtjes i Republikës, së Kroacisë Martin Špegel, ministri i Punëve të Brendshme i Kroacisë Josip Bolkovac, kryeshefi i SHMSH të Kroacisë Jovo Perković, përkatësisht ministri i Mbrojtjes i Sllovenisë Janez Jansha, i Punëve të Brendshme Igor Bačar dhe kryeshefi i SHMSH të Sllovenisë Miha Brajc, sipas kumtesës, biseduan për çështjet aktuale mbrojtëse dhe të sigurisë që kanë të bëjnë me këto republika. (Tanjug)

### NXËNËSIT SHQIPTARË NUK I MARRIN LIBREZAT NË GJUHËN MAQEDONASE

Në shkollën fillore «Marshalli Tito» në Tetovë nxënësit e kombësisë shqiptare refuzuan t'i marrin librezat për suksesin e gjysmëvjetorit të parë, vetëm ngase ato nuk ishin shkruar në gjuhën shqipe.

Në të vërtetë, librezat e nxënësve në shkollën fillore «Marshalli Tito» për të gjithë nxënësit ishin shkruar në gjuhën maqedonase, siç e kanë përcaktuar dispozitat e tashme ligjore dhe kushtetuese në RS të Maqedonisë.

### MASAT E PËRKOHSHME PËR LIGJIN KUSHTETUES TË SLOVENISË

Begorad, 17 janar  
Prokurori publik federativ, Lubo Përleta inicoi në Gjyqin Kushtetues të Jugosllavisë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së dispozitave të ligjit kushtetues për zbatimin e amendamentit 96 në Kushtetutën e Sllovenisë, që ka të bëjë me veprimet penale të shkëputjes së një pjesë të terrorit të RSFJ-së.  
Prokurori publik federativ propozoi edhe që Gjyqi Kushtetues, deri në përfundimin e procedurës, të urdhërojë ndërprerjen e zbatimit të të gjitha akteve apo veprimeve individuale që do të ndërmerreshin në bazë të ligjit kushtetues kontestues. (Tanjug)

të madhe na qenkan ndryshuar qëndrimi ndaj punës dhe qenka arritur një shkallë më e lartë e përgjegjësisë për kryerjen e obligimeve punuese. Në favor të kësaj thuhet se ka kolektiva punonjëse në të cilat më me pak punëtorë qenka shënuar prodhimtari më e madhe (Fabrika e Tubave në Ferizaj, Fabrika e Pompave me Piston në Deçan, miniera «Stari-tërg», «Trepça», etj.). Prandaj KEF-i përkrah vendimet e organeve përkatëse që kanë mbështetje në ligje.

Pra, i tillë është qëndrimi i qeverisë federative për vendimet «shteti juridik» të Serbisë që po i merr ndaj shqiptarëve në Kosovë! Vërtet s'ka se çka t'i shihet për të madhe këtij mendimi të qeverisë, e cila me këtë vetëm edhe një herë dëshmoi se nuk çanë kokën për Kosovën, siç ka vepruar edhe deri më tash. Qeveria ndaj kosovës dhe shqiptarëve po sillet si njerëz e ndaj Serbisë në rastin konkret si nënë!!!

Rreth pyetjes për mbylljen e shkollave KEF-i nuk dha kurrfarë përgjigje. Ndoshta këtë e bëri me qëllim që të mos bëhet e tepërt nëse edhe këto masa të ligjshme të Serbisë i përkrah se gjoja kanë mbështetje ligjore.

Lidhur me marrjen e lejeve të armëve dhe dhenjen e lejeve të reja gjithashtu nuk u dha përgjigje konkrete, por thuhet se në përputhje me aktivitetin e shtuar të OPB për rregullimin e gjendjes në këtë sferë dhe për luftimin e kontrabandimit të armëve në Kosovë e Metohi (edhe qeveria ben shkelje të Kushtetutës federative dhe e përdor nocionin kundërkushtetues. Kosovë e Metohi e jo atë kushtetues Kosovë - vërejtja jonë) SFPB përcjellë gjendjen e këtyre organeve dhe koordinon punën në luftimin e zbulimin e kanaleve për sjelljen ilegale të armëve.

Delegati Gani Miftari nuk ishte i kënaqur me këto përgjigje dhe në mbledhjen e fundit më 16 janar shtroi pyetjen plotëseuse:

1. A kanë organet e autorizuar federative të inspeksionit analizën e afërt të saj se çka është e arsyeshme e çka jo në rastet e flakjes nga puna të shqiptarëve, apo qëndrimi i KEF-it mbështetet vetëm në disa raste? Këtë po e them për shkak se nuk është fjala për numrin e vogël të punëtorëve, por për dhjetëra mijëra të tillë. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të SHKSH, prodhimi i përgjithshëm për 11 muaj e vitit të kaluar në Kosovë ishte 30% më i vogël në raport me një vit më parë ose 3 herë më pak në raport me mesataren e vendit, e jo siç theksohet në përgjigjen e KEF-it!

Gjithashtu kërkoj përgjigje nga KEF-i lidhur me mbylljen e shkollave në gjuhën shqipe në Kosovë?

3. Edhe rreth pyetjes së tretë nuk mora përgjigje ashtu siç kam pyetur, sepse unë kërkoja njoftime lidhur me marrjen dhe dhënien e lejeve për bartjen e armëve gjatë vitit të shkuar e nuk kam pyetur se çka po bëjnë organet e punëve të brendshme, lusa që të më jepet përgjigje me shkrim në të gjitha pyetjet e shtruara, tha në fund Gani Miftari.

### SUGJERIM I SEKRETARIT TË SPB-SË SË RAJONIT TË KNINIT

#### TË REFUZOHET NËNSHKRIMI I DEKLARATËS SË MPB TË KROACISË

Knin, 17 janar  
Sekretari i SPB-së së posafomuar të rajonit autonom serb të Krahinës, të cilin Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë nuk e njeh, Milan Martiq, sot me telegram u dërgoi një sugjerim të gjitha stacioneve të sigurimit publik në territorin e Krahinës që të mos nënshkruajnë deklaratën që ua ka dërguar MPB-ja kroate. Në atë deklaratë veç të tjerash thuhet se ata të cilët «deklaratën e besnikërisë» nda Kroacisë nuk e nënshkruajnë e pret ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Në atë rast në telegramin dërguar SPB-ve në Benkovc, Gračac, Obrovac, Donji-Lapac, Titovo-Korenica, Glina, Dvorno- Un, Kostajnicë, Vojniq, Petrinjë e Vërin-Most, Martiqi thekson se kjo kërkesë e MPB-së së Kroacisë është «edhe një akt i vrazhdë jolegjitim e provokuës ndaj pjesëtarëve e punëtorëve të autorizuar e të tjerë në KAS të Krahinës». Gjithashtu, Martiqi konsideron se ai është «atak mbi dinjitetin e punëtorëve të SPB-së së Krahinës, ndërsa shantazhi me punë dhe me të ardhura personale është akt jovicilizues». Martiqi gjithashtu thekson se kërkesa e këtitillë e MPB-së është në kundërshtim me ligjet federative ngaqë «të gjithë punëtorët e autorizuar në Krahinë kanë dhënë deklaratë solemne për RSFJ-në». (Tanjug)



PAS PËRFUNDIMIT TË GJYSMËSEZONIT VJESHTOR E FILLIMIT TË ATIJ PRANVEROR TË LIGËS SË DYTË FEDERATIVE TË HENDBOLLISTËVE (GRUPI LINDOR)

## TREPÇA NË VRAP PËR TITULL

● Tri skuadrat e tjera kosovare në këtë rang të garave: Borci, Prishtina e Vëllaznimi (Kosova e Vuçiternës nuk u inkuadrua në garë) dëshpëruan me renditje në radhitjen tabelare

Pas aplikimit të masave të jashëzakonshme të shtetit juridik serb të Kosovës ra intersimi për shumë sfera të jetës, pra edhe për sportin, për të cilin në botë qëndron sintagma së është «gjaja më e rëndësishme e dorës së dytë». Sepse të rinjtë e kësaj treve (të thash pa rini), janë më shumë të preokupuar si të sigurojnë bukë e gojë sesa të merren apo ta përcjellin sportin, që ra nën çdo nivel dhe më të cilin tashmë nuk mund të krenohet Kosova si kur bie fjala skuadrat tona bënin gara me mjaft sukses në rangun më të lartë - Ligën e parë federative (në futboll, hendboll, boks...)

Jo moti, hendbolli pa dyshim ishte një ndër sportet më cilësore dhe më masive kosovare. Borci i Ferizajt (disa herë) e Trepça e Mitrovicës u gjendën edhe në kategorinë e parë të garave në Jugosllavi, krah për krah me Metaloplastikën, Proleterin, Zagreb Kromosin e të tjerë, që ia shtuan namnin edhe ashtu të madh këtij sporti në arenën botërore. Në anën tjetër, Kosova e Vuçiternës, Vëllaznimi, Prishtina, Bozhuri, Elektroekonomia e të tjera, bënin «kërdi» në kategorinë e dytë - Ligën e dytë federative, prej nga kalohet në atë të parën.

Pritëm që edhe në këtë sezon, pjesa e parë e të cilit u krye para një muaji (e dyta do të vazhdojë kah mesi i shkurtit), si përherë do të jetë i suksesshëm për katër ekset kosovare në Ligën e dytë federative - grupi i lindjes, në të cilin është dashur të gjendet edhe e pesta - Kosova e Vuçiternës, njëra ndër më cilësoret, nga e cila bile shpresonim se do të atakojë edhe titullin e më të mirit, pra të kampionit, por ajo, për shkak të situatës së

përgjithshme në Kosovë, as që ia nisi garës.

Pas 13-të xhirove të zhvilluara, Trepça e Mitrovicës, edhe pse e dobësuar, e mbylli vjeshtën në pozitën e tretë të tabelës së klasifikimit më 16 pikë të tubuara, sa kanë edhe e para Dubočica e Leskovicit (që ra nga kategoria e parë) dhe i dyti T.Kombinati i Prilepit si dhe i katërti Vardari i Shkupit. Sipas të gjitha gjasëve, duke marrë parasysh formën dhe përgatitjen që bënë skuadrat e lartpërmendura, në mesin e këtij «katërshi» duhet kërkuar edhe kampionin definitiv, i cili automatikisht kalon në rangun më të lartë - Ligën e parë të Jugosllavisë. Sa është në gjendje Trepça që ta ruaj hapin me konkurrentët e drejtpërdrejtë në luftë për titull, na mbetet të shohim së shpejti. Në start të sezonit, thënë realisht, më së shumti patëm shpresë në Prishtinën e fortë, anëtarë të së cilës u bënë edhe një Hasan Bajrami, Agron Shabani e Nexhdet Dobrosi, lojtarë të cilësive kulminante të cilët i lakmojnë edhe ekipet e kategorisë së parë. Falë fondit për kulturë fizike të Prishtinës, Prishtina e nisi sezoni i pa halle materiale. Mirëpo, skuadrën e kryeqendrës së Kosovës në vjeshtë nuk e deshi fati për shumë arsye objektive e subjektive por edhe orarin e pati të pavolitshëm (i luajti dy lojë më shumë jashtë). Në fund të garave të vjeshtës u bënë ndërrime edhe në shtabin profesional. Pas dorëheqjes së

trajnerit Skender Sahiti, skadrës tash i prin Hysni Firza, ekspert i verifikuar dhe strateg i njohur i këtij sporti, me ndihmësin Shaban Hasanxhekaj. Me ardhjen e tyre në krye të shtabit profesionist, udhëheqësia e klubit si edhe vetë lojtarët, shpresojnë se në pranverë do të bëjnë kthesë të madhe dhe se prej pozitës së parafundit në tabelë (12 pikë, ose katër më pak se e para Dubočica), do të arrijnë të luftojnë për titullin e më të mirit, atë të kampionit, për çka janë duke u përgatitur me shumë ambicje e optimizëm në pallatin «Boro e Ramizi». Që nga java e ardhshme ata do të vazhdojnë përgatitjen në një qendër të njohur sportive - rekreative në Adriatik, sipas të gjitha gjasëve në Umag. Na mbetet të shpresojmë që synimet e tyre në pranverë do të bëhen realitet. E, për këtë, Prishtina tash ka forcë, dije e mundësi.

Borci i Ferizajt, dikur mburrja e hendbollit kosovar, me halle shumë e me forca të vjetra, gjysmësezonin e parë e mbylli në pozitën e dhjetë në radhitjen tabelare (me 12 pikë të tubuar nga 13 ndeshje, sa kanë edhe Bori, Boreci, Zajecari e Prishtina). Tërë barrën e garave e bartën si thamë «ujqit e vjetër», Vëllazërit Bujar e Besim Qerimi, Tomoviqi, Zherka e Sadriu. Na mbanë shpresa se pranvera për ta do të jetë më fatlume dhe se Borci do ta avancojë në tabelë, në mënyrë që të mos e sjellë veten të rrezikohet për rënie në nga më të ulët të garave, siç i ndodhi Vëllaznimit maksimalisht të dërmuar, që nga 13 ndeshje nuk i fitoi asnjë dhe me 0 pikë e nga pozita e fundit në tabelë do të startojë në pranverë, pa gjasë bile as teorike që t'i shpëtojë më të keqes - largimit nga shqoëria e tashme. A.D.

NGA ARENA E TENISIT

## RAHJE NDËRMJET SHIKUESVE NË MELBURN

MELBURN.- Pesë simpatizues, me origjinë jugosllave, u lënduan në rrahjen që shpërtheu në meqin ndërmjet Goran Përpitit dhe braziljanit Luiz Matar. Tenisti Jugosllav e fitoi meqin 3:0 me seta.

Rrahja shpërtheu kur, siç pohojnë dëshmitarët, një grup

RANGLISTA BOTËRORE

## SELESH E DYTA, IVANISHEVIQ I TETI

MAJAMI.- Jugosllavja Monika Selesh momentalisht zë vendin e dytë në listën e tenisteve më të mira të botës, kurse Goran Ivanisheviq hëpërhe është i teti në ranglistën e lojtarëve më të suskesshëm të «sportit të bardh».

Lista e tenisteve:

1. Shtefi Graf (Gjermani) 278,10 pikë, 2. Monika Selesh (Jugosllavi) 203,75,3. Martina Navratilova (SHBA) 199,42,4. Meri - Xho Fernandez (SHBA) 140,06,5. Gabriela Sabatini (Argjentinë) 137,01,6. Arnata Sañces (Spanjë) 116,15,7. Katerina Malejeva

(Bullgari) 115,83,8. Xhenifer Kaprijati (SHBA) 103,41,9. Zina Garisan (SHBA) 101,34,10. Manuela Malejeva (Zvicër) 10,79, piëk etj.

Asiash nuk është arrestuar nga se tifozët kapërcyen rrethojen dhe u arratisën sapo erdhin policia.

Lista e tenistëve:

1. Stefan Etberg (Suedi) 3.889 pikë, 2. Boris Becker (Gjermani), 3.528, 3. Ivan Lëndel (Çekosllovakia) 2.541, 4. Andre Agasi (SHBA) 2.398,5. Pit Sampras (SHBA) 1.855, 6. Andres Gomes (Ekuador) 1.680,7. Tomas Muster Austri) 1.551, 8. Goran Ivanisheviq (Jugosllavi) 1.503, 9. Emilio Sañces (Spanjë) 1.487, 10. Bred Gilbert (SHBA) 1.451 etj.

## DISFATË E IVANISHEVIQIT NË DUBËL

MELBURN. - Goran Ivanisheviq dhe çekosllovaku Peter Korda nuk arritën të renditen në xhiron e dytë të kampionatit australian në konkurrencën e qifteve. Këta në meqin e xhiros së parë i mposhti çifti i panjohur Nik Braun nga Anglia dhe Meno Östing nga Holanda me rezultat 6:1, 5:7, 6:3.

## B.MILUTINOVIQ - TRAJNERI REPREZENTACIONIT TË SHBA-VE

NJU-JORK.- Bora Milutinoviç trajner i reprezentacionit futbollistik të Kostarikës në Mundialin e vjetëm në Itali sipas të gjitha gjasave do të marrë timonin e reprezentacionit futbollistik të Amerikës në periudhën e përgatitjeve për kampionatin e ardhshëm botëror, mikpritëse të së cilës janë SHBA-të.

Siç shkruan «Nju-Jork tajms» Milutinoviç është «favorit» i Franc Bekënbaerit, asit të mirënjohur futbollistik gjerman, i cili deri në kampionatin botëror në Amerikë do të punojë si këshilltar special i «Federatës» e cila, e ballafaquar me faktin se futbollit në këtë vend sportiv nuk ka kurrfarë popullariteti, pranoi detyrën serioze dhe me përgjegjësi të cilën me qëllim të popullarizimit të futbollit në botë ia besoi federata Ndërkombëtare (FIFA).

## SPANJA - PORTUGALIA 1:1

KASTELONË.- Në një ndeshje ndërkombëtare miqësore të futbollit mbrëmë në Kastelonë skuadra përfaqësuese e Spanjës dhe e Portugalisë luajtën baras 1:1 (0:1). Golashënues: Moja në minutën 71<sup>a</sup> për Spanjën, kurse Okeano në minutën 39 për Portugalinë.

PINGPONG

## POLONIA - ANGLIA 3:4

GDANJSK.- Skuadra përfaqësuese franceze e pinpongut mundi në Gdanjsk në kuadër të superligës evropiane skuadrën përfaqësuese vendëse të Polonisë 4:3.

## HOLANDA - ÇEKOSLLOVAKIA 5:2

DORDREHT.- Skuadra përfaqësuese e tenistëve të Holandës mposhti Çekosllovakinë 5:2 në ndeshjen e kthimit të superligës evropiane dhe kësaj siguri egzistencën në divizionin e parë edhe në vitin e ardhshëm.

VOLEJBOLL

## FOJERBAH - MLLADOST 0:3

Në ndeshjen e parë çerekfinale të kupës së kampionëve evropianë të volejbollistëve në Fojerbah (Gjermani) lojtarët e Mlladostit të Zagrebit mposhtën ekipin gjerman Fojerbah 3:0 (15:1,15:3,15:2).

## KANA - PARTIZANI 3:1

KANË.- Në ndeshjen e parë të grupit B gjysmëfinal të Kupës së kampionëve evropianë mbrëmë në Kanë, volejbollistët e kampionit francez Kanës mposhtën kampionin jugosllav Partizanin 3:1 (15:5,15:8, 13:15,15:6).

KUPAT EVROPIANE TË BASKETBOLLIT

## VETËM CIBONA SHËNOI FITORE


● Zagrebasi mundën Hapoelin me 124:68, kurse Zara, Zhelezniçari e C.Zveda pësuan humbje

Në kupat evropiane të basketbollit ekipet jugosllave vite me radhë kanë luajtur rol të rëndësishëm, e shumë prej tyre edhe kanë ngadhny, duke fituar trofetë e çmueshëm. Mirëpo, në ciklin e sivjetëm të garave në kupat evropiane ekipet jugosllave nuk janë të suksesshme si në të kaluarën. Shkaktr kryesor për një mosukses të tillë është largimi i një numri të madh të lojtarëve cilësorë të cilët tash i mbrojnë ngjyrat e ekipeve në Itali, Spanjë, Greqi, Gjermani, Francë SHBA etj.

Megjithatë, me të drejtë

gut në Berlin, ngjyrat e të cilit i mbron ish reprezentuesi jugosllav e kapiteni i C.Zvezdës së Beogradit, Zoran Radoviç. Nëse Cibona luan si kundër Hapoelit, me siguri se nga Beolini do të kthehet me fitore dhe do të renditet në gjysmëfinale.

Përfaqësuesi i dytë jugosllav në këtë kupë, Zara, që bënë gara në grupin D (sikur Cibona, ka gjasa reale të renditet në gjysmëfinale. Zarasit me tri fitore e dy humbje momentalisht gjenden në pozitën e dytë. Në xhiron e pestë Zara pësoi



Zoran Çutura vëteran i Cibonës

pritet që disa ekipe jugosllave të arrijnë edhe në garat përfundimtare të ciklit të sivjetëm. Gjasa reale kanë basketbollistët e Cibonës dhe të Zarës në Kupën «Radivoje Koraç» dhe ata të POP 84 (ish Jugoplastika) në Kupën e kampionëve evropianë.

Në kupën «Radivoje Koraç» u zhvilluan ndeshjet e zhiros së 5-të (në grupet çerekfinale. Cibona, e cila bën gara në grupin B, në Zagreb u takua me përfaqësuesin e Izraelit, Hapoelin e Tel Avivit. Zagrebasi ishin bindshëm më të mirë dhe shënuan fitore me rezultat 124:68 (68:34). Pas kësaj fitoreje zagrebasi kanë gjasa reale që të renditen në pozitën e dytë të grupit B çerekfinal dhe të renditen në garat gjysmëfinale. Për të arritur këtë qëllim Cibonës i nevojitet të shënojë fitore të mërkurën e ardhshme kundër Sharletnbur-

humbje nga konkurrenti kryesor për vendin e parë, Estudiantes në Madrid me rezultat 65:84 (28:42). Për t'u renditur në gjysmëfinale Arjan Komazecit me shokë u nevojitet edhe një fitore, e cila pritët të shënohet të mërkurën e ardhshme në Zarë kundër Sunairit të Belgjikës.

Basketbollistët e C.Zvezdës (Kupa e fituesve të Kupave), të cilët gjenden në grupin B çerekfinal që moti i kanë humbur gjasat në garat e mëtejme.

Në garat e Kupës «Liljana Ronketi» dy përfaqësuesit e Jugosllavisë, C. Zvezda e Beogradit dhe Zhelezniçari i Sarajevës nuk do të arrijnë të renditen në gjysmëfinale. Beogradaset në kuadër të xhiros së tretë të grupit C pësuan humbje të thellë në Moskë nga CSKA me 74:94, kurse basketbollistët e Zhelezniçarit humben në Sarajevë nga Orshija e Francës me 66:76.

RELI AUTOMOBILISTIK «PARIS-DAKAR»

## VATANEN EDHE MË TEJ UDHËHEQ

TAMBAKUNDA - Ekipi francez Aro e Monet është fitues i etapës së 13-të të relit automobilistik «Paris - Dakar». Ata, me automobilin «Lada Samara» nga qyteti Kif në Mauritani deri në Kajese të Malit, në një gjatësi prej 283 kilometra, kaluan për 1:36,13.

Vendi i dytë në këtë etapë u takoi bashkëvendësve të tyre Tambei dhe Lemojn të cilët nisnin automobilin e prodhuesit të njëjtë me ngecje prej 17 sekondash. Vendi e tretë e fituan zviceranët Erikson dhe Parmander me «Micubishi» të cilët ngecën 1:51 prapa fituesit të etapës. Në renditjen e përgjithshme nuk pati ndryshime, edhe më tej udhëheq Ari Fatanen dhe Berg Berglund të Finlandës me automobilin «Citroen» me kohë të përgjithshme 31:20,40.



Më 13.1.1991 u bënë 2 vjet pa më të dashurin tonë



**MEHMET R ZABËRRGJA**  
(1954-1989)

Jeta jonë është e hidhur pa ty. Ajo po rrjedhë nën hijen e emrit tënd. Koha nuk paska fuqi të shërojë plagët që i hape në zemrat tona e çdo herë e më tepër po na shtohet malli për ty. Tokë e errët na more më të dashurin tonë, na more dritën e syve, e na fale lotin e përjetshëm.

Me mall të pashuar dhe lot në sy e kujtojnë përherë: bashkëshortja Shefka, djemtë Fatosi e Labi-noti, vajzat Fitorja e Kaltrina, si dhe farefisë i gjerë nga Mitrovica e Titos, Prishtina dhe Rapica. (9496-91)

Me rastin e dyvjetorit të vdekjes së babait



**SHYQERI BERISHA**

E kujton përherë me mall: e bija Fahria me bashkëshortin Ruzhdiun dhe djalin Rrezonin (9314-91)

Kaluan dy vjet pa babanë



**SHYQERI BERISHA**

Ti jeton prorre në kujtimet tona. E kujton: bija Adilja me bashkëshortin Aslanin dhe fëmijët Trëndelinën dhe Arbrin. (1313-91)

Më 16.1.1991 u bënë 10 ditë nga vdekja e shokut dhe kolegut tonë të dashur



**RESHAT VALLQI**

E kujtojnë kolegët e PM «Dardania» - Prishtinë. (9314-91)

Sot, më 18.1.1991, u bënë 7 ditë që kur u nda nga ne bashkëpunëtori, shoku dhe kolegu ynë i dashur



**VLLAZNIM XHOKA**

(inxh. i dipl. i gjeodezisë) E kujtojnë: Xhavidë, Lulja, Ramizi, Skënderi, Ilmiu, Nehru, Bashkimi, Fehmiu, Melihatja, Mehmeti, Bakiri dhe Xhelati. (9318-91)

U bënë 7 ditë pikëllimi që kur u nda nga ne në lulen e rinisë



**AGRON DABINOVCI DHE**



**SHENIZE TOPALLI**

Me dhembje të thellë e përkujtojnë familja Dabinovci dhe Topalli nga Ferizaj. (9319-91)

Më 17.1.1991 u bënë 52 ditë pa ty



**SABRIE (FEJZULLAHU) MEJZINOLLI**

E madhe është dhembja dhe zbrazëtia që le në zemrat tona. Na le të jetojmë përherë të pikëlluar, me mall, me lot dhe me zemra të thyera.

E kujtojnë: nëna Eminja, vëllezërit Bajrami e Naseri, motrat Hysnia e Iqballja, kunata Rukia dhe mbarë familja nga Prishtina. (8444-91)



**HYRIE (TURJAKA) KAQI**

Kaluan 3 vjet mall i djegur pa lumturi në jetë, pa nënën, shtyllë e gëzimi e jete. Nëna Mahia, motra Fahria, vajza Ferka (24375-91)

Më 20 janar bëhen gjashtë muaj që kur u ndamë nga më i dashuri ynë



**Mr. ZAHIR ISTREFI**

Shkove atëherë kur pritnim të gëzohemi të gjithë. E rëndë qenka jeta pa ty. Pikëllimi ynë për ty nuk ka të ndalur.

E kujtojnë: bashkëshortja Zahidja, fëmijët Adriana, Visarioni, Dardana dhe nipi i vogël Taulanti. (9307-91)

Me mall të pashuar kujtojmë trevjetorin e vdekjes së bashkëshortit e babait tonë të dashur



**SHEH SAFET MULLIQI**

Krenohemi që të patëm 'bujar dhe fisnik.

Përherë e kujtojmë me mall dhe respekt: bashkëshortja Resmia, djemtë Luani e Gëzimi, vajzat Drita, Makedonja e Teuta, nuset Laura e Naxhisi, dhëndurët Hajdari, Agimi e Gëzimi, nipat, e mbesat. (9310-91)

**Pleqësia e shkollës fillore «Bajram Curri» në Sllatinë të Madhe, komuna e Fushë-Kosovës, dhe Komisioni për konkurse, në mbledhjen e mbajtur më 8.1.1991, mori vendim që të shpallë.**

**KONKURS**

për plotësimin e vendit të lirë të punës, për kohë të pacaktuar:

**1. Një mësues i ciklit klasor në PNF në Henc**

Kushtet:  
- të ketë të kryer shkollën normale, akademinë pedagogjike ose fakultetin filozofik-grupi i pedagogjisë.

Kërkesës duhet t'i bashkangjiten të gjitha dokumentet e nevojshme të parapara me ligj.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e publikimit. /18-91/

# M. HOXHA.

## NDËRMARRJA TREGTARE E NDËRMJETËSUESE NË RAHOVEC, rr «Skënderbeu» nr. 15, tel. 029/76-748

### NJOFTON

**Konsumatorët se përmes rrjetit tregtar të ndërmarrjes sonë në Kosovë mund të furnizohen me shumicë e pakicë me artikuj të ndryshëm të konsumit të gjerë, të prodhuara në vend dhe nga importi.**

### NA VIZITONI Ë BINDUNI!

### QENDRA E BIZNESIT TË VOGËL «EUREKA» - PRISHTINË

#### LAJMËRON

Lajmërohen të gjithë obliguesit e tatimit dhe kontributeve nga të ardhurat personale për kryerjen e veprimtarisë me punë personale (zejtari të të gjitha llojeve, tregtarët, hotelistët, transportuesit e të tjerë) se mund t'i shfrytëzojnë shërbimet (plotësimin e formularëve dhe dokumenteve të tjera lidhur me paraqitjen e tatimit dhe të kontributeve të përmendura). Këto shërbime gjithashtu mund t'i shfrytëzojnë edhe të gjithë qytetarët e tjerë që janë të obliguar të paraqesin tatimin dhe kontributet nga të ardhurat e përgjithshme të tyre.

Të intersuarit për shfrytëzimin e këtyre shërbimeve mund të kontaktojnë personalisht për çdo ditë me ekspertë profesionalë nga ky lëm në QBV «Eureka» në rrugën «Ramiz Sadiku» p. n. prej orës 12 deri 20 ose të informohen në tel. (038) (25-443, 27-465, 31-772).

Kompensimi për shërbimin e kryer për plotësimin e një fletëparaqitjeje është 150 din.

Të interesuarit mund të paraqesin telefonin dhe të japin adresën e vet me qëllim që këto shërbime t'u ofrohen dhe të kryhen në dyqanin apo shtëpinë e obliguesit të tatimit për çdo ditë deri në fund të janarit kur kalon edhe afati i obligimit të paraqitjes së tatimit, me kusht që lajmërimi gjegjësisht thirrja të bëhet së paku 5 h ose 1 ditë më parë dhe të paguajë çmimin 250 din.

Të intersuarit përveç të tjerash mund të shfrytëzojnë dhe materialet e përgatitura nga tatimqarkullimi dhe llojet e tjera të tatimit, doracakun për udhëheqjen e librave tregtarë e shërbime të tjera nga këto fusha.

Pagesa bëhet me të gatshme me rastin e kryerjes së shërbimit. (96-91)

### Këshilli i punëtorëve i OPB të Shtëpisë së Shëndetit të Serbicës, duke u bazuar në nenet 105 dhe 106 të Statutit të kësaj OPB-je, në mbledhjen e mbajtur më 23.XI.1990 vendosi të shpallë

#### KONKURS

për zgjedhjen dhe emërimin e punëtorëve në vende të punës me autorizim dhe përgjegjësi të veçanta

1. Drejtor i OPB-së
2. Zëvëndësredrejtor i OPB-së

Kushtet:  
Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:  
1 dhe 2-ta janë mjekë specialistë, mjekë të praktikës së përgjithshme, atonatologë, farmaceutë me tre vjetë përvojë pune.  
- të kenë aftësi organizative, të treguar në praktikë, respektivisht që me punën dhe aktivitetin e vet të gjertanishtëm të kenë treguar sukses në zhvillimin e marrëdhënieve vetëqeverisëse.  
- të mos kenë pengesa për emërim sipas ligjit.  
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në mjetet e informimit publik.  
Zgjedhja e kandidatëve bëhet brenda 30 ditësh prej ditës së mbylljes së konkursit.  
Pagesa e të ardhurave personale bëhet sipas rregulloreve mbi bazat dhe kriteret për ndarjen e mjeteve për të ardhura personale të punëtorëve.  
Banesa nuk është e siguruar  
Kërkesat me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë me vonesë nuk do të shqyrtohen.  
Kërkesat me dokumente të kompletuara dërgohen në adresën: Këshilli të Punëtorëve të OPB të Shtëpisë së Shëndetit në Serbicë.

Ndërmarrja e industrisë së mishit «Topola» - Baçka-Topolë, rruga «Mareshali Tito», nr. 5, publikon

### SHPALLJE

për marrjen e ofertave me shkrim për shitjen e këtyre objekteve me hapësirë afarizmi:

- I. Hapësira e afarizmit në Pulë me adresën «Edvard Kar-del», p.n. me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>.  
1. Hapësira e magazinimit përbëhet nga 124 m<sup>2</sup>, nga e cila sipërfaqe hapësirë zyre me pikë sanitare është rreth 20 m<sup>2</sup>. Në hapësirën e magazinimit është vendosur një dhomë ftohjeje (-18 C) me vëllimin 18,6 m<sup>3</sup>.  
2. Një objekt i shitjes me pakicë me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, pajisur me pajime komplete për shitjen e mishit të freskët dhe të nënprodhimeve të tjera të mishit.  
3. Çmimi fillestar i hapësirës së veprimtarisë në pajime është 5.000 (pesë mijë) DM/, për një metër katror.
- II. Hapësira e veprimtarisë në Domzhale në adresën «Lublanska», nr. 84, me sipërfaqe 233 m<sup>2</sup>.  
1. Hapësira e magazinimit në plate me sipërfaqe 160 m<sup>2</sup>, në kuadrin e së cilës janë hapësirë zyre dhe një pikë sanitare me afro 30 m<sup>2</sup>. Në hapësirën e magazinimit është vendosur një dhomë ftohjeje (-18 C) me vëllimin 36,0 m<sup>3</sup>.  
2. Një objekt i shtypjes me pakicë në katin përdhësë me sipërfaqen 73 m<sup>2</sup>, nga e cila sipërfaqe hapësira e zyrës dhe hapësira sanitare nxënë rreth 20 m<sup>2</sup>. Pjesa tjetër e hapësirës është e pajisur me pajime komplete për shitjen e mishit të freskët dhe të nënprodhimeve të tjera të mishit.  
3. Çmimi fillestar i hapësirës së veprimtarisë me pajime është 6.500 (gjashtë mijë e pesëqind) DM/ për një metër katrorë.
- III. Të dy objektet janë të rregulluara dhe të pajisura sipas dispozitave veterinaro-sanitare pozitive të magazinimit dhe të shitjes së mishit të freskët dhe të nënprodhimeve të mishit.  
Oferta duhet të përmbajë sa vijon:  
- Lartësinë e ofruar të çmimit të shitblerjes në të cilën elementet e tjera që janë thelbësore për t'u lidhur kontrata. Si ofruese mund të paraqiten të gjithë personat e interesuar juridikë dhe fizikë.  
Ofertat paraqiten brenda 15 ditëve prej ditës së daljes së shpalljes.  
Për datën e hapjes së ofertave ofruesit do të njoftohen më vonë me shkrim.  
Ofertat paraqiten me dërgesë të porositur në adresën e lartëshënuar në shënimin në zarf «Komisioni për shitjen e hapësirës së veprimtarisë».  
Të gjitha informatat tjera mund të merren në tel: 024 712-360, telex 15166 dhe fax. 024 / 711-953. (100-91)

### Komisioni për konkurse i shkollës fillore «1 Maji» në Haxhaj, KK në Pejë në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 1990 mori vendim që të shpallë

#### KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Drejtor shkolle (nuk është rizgjedhje)

Kushtet:  
përveç kushteve të parapara me ligj, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:  
- të ketë të kryer fakultetin, SHLP-në ose akademinë pedagogjike,  
- të ketë 3 vjet përvojë në punë,  
- të ketë aftësi organizative dhe pedagogjike.  
Kërkesat me dokumente të kompletuara dërgohen në adresën e shkollës.  
Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë me vonesë nuk shqyrtohen.  
Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes. /186-2-90/

### SHITBLERJE

Shes komplet inventarin për qebaptore, rr. «Lenini» nr. 69, tel 038/ 36-349 prej orës 20-22. (9315-91)

Në lagjen Bregu i Diellit, në Prishtinë shes banesën katërdhomshe me 103 m<sup>2</sup> me dy WC-a, telefoni 038/47-076



